



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi Komunalë Rahovec
Skupština Opštine Orahevac / Municipal Assembly Rahovec



VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË E TJERA PËR

KOMUNËN E RAHOVECIT



RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 010 (I vendi i Komunitetit)
Nr./Br./No 21 Nr. ifaq/Br./str./No. 2011/15
Data/Datum/Date 28.01.2023



Shkurt- 2023, Rahovec

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKËQSITË NATYRORE DHE FATKËQSITË E TIERA

PËRMBAJTJA:

PARATHËNIE.....	7
THEMELIMI I GRUPIT PUNUES.....	8
VLERËSIMI I RREZIQEVE SI PJESË PËRBËRËSE E MBROJTJES DHE E SHPËTIMIT NË KOMUNËN E RAHOVECIT	9
MISIONI DHE SYNNIMI I VLERËSIMIT TË RREZIKSHMËRISË.....	9
INFRASTRUKTURA LIGJORE.....	10
KREU I PARË.....	11
PROFILI I KOMUNËS SË RAHOVECIT.....	11
1. POZITA, KARAKTERISTIKAT GJEOGRAFIKE DHE KLIMATIKE TË KOMUNËS SË RAHOVECIT	11
1.1. ZONA E PËRGJEGJËSISË (PËRKUFIZIMI HAPËSINOR).....	11
1.2. 1.2 SIPËRFAQJA E PËRGJITHSHME (E TERRITORIT) E KOMUNËS SË RAHOVECIT	11
1.2.1 HIDROGRAFIA - LUMENTË DHE LIQENET	12
2. DEMOGRAFIA	13
Struktura e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë	16
2.1 KATEGORITË E BANORËVE TË PLANIFIKUAR PËR EVAKUM.....	17
2.2 TË PUNËSUARIT, TË PAPUNËT	18
Varfëria në Rahovec	19
3. TË MIRAT MATERIALE, KULTURORE DHE TË MJEDISIT	21
3.1. TRASHËGIMIA KULTURORE	21
Monumentet natyrore	25
3.2. PARQET NACIONALE	25
3.2.1 PARQET NATYRORE DHE REZERVATET	25
3.2.2 SIPËRFAQET PYJORE.....	25
3.2.3 ZONAT E MBROJTURA DHE TRASHËGIMIA NATYRORE	26
3.3. ZONAT E PRODHIMITARISË BUJQËSORE	27
3.3.1 ZHVILLIMI BUJQËSOR DHE RURAL	27
3.3.2 ZONAT E PRODHIMIT BUJQËSOR	27

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË E TJERA

3.3.3	KULTIVIMI I BIMËVE NJË - VJEÇARE (TË KORRAT)	28
3.3.4	KULTIVIMI I KULTURAVE BUJQËSORE SHUMËVJEÇARE	28
3.3.5	SKEMA E TREGUESIVE SPECIFIKË RURALË	28
3.3.6	FERMAT BUJQËSORE	30
3.3.7	NUMRI, LLOJI DHE KAPACITETET E FERMAVE	30
3.4.	ZONAT INDUSTRIALE DHE OBJEKTET EKONOMIKE.....	31
3.4.1	VENDNDODHJA DHE VEÇORITË E ZONËS INDUSTRIALE	31
3.4.2	AGROBIZNESI	32
3.4.3	TURIZMI	32
3.4.4	SEKTORI PRIVAT / KOMUNITETI I BIZNESIT	32
3.4.5	SHOQATAT AFARISTE	33
3.5.	OBJEKTET	33
3.5.1	OBJEKTET E BANIMIT	33
3.5.2	OBJEKTET AFARISTE	34
3.5.3	OBJEKTET SPORTIVE	35
3.5.4	OBJEKTET KULTURORE	35
3.6.	STREHIMORET DHE OBJEKTET PËR STREHIM	37
3.6.1	PËRCAKTIMI I LOKACIONEVE (ZONA VE) TË GRUMBULLIMIT NË RAST FATKEQËSIE	38
3.6.2	LOKACIONI I STREHIMOREVE / TITULLARI.....	38
3.7.	KAPACITETET SHËNDËTËSORE PUBLIKE DHE PRIVATE	38
3.7.1	INSTITUCIONET SHËNDËTËSORE.....	38
3.7.2	KAPACITETET HUMANE SHËNDËTËSORE:	39
3.7.3	KAPACITETET TEKNIKE NË SEKTORIN PUBLIK (QKMF/QMF)	40
3.7.4	KAPACITETET MJEKËSORE PRIVATE	41
3.7.5	DETYRAT E EKIPEVE PËR SHËRBIME MJEKËSORE NË SITUATA EMERGJENTE:	42
4.	INFRASTRUKTURA TEKNOLOGJIKE DHE E TRAFIKUT	43
4.1.	RRUGËT (RRJETI RRUGOR DHE QARKULLIMI).....	43
4.2.	HEKURUDHAT	45
4.3.	AEROPORTET	45
4.4.	URAT DHE TUNELET	45
	Tunelet	46
4.5.	LARGPËRÇUESIT DHE TRAFO-STACIONET	46

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË E TJERA

4.6.	SISTEMET ENERGETIKE (OBJEKTET DHE SISTEMET)	48
4.7.	SISTEMET E TELEKOMUNIKIMIT	48
4.7.1	QENDRAT TELEKOMUNIKUESE, TRANSMETUESE DHE REPETITORËT	49
4.7.2	TV DHE RADIOSTACIONET	49
4.8.	SISTEMET HIDROTEKNIKE	50
4.8.1	OBJEKTET PËR FURNIZIM ME UJË	50
4.8.2	KORPORATAT RAJONALE TË UJËRAVE (KRU) DHE BURIMET ALTERNATIVE	50
4.8.3	SISTEMI I DISTRIBUIMIT TË UJT PËR PIJE	50
4.8.4	BURIMET ALTERNATIVE TË UJT PËR PIJE	51
4.8.5	NDOTËSIT E MUNDSHËM TË UJËRAVE SIPËRFAQËSORË DHE NËNTOKËSORË	51
4.9.	SISTEMET E SHPËRNDARJES SË GAZIT DHE TË NATFËS	52
4.9.1	POMPAT E DERIVATEVE	52
4.9.2	DEPONTË E DERIVATEVE /KAPACITETET	53
4.10.	OBJEKTET E RËNDËSISË SË VEÇANTË	53
4.10.1	OBJEKTET E SIGURISË (STACIONET POLICORE, QENDRAT OPERATIVE RAJONALE ETJ)...	53
4.10.2	OBJEKTET DHE HAPËSIRAT QEVERITARE (SHËRBIMET E ADMINISTRATËS CIVILE, SHËRBIMET PUBLIKE)	53
4.10.3	SHËRBIMET FINANCIARE /BANKAT, AGJENCITË E SIGURIMEVE, SHËRBIMET POSTARE, ETJ	54
4.10.4	OBJEKTET SHKOLLORE (PARASHKOLLORE, SHKOLLA FILLORE E MESME E ULËT (SHFMU), SHKOLLA E MESME E LARTË (SHML))	54
	KREU II	58
	II. LLOJET E FATKEQËSIVE	58
1.	INTENSITETI, LLOJET DHE NDIKIMET E VEPRIMIT TË FATKEQËSIVE NATYRORE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË RAHOVECIT	58
1.1	PRIORITIZIMI I FATKEQËSIVE NATYRORE BAZUAR NË MATRICËN E RREZIQEVE	58
	(LISTA SIPAS PRIORITETEVE)	58
1.2	RREZIQET NGA FATKEQËSITË NATYRORE	59
1.3	VËRSHIMET	59
1.3.1	IDENTIFIKIMI I RREZIQEVE NGA VËRSHIMET	59
1.3.2	KARAKTERISTIKAT HIDROGRAFIKE DHE NDIKIMET E SAJ NË PARAQITJEN E VËRSHIMEVE	59
1.3.3	HISTORIKU I VËRSHIMEVE	60

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË E TJERA

1.3.4	VENDET (VENDBANIMET) MË TË ATAKUARA NGA VËRSHIMET / PASQYRA E VENDBANIMEVE TË RREZIKUARA ME NUMRIN DHE STRUKTURËN E BANORËVE.....	61
1.3.5	KUSHTET HIDROMETEOROLOGJIKE.....	93
1.3.6	ZJARRRET (ZJARRET KATEGORIZOHEN SI FATKEQËSI NATYRORE DHE FATKEQËSI TË TJERA) 96	
1.3.6.1	KARAKTERISTIKAT E TERRENTIT DHE TË VATRAVE POTENCIALE TË ZJARREVE.....	96
1.3.6.2	HARTËZIMI I RREZIQEVE NGA ZJARRRET;.....	111
1.3.7	TËRMETET.....	121
1.3.7.1	KARAKTERISTIKAT SIZMIKE TË ZONAVE DHE RREZIKU SIZMIK	121
1.3.7.2	VENDBANIMET E RREZIKUARA, NUMRI DHE STRUKTURA E BANORËVE	121
1.3.7.3	RREZIKSHMËRIA E ZONAVE TË ÇAKTUARA.....	121
1.3.7.4	SHPESHTËSIA, INTENSITETI DHE EPIQENDRA E TËRMETIT (DRIDHJEVE)	121
1.3.7.5	PASOJAT E TËRMETEVE SIPAS ZONAVE SIZMIKE	122
1.3.7.6	MASAT PARANDALUESE.....	122
1.3.7.7	HARTA E RREZIQEVE	123
	SKENARI.....	125
1.3.8	RRËSHQJTET DHE EROZIONET	128
1.3.8.1	KARAKTERISTIKAT E TERRENTIT DHE TË ZONAVE POTENCIALE TË RRËSHQJTJES DHE TË EROZIONEVE	128
	KUSHTET KLIMATIKE, INTENSITETI, SHPESHTËSIA E PARAQITJES.....	128
1.3.8.2	SIPËRFAQET E PËRFSHIRA	128
1.3.8.3	PASOJAT NGA RRËSHQJTET DHE EROZIONET	129
1.3.8.4	MASAT PARANDALUESE.....	129
1.3.8.5	HARTA E RREZIQEVE NGA EROZIONI.....	131
1.3.9	RESHJET E DËBORËS DHE NGRICAT	133
1.3.9.1	KARAKTERISTIKAT E TERRENTIT DHE E ZONAVE POTENCIALE ME TË RESHURA TË DENDURA TË DËBORËS DHE NGRICAVE	133
1.3.9.2	INTENSITETI I RESHJEVE, SHPESHTËSIA E PARAQITJES, TEMPERATURAT EKSTREME	133
1.3.9.3	PASOJAT NGA DËBORA DHE NGRICA.....	133
1.3.9.4	MASAT PARANDALUESE.....	134
1.3.9.5	HARTA E RREZIQEVE	134
1.3.10	BRESHËRI	135

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKËQËSITË NATYRORE DHE FATKËQËSITË E TJERA

1.3.10.1	KARAKTERISTIKAT E TERRENIT DHE ZONAT POTENCIALE TË PREKURA NGA BRESHËRI	135
.....		135
1.3.10.2	SHPESHTËSIA E PARAQJTËS DHE MUAJTË KRITIKË	135
1.3.10.4	HARTA E RREZIQEVE	139
1.3.11	ORTEKËT	140
1.3.11.1	KARAKTERISTIKAT E TERRENIT DHE ZONAT POTENCIALE.....	140
1.3.11.2	PASQYRA E VENDBANIMEVE TË RREZIKUARA, NUMRI DHE STRUKTURA E BANORËVE	141
1.3.11.3	TREGUESIT STATISTIKORË TË PASOJAVE NGA ORTEKËT PËR 10-20 VITET E KALUARA (MUAJTË MË KRITIKË TË VITIT, CENUSHMËRIA, EFEKTET SIPAS EVIDENCAVE STATISTIKORE ETJ.)	141
1.3.11.4	MASAT PARANDALUESE.....	141
1.3.11.5	HARTA E RREZIQEVE	143
1.3.12	ERËRAT E FUQISHME DHE STUHITË.....	145
1.3.12.1	KARAKTERISTIKAT E TERRENIT DHE ZONAT POTENCIALE.....	145
1.3.12.2	PASQYRA E VENDBANIMEVE TË RREZIKUARA, NUMRI DHE STRUKTURA E BANORËVE	145
1.3.12.3	TREGUESIT STATISTIKORË TË PASOJAVE NGA ERËRAT E FUQISHME DHE STUHITË (PËR 10-20 VITET E KALUARA, MUAJT MË KRITIKË TË VITIT, CENUSHMËRIA, EFEKTET SIPAS EVIDENCAVE STATISTIKORE ETJ.).....	145
1.3.12.4	HARTA E RREZIQEVE	147
1.3.13	THATËSIRAT	148
1.3.13.1	TREGUESIT STATISTIKORË PËR MUNGESËN E THEKSUAR TË TË RESHURAVE	148
1.3.13.2	DËMET DHE PASOJAT (TË EVIDENTUARA PËR 30 VITET E KALUARA, MUAJTË MË KRITIKË TË VITIT, CENUSHMËRIA, EFEKTET SIPAS EVIDENCAVE STATISTIKORE ETJ.)	148
1.3.13.3	PASQYRA E VENDBANIMEVE/ ZONAVE TË RREZIKUARA, NUMRI DHE STRUKTURA E BANORËVE	148
1.3.13.4	REZERVAT UJORE (MBITOKËSORE DHE NËNTOKËSORE)	148
1.3.13.5	MASAT PARANDALUESE.....	149
1.3.13.6	HARTA E RREZIQEVE	150
1.3.14	RREZIQET NGA EPIDEMITË DHE PANDEMITË	152
1.3.14.1	KARAKTERISTIKAT E TERRENIT DHE ZONAT POTENCIALE.....	152
1.3.14.2	SËMUNDJET NGJITËSE	152

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË E TJERA

1.3.14.3	PASOJAT NGA EPIDEMITË DHE PANDEMITË (MUJATË MË KRITIKË TË VITIT, EFEKTET SIPAS EVIDENCAVE STATISTIKORE ETJ.)	153
1.3.14.4	BARTËSIT DHE PËRGJEGJËSIT E AKTIVITETEVE TË RREGULLTA DHE MASAT PARANDALUSE	154
1.3.14.5	HARTA E RREZIQEVE	155
2.	FATKEQËSITË E TJERA	156
2.1	VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË E TJERA	156
2.1.1	SHPËRTHIMI I PENDAVE HIDRO-AKUMULUSE	156
2.1.2	POTENCIALIN AKUMULUES TË LIQENEVE DHE TË POZITËS SË TYRE	157
2.1.3	PASOJAT NGA SHPËRTHIMI I PENDËS HIDRO-AKUMULUSE	157
2.1.4	PASQYRËN E REZULTATEVE TË MATJEVE DHE VLERËSIMIN E GJENDJES SË TRUPIT TË PENDËS.	157
2.2	VLERËSIMI PËR FATKEQËSITË NUKLEARE, RADIOLOGJIKE, KIMIKE DHE BIOLOGJIKE	159
2.2.1	VLERËSIMI PËR RREZIQET NGA VEPRIMET LUFTARAKE DHE TERRORISTE	159
2.2.2	VLERËSIMI I RREZIQEVE TË RREZATIMIT RADIOAKTIV NË KOMUNËN E RAHOVECIT	161
2.3	VLERËSIMI DHE PASOJAT E INFRASTRUKTURËS KRITIKE	164
2.4	STRUKTURAT PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM	164
2.4.1	VLERËSIMET PËRFUNDIMTARE BËHEN PËR SECILËN MASË TË MBROJTJES DHE TË SHPËTIMIT	169
3.	KOSTOJA FINANCIARE E DOKUMENTIT TË VLERËSIMIT	169
3.1	Identifikimi dhe analizmi i rreziqeve nga FNFT (ekipe hulumtuese profesionale)	170
3.2	Identifikimi i nevojave për resurset humane dhe teknike	170
3.3	Identifikimi i nevojave për trajnim dhe aftësim profesional	171
3.4	Zbatimi i akteve ligjore, nënligjore dhe monitorimi i tyre	171
3.5	Masat parandaluese për zvogëlimin e efekteve nga FNFT-ja	171
4.	DIZPOZITAT PËRFUNDIMTARE	171
5.	REFERENCAT	172

PARATHÈNIE

Dokumentet i vlerësimit të rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera në komunën e Rahovecit, bazohet në Ligjin Nr.04/L-027, si dhe në Rregulloren Nr. 28 / 2012 për Metodologjinë e hartimit të vlerësimit të rrezikshmërisë.

Me këtë dokument identifikohen kërcënimet nga reziqet në komunën e Rahovecit, si dhe bëhen vlerësimi i shkallës së rrezikshmërisë së tyre. Gjithashtu, me këtë vlerësim, identifikohen mundësitë dhe nevojat për parandalimin, zvogëlimin e reziqeve, reagimin, rimëkëmbjen dhe evitimin e pasojave nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera. Ky vlerësim, shërben si bazament për Planin e Reagimit në nivel lokal, si dhe Hartimin e Vlerësimit të Rreziqeve, duke përfshirë resurset humane dhe teknike, shetërore, private si dhe të OJQ-ve, me qëllim të mbrojtjes dhe të shpëtimit të jetës së qytetarëve të komunës së Rahovecit nga fatkeqësitë natyrore , tekniko-teknologjike dhe nga faktori ijeri.

Në bazë të neni 13 dhe neni 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), neni 74 dhe neni 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, të datës 29.3.2017, Kryetari i komunës me vendim të cakimin e grupit punues për hartimin e Planit të vlerësimit të trezikut për territorin e komunës së Rahovecit.

THEMELIMI I GRUPT PUNUES

Kryetari i komunës së Rahovecit , z. Smaji Latifi, bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë brenda juridiksionit komunal, nxjerr vendim për themelimin e Grupit Punues për hartimin / rishikimin e dokumentit të vlerësimit të rrezikshmëisë.

Vendimi i Kryetarit të Komunës për themelimin e grupit punues:

[illegible]

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË E TIJERA

VLERËSIMI I RREZIQEVE SI PJESË PËRBËRËSE E MBROJTJES DHE E SHPËTIMIT NË KOMUNËN E RAHOVECIT

H Y R J E

“Vlerësimi i rrezikshmërisë nënkupton analizën sasore dhe cilësore të natyrës dhe të rrethanave të tjera për dukuritë e mundshme nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera”. Si çdo pjesë e Kosovës, edhe komuna e Rahovecit mund të ballafaqohet me fatkeqësitë natyrore. Bazuar në historikun e fatkeqësive natyrore dhe të fatkeqësive të tjera, në të kaluarën ka pasur shkatërtime dhe humbje të shumta të jetës së njerëzve, të të mirave materiale, të trashëgimisë kulturore dhe të ambientit. Me qëllim të ngritjes së vetëdijes qytetare, ngritjes së kapaciteteve për mbrojtje dhe shpëtim, masave parandaluese, zhvillimin e programeve për një jetë më kualitative dhe më të sigurt, hartohet dokumenti i vlerësimit të rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.

Rreziku, ndër të tjera, paraqet një pëjtim të humbjes apo të dëmit, i cili mund të shfaqet në cilindo vend dhe në çfarëdo kohe, intensiteti i të cilit mund të jetë i kufizuar apo me përmasa tragjike, prandaj, parandalimi i rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, nënkupton zvogëlimin/lehtësimin e rreziqeve, masat parandaluese, ngritjen e nivelit të gatishmërisë dhe të kapaciteteve të nevojshme, për të ndërmarrë veprimet e duhura në situata emergjente.

Ky dokument, është bazë për hartimin e planeve të reagimit emergjent, të planeve operative dhe të planeve të tjera sipas legjislacionit në fuqi.

Komuna e Rahovecit është përgjegjëse për organizimin e Mbrojtjes dhe të Shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera në kufijtë territorial të përgjegjësisë të saj, si pjesë e sistemit unik të emergjencave civile në Kosovë, i cili pëmban planifikimin, organizimin, aftësimin, koordinimin, realizimin, mbikëqytjen dhe financimin e të gjitha masave dhe aktiviteteve për Mbrojtje dhe Shpëtim.

Dokumenti i vlerësimit të rrezikshmërisë duhet të rishikohet sipas rregullores në fuqi çdo tre vjet e në raste sepcifike edhe më herët.

MISIONI DHE SYNNIMI I VLERËSIMIT TË RREZIKSHMËRISË

Hartimi i Dokumentit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë konsiston në identifikimin, analizimin, vlerësimin, strukturimin dhe arkivimin e informatave nga të gjitha subjektet juridike pjesëmarrëse dhe reaguese ndaj situatave emergjente në komunë, me qëllim të:

- a. Hartimit të planeve të reagimit emergjent, planeve operative dhe planeve të tjera përkatëse sipas legjislacioneve në fuqi;

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË E TJERA

- b. Profilizimi dhe standardizimi të masave parandaluese dhe veprimeve konkrete për zvogëlimin, zbutjen dhe sanimin e pasojave të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera;
- c. Caktimi të shkallës së cenueshmërisë (vatrave potenciale të rrezikut sipas shkallës së rrezikshmërisë), përcaktimi të moduleve vlerësuese për situatat e krijuara emergjente, si dhe koordinimi të resurseve humane dhe teknike, të cilat do të përfshihen si përgjigje adekuate në situatat emergjente.

Vlerësimi i rrezikut nënkupton procesin e analizimit, të vlerësimit dhe të konkluzioneve të cilat inkorporohen në hartimin e planeve dhe të strategjive afatshkurtra dhe afatgjate, me qëllim të zvogëlimit të rreziqeve nga FNFT-ja, realizimin e projekteve konkrete dhe menaxhimin e situatave emergjente, me të cilat mund të përballët komuna.

INFRASTRUKTURA LIGJORE

Hartimi i “Vlerësimit të rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera”, për territorin e komunës së Rahovecit, është i bazuar në ligjin për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera, si dokument bazë për hartimin e planeve të reagimit emergjent dhe planeve të tjera.

Vlerësimi i Rrezikshmërisë për territorin e komunës së Rahovecit, është dokument me karakter lokal, hartimi i të cilit është i bazuar në:

1. “Ligjin për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera” Nr. 04/L-027;
2. “Ligjin për Mbrojtje nga Zjarrt” Nr. 04/L-012;
3. “Ligjin për transportin tokësor të maltrave të rrezikshme” Nr. 06/L-071;
4. “Ligjin për sigurinë në komunikacionin rrugor” Nr. 02/L-70;
5. “Ligjin për ndërtim”, Nr. 04/L-110;
6. “Ligjin për pajisjet nën presion” Nr. 08/L-031;
7. “Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-109, për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjithëse” Nr. 08/L-046;
8. “Ligjin për përdorimin civil të eksplozivëve” Nr. 04/L-022;
9. “Ligjin për vlerësimin e ndikimit në mjedis” Nr. 03/L-214.
10. “Ligjin për mbrojtjen e mjedisit” Nr. 03/L-025;
11. “Ligjin për mbrojtje nga preztimi dhe siguri bërthamore” Nr. 06/L-029;
12. “Ligjin për rezervat shtetërore të maltrave” Nr. 03/L-244;
13. “Ligjin për ujrat e Kosovës” Nr. 04/L-147;
14. Rregulloren për Metodologjinë e Hartimit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë nga FNFT, Nr. 25/2020;
15. Udhëzimin Administrativ (MPB)-04/2018-UA, për kategorizimin dhe klasifikimin e objekteve në kategorinë përkatëse të rrezikshmërisë nga zjarrt;
16. Statutin e Komunës së Rahovecit.

KREUI PARË

PROFILI I KOMUNËS SË RAHOVECIT

1. POZITA, KARAKTERISTIKAT GJEOGRAFIKE DHE KLIMATIKE TË
KOMUNËS SË RAHOVECIT

Territori i komunës së Rahovecit, shtrihet në regionin e Gjakovës dhe ka një pozitë të mirë gjeografike. Në veri kufizohet me Komunën e Klinës me distancë rreth 40 km, në verilindje me Komunën e Malishevës rreth 16 km, në juglindje me komunën e Suharekës rreth 17 km dhe atë të Mamushës, në jug me Komunën e Prizrenit 25 km, dhe në Perëndim me komunën e Gjakovës, 22 km dhe në largësi nga kryeqendra e Kosovës (Prishtina) rreth 60 km.

Ekzistojnë lidhje të mira komunikative në mes të komunave, kalon magjistralja Prizren – Pejë dhe hekurudha Prizren – Pejë.

Territori i komunës shtrihet në hemisferën në mes shkallës 42° e 30' dhe 42° e 50' të gjerësisë gjeografike veriore dhe ndërmjet 20° e 21' dhe 20° e 55' të gjatësisë gjeografike lindore. Vendbanimet në komunën e Rahovecit shtrihen në lartësi të mbidetare prej 306 m¹ (Krusha e Madhe) deri në 1038 m lartësi mbidetare (Zatirqi).

Për kah lartësia mbidetare, këto vendbanime ndahen në luginore-rrafshore, kodrinore dhe malore. Vendbanimet të cilat janë të përfshira në luginë ose rrafshina janë këto: (310m – 350 m.)

Xërxa, Fortesa, Gexha, Malësia e Vogël, Ratkoci, Dejni, Dabidoli, Çifllaku, Nagaci, Hoça e Vogël, Celina dhe Krusha e Madhe.

Vendbanimet të cilat janë të përfshira në lartësi të mbidetare prej 350m – 600 m, që i takojnë kategorisë së vendbanimeve kodrinore, janë: Rahoveci, Drenoci, Senoci, Pastaseli, Polluzha, Kramoviku, Mrasori, Hoça e Madhe, Operusha, Zaçisht, Pataqani i Ulët, Pataqani i Epër, Nashpalla, Bratolini, Vrajaka, Retija dhe Retija e Ulët. Vendbanimet malore shtrihen në lartësi të mbidetare prej 600m – 1.000 m, e këto janë: Zatirqi, Kazniku.

Harta 1: Pozita gjeografike e Komunës së Rahovecit, *Aneksi i hartave.*

1.1. ZONA E PËRGJEGJËSISË (PËRKUFIZIMI HAPËSINOR)

Komuna e Rahovecit kufizohet me Komunitatet e: Prizrenit, Gjakovës, Klinës, Malishevës, Suharekës dhe Mamushës. **Harta 2: Kufizimi i komunës së Rahovecit me komunitetet fqinje,**

Aneksi i hartave.

1.2. 1.2.SIPËRFAQJA E PËRGJITHSHME (E TERRITORIT) E KOMUNËS SË
RAHOVECIT

Territori i komunës së Rahovecit ka një sipërfaqe prej 275.89 km²

¹ Agjencia Kadastrale e Kosovës, hartat topografike 1:250 000
11

1.2.1 HIDROGRAFIA - LUMENJTË DHE LIQENET

Në komunën e Rahovecit, rrethi hidrografik është relativisht i dendur. Kjo paraqet pasurinë natyrore të komunës dhe një ndër kushtet për ekzistencën e botës bimore dhe të aktiviteteve njerëzore. Rrethi hidrografik të komunës së Rahovecit e përbëjnë disa qindra burime, puse, burime rrjedhëse dhe të qëndrueshme, si dhe përrenjë. Burimet janë forma të rëndësishme hidrografike. Në territorin e komunës së Rahovecit, ka disa burime periodike dhe të përhershme. Numri i madh i burimeve janë ato burime që burojnë në luginat e përroçkave – përrenjve dhe rrëzë kodrinave. Më së shumti, ka burime në luginën e Rimmikut, të lumit të Hoçës, të Opterushës etj. Rëndësi të madhe ekonomike kanë burimet të cilat shtrihen në shpatet e luginave dhe të shtratis të lumit, pastaj burimet të cilat paraqiten në kodrat terciare të neogjenit. Hulumtimet tregojnë se më së shumti ka burime karstike periodike dhe të përhershme. Burimet e këtyre gjenden në jugperëndim, veri dhe veriperëndim, në rrëzë të malit të Shkozës, Zatriq dhe Kaznik. Shtrirja e vendbanimeve është kryesisht përgjatë ujërtrjedhave, si dhe burimeve ujore, si: Rahoveci, Hoça e Madhe, Zaçisht, Opterusha, Zatriqi, Drenoci, Senoci, Pastaseli, Kramoviku e të tjerë.

a. Gjendja e resurseve ujore - lumore - lumenjtë

Lumi Drini i Bardhë, edhe pse nuk buron në komunën e Rahovecit, të gjitha përroçkat dhe lumenjtë derdhen në të. Nëpër komunën e Rahovecit, ky lumë rrjedh me një gjatësi prej 30 km dhe në pjesën më të madhe është edhe si kuft administrativ i komunave, si: Prizrenit, Gjakovës, Malishevës dhe Klinës. Lumenjtë-përroçkat, të cilat derdhen në Drinin e Bardhë janë: lumi Rakoc, Rimmik, Polluzhë, Hoçë etj. Për shkak të konfiguracionit të terrenit, lugina e Drinit, në komunën e Rahovecit është e gjërë rreth 2km deri 5 km. Ndërsa gjatësia mesatare e shtratis të lumit prej 50 m deri 100 m, thellësia e shtratis të lumit është 1 deri 5 m. Lumi Drini i Bardhë ka prerë masivin gëlqeror Gradishtin, duke formuar Grykën (Kanyonin) epigjenike atraktive në gjatësi prej 450 m. Në kanyon është ndërtuar Ura e Fshenjtë e cila është e gjatë 70 metra dhe lartësia prej harkut, deri te shtrati i ujit është 30 m. Lumi i Hoçës buron në fshatin Hoçë e Madhe, në lartësi mbidetare 420 m dhe rrjedh nëpër fshatin Brestoc, por para fshatit Brestoc bashkohet me degën e Babindollit dhe disa burime dhe derdhet në Drinin e Bardhë.

Lumi Bellaja është dega e majtë e Drinit të Bardhë, me gjatësi 3 km, prej fshatit Fortesë deri te fshati Rogovë. Lumi Duhle buron në Rahovec dhe është i formuar nga tri burime (Duhle, Vrellë dhe Sopot) dhe bashkohet me lumin e Rimmikut. Në harta topografike, ky lumë është i shënuar me emrin Gjergoja, që do të thotë për popullin e kësaj ane është i panjohur. Lumi Rimmik buron rrëzë malit Gërgavicë dhe në rrjedhjen e saj i bashkon disa burime të tjera. Ky lumë ka rëndësi të madhe ekonomike për këtë anë. Lumi Rimmik, gjatë rrjedhjes së vet, bashkohet me rrjedhën Duhlllo dhe në fshatin Fortesë bashkohet me lumin e Sopniqit duke formuar kështu lumin Bellaja. Lumi Sopniq burimin e ka në rrëzë të malit të Drenocit dhe kalon nëpër fshatin Nushtpal, Sopniq.

Ky lumë gjatë stinës së verës thahet dhe mund të quhet si lumi i thatë. Duhet cekur se janë edhe disa lumenj- përroçka, si: i Rakocit, i Kramovikut, i Polluzhës e të tjera.

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATÛRORE DHE FATKEQËSITË E
TJËRA

Harta 3: Rrjeti hidrografik i Komunës së Rahovecit, aneksi i hartave

2. DEMOGRAFIA
(Numri i banorëve, struktura e moshës dhe e gjinisë së banorëve, treguesit sipas
kategorive, dendësia e banorëve, etj)

Bazuar në statistikat e fundit (Vjetari statistikor i Republikës së Kosovës 2021), Komuna e Rahovecit ka gjithsej 55 391 banorë. Krahasuar me vitin 2011, ka një rënie të popullatës për 817 banorë.

Sipas statistikave rreth 30% e popullatës jetojnë në zonën urbane, ndërsa 70% jetojnë në zonat rurale.

Nga tabela mund të shihet trendi i zvogëlimit të popullsisë në Komunën e Rahovecit, ky trend pritet të shënojë zvogëlim edhe në vitet e ardhshme, së paku edhe për 10 vite.

Në bazë të vlerësimeve të bëra, në komunën e Rahovecit dominon moshja e re, dhe atë si në zonën urbane poashtu dhe në atë rurale. Ndërsa grupmosha dominante e popullsisë janë kategoria 19-44 vjeçe. Nëse bëjme një krahasim të lëvizjes së numrit të popullsisë nëpër vite të regjistrimit, kemi këto rezultate:² në vitin 1948 Rahoveci kishte 20350 banorë, ndërsa të dhënat e fundit tregojnë se numri i banorëve në Komunë sillej rreth 55391 banorë, që do të thotë se për këtë periudhë kohore (62 vjeçare) numri i popullsisë është rritur përafërsisht tri herë.

Tabela 1 - Numri i popullsisë sipas regjistrimeve dhe vlerësimeve


Vitet	Numri i popullsisë
Regjistrimi i vitit 1948	20350
Regjistrimi i vitit 1953	22687
Regjistrimi i vitit 1961	26839
Regjistrimi i vitit 1971	35215
Regjistrimi i vitit 1981	46459
Vlerësimi i 1991 (vlerësim i bërë nga Komuna)	59877
Regjistrimi i vitit 2011	56208
Vlerësimi i vitit 2012	57451
Vlerësimi i vitit 2013	57645
Vlerësimi i vitit 2014	58214
Vlerësimi i vitit 2015	58908
Vlerësimi i vitit 2016	59381
Vlerësimi i vitit 2017	59102
Vlerësimi i vitit 2018	58023
Vlerësimi i vitit 2019	56414

²Agjencia e Statistikave të Kosovës

VLERËSIMI I RRËZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË E TJERA

Vlerësimi i vitit 2020	57047
Vlerësimi i vitit 2021	55391

Grafiku 1 - Numri i popullsisë së komunës sipas regjistrimeve dhe vlerësimeve



Sipas të dhënave nga tabela dhe grafiku, vërehet se deri në vitet e 60-ta, komuna e Rahovecit ka shënuar rritje demografike, por shkallët e kësaj rritjeje kanë qenë më të vogla nga fakti se kishte shkallë të larta të natalitetit dhe të mortalitetit, ku si pasojë kishte shtrim të ulët natyror. Pas viteve të 60-ta, gjegjësisht viteve të 70-ta, kemi një rritje më të theksuar të popullsisë, si pasojë e zvogëlimit të shkallëve të mortalitetit dhe në anën tjetër shkalla e natalitetit mbetet ende e lartë, ku si pasojë kemi shkallë më të lartë të shtrimit natyror. Popullsia e komunës së Rahovecit jeton në gjithsej 36 vendbanime, prej tyre 35 janë fshatra dhe vetë qyteti i Rahovecit. Këto vendbanime kanë dallime të theksuara sa i përket numrit të popullsisë. Në qytetin e Rahovecit jetojnë rreth 15892 banorë, që do të thotë se rreth 29 % e popullsisë së tërësishme jeton në qytet, ndërsa në të gjitha vendbanimet e tjera jetojnë rreth 40316 banorë, apo rreth 71 %.

Tabela 2 - Numri i popullsisë sipas vendbanimeve (Ask 2011).

Nr.	Vendbanimi	Nr. Banorëve	Nr.	Vendbanimi	Nr. Banorëve
1	Rahovec	15892	19	Nushpal	220
2	Bellacërke	2270	20	Opterushë	1911
3	Bërrnjak	40	21	Pastaselle	1011
4	Bratotin	396	22	Pataqan i Epërm	533
5	Brestovac	1288	23	Pataqan i Poshtëm	1077
6	Celine	1903	24	Guri i Kuq	731
7	Çiftlik	1292	25	Polluzhtë	808
8	Dobidol	799	26	Radostë	2346
9	Dejné + Baboc	1757	27	Ratkoc	3791

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKËQËSITË NATYRORE DHE FATKËQËSITË E TIERA

10	Drenoc	1587	28	Retije e Ulet	234
11	Gexhe	660	29	Retije	771
12	Hoçe e Madhe	124	30	Sapniq	996
13	Hoçe e Vogel	1166	31	Sarosh	6
14	Kaznik	164	32	Senoc	687
15	Kramovik	1125	33	Vrajake	838
16	Krushë e Madhe	4473	34	Xërxe	3184
17	Mirasor	191	35	Zatnq	535
18	Nagavc	743	36	Zoqshre	659
			TOTALU		56208

Sipar vlersimeve të fundit të ASK 2021, dendësia e popullsisë në komunën e Rahovecit del të jetë rreth 201 banorë në 1 km², ku rreth 55 391 banorë jetojnë në 275.9 km². Brenda territorit të komunës së Rahovecit, ekzistojnë dallime për sa i përket dendësisë së popullsisë.³ Në disa vendbanime që kanë numër më të madh të popullsisë edhe dendësia është shumë më e lartë dhe e kundërta në vendbanimet që kanë numër të vogël të popullsisë edhe dendësia është shumë më e vogël.

Tabela 3 - Dendësia e popullsisë sipas vendbanimeve

Nr.	Zona	Nr. Ban.	Sipërfaqja, në km²	Banor. në 1 km²	Nr.	Zona	Nr. Ban.	Sipërfaqja, në km²	Banor. në 1 km²
1	Rahovec	15892	48.49	328	19	Nushpaj	220	0.64	344
2	Bellacerkë	2270	10.96	207	20	Opterushtë	1911	9.01	212
3	Bërriak	40	4.51	9	21	Pastasellë	1011	5.40	187
4	Bratotin	396	3.11	127	22	Pataqan i Epërm	533	2.33	229
5	Brestovc	1288	5.80	222	23	Pataqan i Poshtëm	1077	5.53	195
6	Celinë	1903	5.72	333	24	Gur i Kuq	731	10.02	73
7	Çifllak	1292	4.76	271	25	Polluzhtë	808	5.66	143
8	Dobidol	799	3.46	231	26	Radostë	2346	10.33	227
9	Dejnë + Baboc	1757	6.43	273	27	Ratkoc	3791	11.82	321
10	Drenoc	1587	8.19	194	28	Retije e Ulet	234	0	0
11	Gexhë	660	3.23	204	29	Retije	771	9.84	78
12	Hoçe e Madhe	124	13.52	9	30	Sapniq	996	4.95	201
13	Hoçe e Vogel	1166	7.05	165	31	Sarosh	6	4.95	1
14	Kaznik	164	8.34	19	32	Senoc	687	4.36	158
15	Kramovik	1125	10.31	109	33	Vrajakë	838	4.94	170
16	Krushë e Madhe	4473	10.00	447	34	Xërxe	3184	10.09	316
17	Mirasor	191	3.17	60	35	Zatnq	535	15.15	35
18	Nagavc	743	3.09	240	36	Zoqshite	659	5.21	127

Dendësia më e lartë e popullsisë paraqitet në vendbanimin Krushë e Madhe, me 447 banorë në km², kjo për shkak se ky vendbanim ka një sipërfaqe prej 10 km². Vendbanimet e tjera me dendësi po aq të madhe, janë: Nushpala, ku mesatarisht jetojnë rreth 344 banorë në një km², Rahoveci me 328 b/km², Celina me 333 b/km² etj.

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË E TJERA

Vendbanimet me shkallë më të vogël të dendësisë së popullsisë janë: Saroshi (1 b/km²), Hoça e Madhe (9 b/km²), Bërnjaka (9 b/km²).


Harta 4: Dendësia e popullsisë në Komunën e Rahovecit (burimi i të dhënave ASK 2011), ankesi i hartave.

Struktura e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë⁴

Komuna e Rahovecit, në aspektin e zhvillimit demografik, ka veçoritë e saj edhe në përbërjen e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë. Në këto struktura kanë ndikuar shumë faktorë demografikë dhe socio-ekonomik dhe janë krijuar shumë karakteristika dhe efekte të tjera sasiore dhe cilësore në zhvillimin demografik. Komuna e Rahovecit ka popullsi kryesisht të re dhe me bazë të zgjeruar të piramidës sipas moshës, edhe pse në periudhat e fundit kohore vërehen disa tendenca me ndryshime të vogla në zvogëlimin e grupmoshave të reja.

Deri në vitet e 90-ta, në komunën e Rahovecit, ka dominuar plotësisht tipi progresiv i popullsisë, ku shkalla e lartë e natalitetit dhe rëniet e vazhdueshme të mortalitetit kanë ndikuar drejtpërdrejt në krijimin e këtij tipi të popullsisë. Ndryshimi i rrethanave socio-ekonomike dhe politike pas viteve të 90-ta, kanë ndikuar në zhvillimin e përgjithshëm demografik të komunës, njëheri edhe me ndryshime në strukturën e popullsisë sipas moshës. Pothuaj gjatë gjithë pjesës së dytë të shekullit të kaluar, piramida e popullsisë së komunës së Rahovecit kishte bazë të zgjeruar me dominimin e grupmoshave 0 deri 4 vjeç. Gjatë analizës së të dhënave demografike, vërehen ndryshime në strukturën e popullsisë. Këto ndryshime mund t'i dallojmë më qartë përmes piramidës së popullsisë.

Grafiku 2- Piramida e popullsisë në komunën e Rahovecit (ASK 2011)



Të dhënat për grupmoshën janë marrë nga ASK 2011 dhe gjithashtu është analizuar edhe numri i lindjeve në periudhën e fundit, ku vërehet një rënie e tyre në krahasim me vitet e mëparshme.

⁴Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Forma e piramidës ndryshon duke u ngushtuar baza e saj dhe kjo si pasojë e dy faktorëve: e migrimeve dhe e tendencave të zvogëlimit të natalitetit. Nga piramida e popullsisë, vërehet se grupmoshat e reja 0 deri 4 vjeç, kanë pjesëmarrje më të vogël në popullsinë e përgjithshme në krahasim me grupmoshën 5 deri 9 vjeç dhe 10 deri 14 vjeç.

Në përgjithësi, grupmoshat e reja të popullsisë (0 deri 19 vjeç), dominojnë dukshëm në popullatën e përgjithshme të komunës, dhe ky është një indikator mjaft i rëndësishëm që tregon se në të ardhmen do të ketë natalitet të lartë, nga fakti se këto grupmosha në të ardhmen japin një përqindje të konsiderueshme të popullsisë fertile që konsiderohet si burim i lindshmërisë.

Mbi 40 % e popullsisë së përgjithshme në Komunë janë me moshë të re 0 deri 19 vjeç, ndërsa grupmoshat mbi 65 vjeç kanë pjesëmarrje më të vogël, me 8.8 % të popullsisë së përgjithshme.

Struktura gjinore e popullsisë, në komunën e Rahovecit, ka karakteristikat e veta me dominim jo të madh të gjinisë mashkullore.

Sic shihet edhe nga grafiku, ekziston një dallim i vogël gjinor në popullsinë e komunës së Rahovecit, ku popullsia mashkullore dominon me 50.7% në krahasim me popullsinë femërore që ka 49.3 % të popullsisë së gjithmbarshme.

SHPËRNDARJA E POPULLSISE NË BAZË TË GRUPEVE ETNIKE NË KOMUNËN E RAHOVECIT - Struktura etnike e popullsisë

Në aspektin etnik, komuna e Rahovecit, ka një popullsi mjaft homogjene, ku mbi 95 % e popullsisë janë shqiptarë

Tab 4- Pjesëmarrja e etnitetve në komunë (ASK 2011)

	Shqipetar	Serb	Turk	Boshnjak	Rom	Ashkali	Egjiptian	Te tjere	Preferojne te mos pergjigjen	Nuk jane ne dispozicion
Rahovec	55166	134	2	10	84	404	299	11	15	83
%	98.15%	0.24%	0.00%	0.02%	0.15%	0.72%	0.53%	0.02%	0.03%	0.15%

Sipas të dhënave nga regjistrimi zyrtar i ASK-së, i bërë në vitin 2011, i cili është regjistrimi i fundit zyrtar për Komunën e Rahovecit, popullsia shqiptare dominon me 98.15 %, ndërsa etnitetet e tjera kanë pjesëmarrje shumë të vogël, serbët me 0.24 % dhe romët me 0.15 %.

2.1 KATEGORITË E BANORËVE TË PLANIFIKUAR PËR EVAKUIM

- Nën at me fëmijë – (Numri i fëmijëve 0 deri 6 vjeç është 6486);
- Nxënësit deri në 14 vjet - (Numri i fëmijëve nga mosh 7 - 14 vjeç është 9595);
- Të moshuarit mbi 70 vjeç janë 2149 banorë;
- Personat me nevoja të veçanta;

VLERËSIMI I RREZIQIEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË E
TERRA

- Aspekti gjinor: Në komunën e Rahovecit, sipas të dhënave të Regjistrimit të vitit 2011, kanë jetuar 56208 banorë, prej tyre meshkuj janë 28512, ndërsa femra 27696 ejt.

2.2 TË PUNËSUARIT, TË PAPUNËT

Papunësia është një ndër problemet me të cilin më së shumti po përballlet shoqëria kosovare. Shkalla e papunësisë në Kosovë është më e larta në rajon. Kjo shkallë e lartë e papunësisë është 44.4%. Vlerësohet se 1/3 e popullsisë së Kosovës është nën moshën 16 vjeç, ndërkaj rreth 60% e popullsisë janë në moshë pune. Kjo shkallë e lartë e papunësisë prek më së shumti femrat, të cilat në bazë të të dhënave statistikore të Ask-së 2011, numri i të punësuarave femra, në Komunën e Rahovecit, arrin diku rreth 11 % nga numri total i të punësuarave. Sipas të dhënave aktuale të drejtorisë përkatëse komunale, në komunën e Rahovecit shkalla e papunësisë është rreth 28.4 %.

Tab 5- Numri i të punësuarave sipas gjinisë

Gjinia	Numri i të punësuarave		%
Meshkuj	7591		89.44%
Femra	896		10.56%
Gjithsej	8487		100.00%

Tab. 6 Numri i të punësuarave sipas gjinisë

Edhe pse nuk ka të dhëna të sakta për shkallën e papunësisë, hulumtimet e ndryshme vlerësojnë se papunësia është e lartë.

Nr.	Vendbanimi	Nr i ndërmarrjeve. tregtare	Nr i të punësuarave	Ndërmarrjet Private	Ndërmarrjet Shogërore
1	Bellacërkë	38	67	38	
2	Bërnjak	2	280	2	
3	Bratotin	2	1	1	
4	Brestovc	4	4	4	
5	Celinë	9	9	9	
6	Çifllak	16	25	16	
7	Dabidol	3	3	3	
8	Dejinë	15	26	15	
9	Drenoc	12	11	12	
10	Gexhë	9	23	9	
11	Hogë e Madhe	-	-	-	5 punëtorë PTK
12	Hogë e Vogël	10	9	10	
13	Kaznik	-	-	-	
14	Kramovik	20	29	20	
15	Krushë e Madhe	86	150	86	5 punëtorë PTK"
16	Mrasor	-	-	-	
17	Nagavc	5	5	5	

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATÛRORE DHE FATKEQËSITË E
TËRA

18	Nushpal	1	1	1	
19	Opterushë	11	9	11	
20	Pastaselë	2	4	2	
21	Patacan i Epërm	1	1	1	
22	Patacan i Ulët	4	4	4	
23	Gur i Kuq	3	2	3	
24	Polluzhë	6	7	6	
25	Radostë	6	8	6	
26	Rahovec	699	1398	699	70 punëtorë "Ambienti,"
27	Ratkoc		114		
28	Reti e Ulët	-	-	69	
29	Retijë	4	4	4	
30	Sapniq	4	4	4	
31	Sarosh	-	-	-	
32	Senoc	7	13	7	
33	Vralak	2	2	2	
34	Xërxë	121	275	121	
35	Zatrig	1	1	1	
36	Zoqisht	4	5	4	

Varfëria në Rahovec

E shkaktuar nga një mori faktorësh, varfëria është e përhapur gjerësisht në Kosovë. Hulumtimet e ndryshme kanë treguar se mbi gjysma e popullsisë së Kosovës jetojnë në varfëri të përgjithshme, ndërsa vetëm një pjesë e vogël e popullsisë jeton në varfëri ekstreme.


Tabela 7 Popullsia mbi moshën 15 vje, dhe statusi aktual i gjendjes ekonomike (ASK 2011)

Bazuar në të dhënat e fundit të regjistrimit	Ekonomikisht aktive	Të punësuar	Të papunësuar, ka punuar më pare	Të papunësuar, nuk kanë punuar kurrë më pare	Të papunësuar, presin të fillojnë punën në të cilën ianë	Ekonomikisht jo aktiv	Total
Gjithsej	14402	8487	1989	3828	98	25725	40127

Sipas hulumtimeve të bëra nga organizata të ndryshme, përkatesisht e UNDP-së, shkalla e përgjithshme e varfërisë në komunën e Rahoveci është 73.54 %, kemi këtë paraqitje të varfërisë:

Grafiku 3- Shkalla e varfërisë UNDP

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË E TJERA




Sipas hulumtimit të lartpërmendur, 12.35% e popullsisë së kësaj komune jetojnë me një dollar në ditë për person, 69.57% e popullatës jeton me dy dollar në ditë për person, në varfëri ekstreme jetojnë 10.86% e popullsisë dhe me varfëri të përgjithshme jetojnë 72.20% e popullsisë. Ndërsa, pas grumbullimit të të dhënave nga Qendra për Punë Sociale për numrin e popullsisë me asistencë sociale, familjeve dhe kryefamiljareve nëna me asistencë sociale dhe analizave të bëra, na paraqitet shkallë e lartë e varfërisë ekstreme. Këto të dhëna, na ndihmojnë sadopak në paraqitjen e gjendjes ekzistuese të popullsisë për secilin vendbanim të komunës.

Sipas të dhënave, del se në komunën e Rahovecit ekzistojnë 2581 persona apo 590 familje që jetojnë me asistencë sociale, që nënkupton se kjo pjesë e popullsisë jeton në varfëri ekstreme. Ndërkaq, varfëria e përgjithshme përfshinë një përqindje më të madhe të popullsisë.

Me shkallë më të lartë të varfërisë është e prekur gjinia mashkullore me 75%, kurse me asistencë sociale 25% janë kryefamiljare nëna. Kjo shkallë e lartë e varfërisë është e shtrirë gjerësisht në tërë territorin. Për më tepër, shih grafikomin:

Grafiku 4. Popullsia me asistencë sociale



Vendbanimet që kanë përqindje më të vogël të popullsisë me asistencë sociale janë: Bellacërka, Nashpalla, Radosia, Sapniqi, Zoqishti, Polluzha, Krusha e Madhe, Kramoviku, Brestovci dhe Bratotini. Ndërsa vendbanimet me përqindje më të madhe të popullsisë me asistencë sociale janë: Kazniku, Senoci, Zatriqi, Guri i Kuq dhe Dobidoli.

Në shkallën e lartë të varfërisë kanë ndikuar një mori faktorësh: shkatërrimet e luftës, shkalla e lartë e papunësisë, niveli i ulët i zhvillimit ekonomik, të ardhurat e vogla për kokë banori, arsimimi i pamjaftueshëm, etj.

VLERESIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQESITE NATYRORE DHE FATKEQESITE E TJERA

Bazuar edhe në të dhenat statistikore (ASK 2011) tregojnë qartë shkallën e varfërisë në komunë.

Tabela 1 - Burimi kryesor i jetesës (ASK 2011)

	Puna (përfshirë punën në pronën,biznesin e tij apo të familjes)	Patundshmëri, investime (qira, interes)	Pension	Ndihma sociale	Transfere të tjera (përfitime nga papunësia, sëmundja dhe lehonja,bursë)	Remetanca (të ardhura nga familjarët ne shtete të tjera)	Mbështetje nga persona të tjerë	Burime tjera të tjera
Gjithsej	21791	159	2662	1683	120	4014	23849	1930

Pensionistët

Numri i përgjithshëm i shfrytëzuesve të pensionit në komunë është 4182..

Numri i pensioneve bazike të moshës në komunën e Rahovecit ishte 4182 përfitues.

Numri i pensioneve kontribut-paguese të moshës në komunën e Rahovecit ishte 793 përfitues.

Asistenca sociale

Tab.9 Numri i familjeve dhe i anëtarëve me asistencë sociale⁵

Nr. Familjeve	Nr. Ant. Familjes
664	2696

3. TË MIRAT MATERIALE, KULTURORE DHE TË MJEDISIT

3.1. TRASHËGIMIA KULTURORE

Komuna e Rahovecit, së bashku me disa komuna të Kosovës, janë të pasura me lokalitete dhe monumente arkeologjike të trashëgimisë natyrore e kulturore. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, respektivisht Departamenti i Trashëgimisë Kulturore, është institucioni përgjegjës për fuqjen nën mbrojtje të monumenteve në territorin e Kosovës. Lista e Trashëgimisë Kulturore përpilohet nga ana e Qendrave Regjionale për Trashëgimi Kulturore (QRTK), që janë në varësi të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Lista e Objekteve të Evidentuara - paraget listën e monumenteve të evidentuara nga përgjegjësit e QRTK-ve në Kosovë, me rastin e hulumtimit në terren.

⁵ <https://ask.rks-gov.net/media/7048/statistikat-e-mir%C3%ABqenies-sociale-gusht-2022.pdf>

⁶

VLERESIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYKORE DHE FATKEQËSITË E TJERA

Në Komunën e Rahovecit gjenden gjithsej 70 objekte të evidentuara gjatë viteve 2002-2003.

Lista e Monumenteve nën mbrojtjen e trashëguar nga periudhat e mëparshme - (nga pushteti Jugosllav) e cila është bartur direkt në listën e mbrojtjes. Nga kjo listë, në Komunën e Rahovecit gjenden 9 lokalitete në kategorinë Trashëgimia Arkeologjike dhe 1 monument në kategorinë Trashëgimia Arkitekturore.

Lista e Trashëgimisë Kulturore në Mbrojtje të Përkohshme - paraqet listën zyrtare të miratuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Në listën e fundit të Trashëgimisë Kulturore nën Mbrojtje të Përkohshme (2020-2021) - në Komunën e Rahovecit janë përfshirë monumentet e trashëgimisë arkeologjike, lokalitetet arkeologjike dhe monumentet e trashëgimisë arkitekturale. Duhet pasur parasysh se kjo listë zyrtare e MKRS-së çdo vit ky plotësim duhet të reflektohet edhe në vendimmartjen komunale dhe atë qendrore lidhur me planifikimin hapësinor.

Kategoria: Trashëgimia Arkeologjike
Nënkategoria: Monument/Ansambël
Tab.10 Trashëgimia arkeologjike

Emërtimi	Periudhat	Vendi	Nr. Unit në Databazë
Kisha e Shortarisë (Manastiri i Zoçishtës)	Mesjete	Zoçishtë	003126
Kisha Bërñaçë	Mesjete	Bërñaçë	003132
Rrenojat e kishes mesjetare	Shekulli XVI-XVII	Opterushë	004669

Tab.11 Lokalitetet arkeologjike

Nënkategoria: Lokalitet Arkeologjik/Rezervat			
Emërtimi	Periudhat	Vendi	Nr. Unit në Databazë
Kisha varrezore e Shën Nikollës	Mesjetë	Hoçë e Madhe	0031/28
Kisha varrezore e Shën Gjjonit	Mesjetë	Hoçë e Madhe	0031/29
Lokiteti Arkeologjik romak në Pozhigë	Romake	Bellacerk	003009
Gërmadhat e Kishës "Shpëtimi i Shenjtë"	Mesjetë	Opterushë	003134
Gërmadhat e Gjyçetit	Parahistori, Antikë	Zatriq	003017
Gërmadhat e kishës së Shën Lukës	Mesjetë	Hoqë e Madhe	003000
Këshqjella	Antikë e Vonë	Gexhë	002995
Varrezë Mesjetare	Mesjetë	Vranjak	003427
Varrezë Mesjetare	Mesjetë	Celinë	003428
Terma-Banjo Romake	Shek.I-IV	Çifllak	003429
Vendbanim parahistorik dhe romak në vendin e quajtur "Maqinë"	Parahistori	Rahovec	004184
Vendbanim neolitik i Opterushës	Parahistori	Opterushë	004185
Tuma dhe vendbanim në Pastasellë	Parahistori	Pastasellë	0041081
Vendbanim neolitik në Pastasellë	Parahistori	Pastasellë	004182
Vendbanim romak në Pastasellë	Romake	Pastasellë	004183
Vendbanim romak i Senocit	Romake	Senoc	004186
Këshqjella në Gexhë	Parahistori-antikitet i vonë	Gexhë	002995

VLERËSIMI I RREZIQEVENGA FATKËQËSITË NATYRORE DHE FAKËQËSITË E TJERA

Tab 12 Trashëgimia arkitekturore

Kategoria: Trashëgimia Arkitekturore				
Nënkategoria: Monument/Ansambël				
Emërtimi	Periodhat	Vendi	Nr. Unit në Databazë	
Teqja Halveti	Shek.XIX	Rahovec	001774	
Kullë-Shtëpi e Qamii Vuçitërnës	Shek.XX	Rahovec	001789	
Kulla e Hajrulla Qantës	Shek. XVIII	Rahovec	001791	
Kroni I Vjetër	Shek. XVIII	Rahovec	001792	
Teqja e Melamive	Shek. XIX	Rahovec	001793	
Kulla e Sahatit	Shek. XVIII	Rahovec	001768	
Xhamia e Kasumit	Shek. XIX	Rahovec	001772	
Xhamia e Sokollit	Shek. XVIII	Rahovec	001773	
Xhamia e Zatriqit	Shek. XVIII	Zatriq	001798	
Konaku i Manastirit të Deganit	Shek. XVIII	Hogë e Madhe	003412	
Shtëpia e familjes Spasiq	Shek. XIX	Hogë e Madhe	003413	
Xhamia e Pastasellës	Shek. XIX	Pastaselle	001083	
Kulla e Ismet Cmegës	Shek. XIX-të	Rahovec	003414	
Minarja e Xhamisë së fshatit	Shek. XVIII-të	Drenoc	001805	
Xhamia e Xërrës	Shek. XVIII-të	Xërxe	001806	
Ura e Gurit	Shek. XIX-të	Bellacërk (Fortesë)	003415	
Xhamia e Kasumit	Shek. XIX-të	Rahovec	001769	
Xhamia e Sokollit	Shek. XVIII-të	Rahovec	001772	
Rrënojat e xhamisë së fshatit Brestoc	Shek. XVI	Brestoc	001763	
Tyrbja e Dervish Avdlut dhe Ahmatit	Shek. XVIII-XIX	Rahovec	004124	
Kulla e Mehmet Pashës	Shek. XIX	Opterushë	001767	
Shtëpia Muze – Ukshin Hoti	Shek. XX	Krushë e Madhe	004308	
Kullë	Shek. XIX	Kramovik	004508	
Kroi i Gurit në Rahovec	Shek. XIX	Rahovec	004760	

Tab. 13 Fusha e konzervimit arkitekturo

Nënkategoria: Fusha e konzervimit arkitekturo				
Emërtimi	Periodhat	Vendi	Statusi	Nr. Unit në Databazë
Fshati Hogë e Madhe	-	Fshati Hogë e Madhe	LZVM	-

Lista e Objekteve Sakrale

Në bazë të të dhënave komunale, objektet sakrale, që janë në vendbanimet e komunës së Rahovecit, janë:

Tabela 14- Objektet sakrale

Nr	Likacioni	Objekti	Viti i ndërtimit	Vërejtje
01	Rahovec	Xhami e vjetër, tani e re	1606	Ndërtimi i ri 2000-2005
02	Rahovec	Xhami e vjetër, tani e re	1720	2006-2008
03	Rahovec	Xhamia e Kasumit	1826	

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË E
TJERA

04	Rahovec	Xhamia e Haxhi Qamil Kasapit	1994/96	
05	Rahovec	Xhamia e Sokollit	1824	
06	Xërxë	Xhami	1797	
07	Fotesë		1810	
08	Krushë e Madhe		XIX-XX	
09	Celinë		1919	
10	Hoçë e Vogel		1920	
11	Brestovc		1598	2007-2008
12	Opterushë		1860	
13	Reti		1945	
14	Reti e Ulët		1947	
15	Drenovc		1710	
16	Pastasel		1820	
17	Zoqishtë		1990	
18	Nagavc		1997	
19	Malësi e Vogel		2004-2005	
20	Ratkoc			
21	Guri i Kuq			

Tabela 15- Objektet sakrale dhe lokacionet e tyre

Nr	Lokacioni	Objekti	Viti i ndertimit
01	Rahovec	Teqe e Melamive Qarshi	XIX
02	Rahovec	Teqe e Helvetive	1732
03	Rahovec	Telqe e Rufai	XX

Tabela 16, Lokacioni i objekteve fetare - Tyrbeve

Nr	Lokacioni	Objekti	Viti i ndertimit
01	Rahovec	Tyrbe	
02	Patagan i Ulët	Tyrbe	XVIII
03	Polluzhë	Tyrbe	XIX
04	Hoçë e Vogel	Tyrbe	
05	Dejne	Tyrbe	
06	Dobidol	Tyrbe	

Tabela 172- Llojet e objekteve sakrale sipas vendbanimeve

Nr	Lokacioni	Objekti
01	Rahovec	Kishë – 1
02	Bërnjak	Kishë – 1
03	Hoçë e Madhe	Kishë – 7
04	Zoqishtë	Kishë – 1

Monumentet natyrore⁶

Llojllojshmëria e monumenteve natyrore të karakterit botanik, hidrologjik, gjeomorfologjik të komunës së Rahovecit, si dhe peizazheve të ndryshme natyrore, që kanë përhapje në territorin e komunës, konsiderohen vlera të trashëgimisë natyrore.

Për shkak të vlerave natyrore, janë propozuar për mbrojtje edhe këto monumente të natyrës:

- 1. Kaznik – Trungu i Frashërit (Francinus excelsior)
 - 2. Kaznik – Trungu i Shpardhit (Quercus fraineto)
 - 3. Drenoc – Trungu i Shpardhit (Quercus fraineto)
 - 4. Nagavc – Trungu i Bungut (Quercus petraea)
 - 5. Bratotin – Trungu i Qarrit dhe Trungu i Vidhit (Quercus cerri & Ulmus minor)
- Trungu i Shpardhit (Quercus fraineto)

Burime të ujit - 2 (burime), çerdhe për zogj gjahu - 1, Mogalishte - 1, Monumente natyrore - 1, Varrezat e dëshmoreve/Lapidar - 1.

Janë hasur edhe gjurmë të kafshëve të egra të mëdha grabitqarë- pastaj shpezë grabitqarë, drunjt të vjetër, puse të ujit për pije etj.

Harta 5 Disa monumente natyrore dhe kulturore në komunën e Rahovecit (Burimi i të dhënave draft - PZHK-Rahovec). Aneksi i hartave

3.2. PARQET NACIONALE

3.2.1 PARQET NATYRORE DHE REZERVATET

Në territorin e komunës së Rahovecit, shtrihet një pjesë e sipërfaqes së zonës së mbrojtur të Kanionit të Drinit të Bardhë të Ura e Fshejt, monument natyror me karakter hidro - gjeomorfologjik që është shpallur në vitin 1986, me sipërfaqe 126,5 ha dhe Parku regional i Mirushes 198,77 ha 1983, monument natyre me ujëvara të njëpasnjëshme.

3.2.2 SIPËRFAQET PYJORE

Pyjet në komunën e Rahovecit kanë sipërfaqe prej 7,692 ha⁷, ku hyjnë pyjet e dendura dhe ato me intensitet më të ulët që janë vetëm 27 % pronë e komunës . Një sasi e madhe e pyjeve të dendura gjendet në katër rajone: Kaznik, Zairiq, Rahovec dhe Opterushë.

Tab 18. Sipërfaqet me Pyje

Nr	Njësite pyjore	Sipërfaqe	Llojet e drunjeve
1	Kaznik	2,052.6 ha	Pishë, Shkozë, Bungu
2	Zairiq	3,029.6 ha	Shkozë, Bungu
3	Rahovec	1,227.7 ha	Pishë, Shkozë, Bungu dhe Haloret

⁶Plan i Zhvillimit Komunal 2011-2020
⁷ Draft- PZHK-ja e Komunës së Rahovecit

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË E
TJERA

4	Opterushë	1,129.7 ha	Shkozë, Bungu
5	Çifllak -Xërrë – Krushë	252.4 ha	Shkozë, Bungu

Në komunën e Rahovecit, duke pasur parasysh nivelin e rrezikut nga zjarret në pyje, gjatë këtyre viteve të fundit, jemi detyruar të marrim masa për mbrojtje nga zjarri, pasi është rrezik permanent shkatërrimi i florës dhe i faunës.

Fauna jonë është e pasur me lloje të ndryshme, si: rregebulli, dhelpra, derri i egër, ariu, lepujt, si dhe zogjtë shtegtar së bashku me folejtë e tyre që ndodhen në komunën tonë e posaçërisht në pyje të larta.

Sektori i pylltarisë, konsiderojmë që duhet të përfshijë edhe pyjet, së bashku me tokat pyjore në territorin e komunës tonë, sepse janë tri aspekte me prioritet:

- aspekti ekonomik;
- aspekti social;
- aspekti mjedisor.

Në pjesën qendrore të NJM-së, në Zatriq, gjendet pika më e lartë me lartësi mbi nivelin e detit 1013 m vendi i quajtur „Gradishtë” ndërsa vendi më i ulët po në NJM, te lumi , “Drini i Bardhë” me lartësi mbidetare 359 m.

Sipërfaqja e tërësishme pyjore e tanishme është: 7,692 ha.

Tabela 19- Sipërfaqet aktuale pyjore

Tokë Pyjore		Sipërfaqe në Ha
1	Pyllëzime artificiale	37.10
2	Pyll cunigshte	4,560.90
3	Shkurre dhe sipërfaqe joproduhese	3,094.00
Gjithsej		7,692.00

Llojet e drurit (Trungjet - kategorizimi i tyre)

Shpërndarja e llojeve të drurit është e dominuar nga lloje te qarri, të bungut dhe të shkozës.

Lloj dominues është lloji i shkozës me pjesëmarrje prej 44% të vëllimit të përgjithshëm, qarri 39% , bungu 10%, llojet e gëthoreve 4%, pisha e zezë 3%, e vëllimit të përgjithshëm.

Duke marrë në konsideratë kushtet natyrore dhe përbërjen pedologjike të tokës, këto pyje ofrojnë kushte relativisht te mira për pyjet e dushqeve.

Harta 6: Sipërfaqet me pyje në Komunën e Rahovecit (Digitalizim nga Ortofotot 2018),

Aneksi i hartave, *Aneksi i hartave.*

3.2.3 ZONAT E MBROJTURA DHE TRASHËGIMIA NATYRORE

Përpos begative të tjera në territorin e Komunës së Rahovecit gjendet edhe monumenteve natyrore të karakterit botanik, hidrologjik, gjeomorfologjik me një sipërfaqe prej 126.5 ha, që karakterizohet me lloje të shumta të florës, vegetacionit dhe faunës.

Llojlloshmëria e monumenteve natyrore të karakterit botanik, hidrologjik, gjeomorfologjik të Komunës së Rahovecut, si dhe peizazheve të ndryshme natyrore, që kanë përhapje në territorin e komunës konsiderohen vlera të trashëgimisë natyrore.

Për shkak të vlerave natyrore janë propozuar për mbrojtje edhe këto monumente të natyrës:

1. Kaznik – Trungu i Frashërit (Francinus excelsior)

2. Kaznik – Trungu i Shpardhit (*Quercus frainetto*)
3. Drenoc – Trungu i Shpardhit (*Quercus frainetto*)
4. Nagavc – Trungu i Bungut (*Quercus petraea*)
5. Bratoin – Trungu i Qarrit dhe Trungu i Vidhit (*Quercus cerris* & *Ulmus minor*)
- Trungu i Shpardhit (*Quercus frainetto*)

Burime të ujit-2 (burime), çerdhe për zogj gjahu-1, Mocalishte-1, Monumente natyrore-1, Varrezat e dëshmoreve/Lapidar-1.

Janë hasur edhe gjurmë të kafshëve të egra të mëdha, grabitqarë, si: ariu dhe ujku, shpezë grabitqarë, drunjtë vjetër, puse të ujit për pije etj.

3.3. ZONAT E PRODHIMITARISË BUJQËSORE

3.3.1 ZHVILLIMI BUJQËSOR DHE RURAL

Duke marrë parasysh kushtet e favorshme topografike⁸, klimaitke dhe agro-ekologjike puna në bujqësi, vreshtari dhe verari përbën aktivitetin themelor ekonomik në Rahovec në të gjitha aspektet, duke përfshirë prodhimin, burimin e të ardhurave dhe punësimin.

Rreth 90% të tokës së komunës së Rahovecit përdoret si tokë punuese për bujqësi, e sidomos tokat kodrinore që përdoren si territore vreshtare. Toka e punueshme prej total 14000 ha, është e mbuluar me sistem të ujitjes nga Drini i Bardhë në sipërfaqe prej 3500/Ha. Rreth 70% e popullsisë në qytet dhe fshat sigurojnë ekzistencën nga aktivitetet bujqësore si në vreshtari, perimtar, etj.

Territori i komunës së Rahovecit përfshihet në regionin e Gjakovës dhe është i ndarë në tri tërësi ose mikroregjione e këto janë: rrafshinë-luginore, kodrinore dhe malore.

3.3.2 ZONAT E PRODHIMIT BUJQËSOR

Sipas përbërjes pedologjike të tokës, territori i komunës së Rahovecit ofron mundësi të prodhimitarisë së llojllojshme të kulturave bujqësore, të cilat shtrihen në këto zona:

1. Zonat Humusore – të përshatshme për kultivimin e bimëve të lavëtarisë (grurë, misër etj) dhe bimëve industriale (pangjari i sheqerit, luledielli, duhani etj.);
2. Zonat Aluviale – të përshatshme për kulturat e perimtarisë;
3. Zonat e tokës së kuqe – të përshatshme për kultivimin e vreshtarisë dhe të pemëtarisë;
4. Zonat Gëlqerore-kodrinore (smonicë) – të përshatshme për kultivimin e hardhisë së rrushit.

Bujqësia e komunës së Rahovecit ka një perspektivë të madhe për zhvillimin e saj, duke marrë parasysh kushtet klimatike, të përbërjes tokësore dhe kushteve hidrografike, sistemin e ujitjes dhe traditën e popullatës që merret me bujqësi.

Të gjitha degët e bujqësisë në komunë, aktualisht janë më të avancuara në sektorin privat – individual, ndërsa funksionimi i saj në sektorin publik ka shënuar një rënie të konsiderueshme, si pasojë e shndërrimit të tokave bujqësore në tokë ndërtimore dhe mungesa e politikave të qëndrueshme zhvillimore dhe fiskale në sferën e bujqësisë. Në këtë pikë ka ndikuar edhe politika

⁸ Tokë punuese - 14000 ha, të konfiguruarani të rrafshët -luginor/ 80.6 km² apo 29.17%, kodrinore 162.2 km² apo 58.70%

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË E
TIERA

nacionale me procesin e privatizimit, ku shumë toka bujqësore nga pronësia publike kanë kaluar në sektorin privat.

3.3.3 KULTIVIMI I BIMEVE NJË - VJEÇARE (TË KORRAT)

Në komunën e Rahovecit kultivohen kulturat një-vjeçare, si: specë, patate, domate, qepë, lakra, tranguj karrota, hudsonia, patellxhan, spinaq, pjepër e çej, përdërisa si kultura; misri, fasulla dhe kungulli, ku arrijnë rezultate të larta sidomos në sipërfaqen e cila është nën sistemin e ujërës.

Tab 20 Kulturat bujqësore një-vjeçare

Kultura	Sipërfaqe/ha	Rendimenti kg/ha	Vërejtje
Gruri	1750.00	3.500 kg/ha	Në perspektivë
Perime	1,573.84	35.000 kg/ha	Në perspektivë
Misri	901.83	5.600 kg/ha	
Prodhimi i fidanëve	50.00	200.000 copë/vit	
Pemë të imëta	17.74	6.000 kg/ha	
BMA	14.84	8,000kg/a	Në perspektivë

3.3.4 KULTIVIMI I KULTURAVE BUJQËSORE SHUMËVJEÇARE

Tab 21 Kulturat bujqësore shumëvjeçare

Kultura	Sipërfaqe/ha	Rendimenti kg/ha	Vërejtje
Pemëtari	127.06	10.000 kg/ha	
Vreshta	2,342.53	16.000 kg/ha	Në perspektivë

3.3.5 SKEMA E TREGUESHËVE SPECIFIKË RURALE

Të dhënat e përgjithshme të fermerëve të komunës së Rahovecit: 2020, 2021 dhe

2022. Tab 22 Kulturat lavëtarisë për komunën e Rahovecit

Të dhënat e fermerëve		2020	2021	2022	Diferenca
Sektor i Lavëtarisë		Sip. në ha	Sip në ha	Sip në ha	Sip. në ha
1	Grurë	1929.14	1,041.66	2,006.21	964.55
2	Misër	1602.7	901.83	1,578.94	677.11
3	Elb	2.61	12.64	4.05	-8.59
4	Tërshërë	48.93	63.68	122.04	58.36
5	Thekër	2.62	0.00	0.00	0.00
Gjithsej		3,586.00	2,019.81	3,711.24	1,691.43
Sektor i Vreshtarisë					
	Lloji i kulturës	Sip ne ha	Sip ne ha	Sip ne ha	

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË E TJERA


2	Rrush	2,406.61	2,342.53	2,322.21	-20.32
3	Fidane të hardhise	148,000.00	248,000.00	149,900.00	-98,100.00
Sektor i Perimkulture -5		Sip. ne ha	Sip. ne ha		
1	Speca	830.46	657.83	695.30	37.47
2	Domate	19.07	7.43	11.48	4.05
3	Qepë	188.90	191.89	149.76	-42.13
4	Hudhër	33.47	21.08	25.56	4.48
5	Patate	227.87	126.46	166.35	39.89
6	Tranguj	10.43	1.55	0.43	-1.12
7	Karota	11.50	9.83	7.65	-2.18
8	Rrepkë	0.50	0.00	0.00	0.00
9	Brokulli	0.00	0.40	0.25	-0.15
10	Fasule	1.55	0.21	0.46	0.25
11	Panxhar	0.00	0.00	0.00	0.00
12	Lakër	99.43	86.07	144.20	58.13
13	Lulelakër	9.77	8.61	10.82	2.21
14	Presh	4.21	0.00	0.20	0.20
15	Spinaq	0.22	0.87	0.84	-0.03
16	Marule	1.26	1.71	0.64	-1.07
Gjithsej		1,438.64	1,113.94	1,213.94	100.00
Kungullore		Sip. ne ha	Sip. ne ha		
1	Shalqinj	205.36	178.04	164.68	-13.36
2	Pjepër	57.61	52.62	100.24	47.62
3	Kunguj	18.07	12.80	11.82	-0.98
4	Kungull i gjelbër	319.46	214.39	302.84	88.45
Gjithsej		600.50	457.85	579.58	121.73
Sektor i Pemtariisë		Sip. ne ha	Sip. ne ha		
1	Dardhë	6.58	7.43	6.63	-0.80
2	Dredhëz	0.66	2.51	2.72	0.21
3	Kumbull	40.65	38.69	54.86	16.17
4	Mollë	10.01	8.15	8.96	0.81
5	Arra	30.08	57.88	73.90	16.02
6	Lajthi	4.94	9.90	10.77	0.87
7	Ftonj	0.92	3.51	4.17	0.66
8	Mjedër	1.01	0.71	0.53	-0.18
9	Pleshkë	1.07	1.50	2.69	1.19
Gjithsej		95.92	130.28	165.23	34.95

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKËQËSITË NATYRORE DHE FATKËQËSITË E TIERA

Sektor i Blegtorisë dhe i shpezëtarisë					
1	Bletë	6,802.00	5,577.00	4,245.00	-1,332.00
2	Lopë	2,598.00	2,335.00	1,938.00	-397.00
3	Dhi	834.00	864.00	248.00	-616.00
4	Dele	8,886.00	8,142.00	7,226.00	-916.00
5	Pula vojëse	74,300.00	43,360.00	59,100.00	15,740.00
Nr.	Lloji i kulturës	Sip ne ha	Sip ne ha		
1	BMA	14.84	14.52	16.51	1.99

Perime në Serra					
1	Perime	16.50	18.70	24.26	5.56

Graf 5. Sipërfaqja e kulturave bujqësore 2020-2022 në hektarë



3.3.6 FERMAT BUJQËSORE

3.3.7 NUMRI, LLOJI DHE KAPACITETET E FERMAVE

Tab 23. Gjendhat, koncentrimi

	Koncentrimi (nr.)			Trendet e rritjes/ zvogëlimit- viti:	
	Njësia matëse	2020.00	2021.00	2022.00	2022-2021

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKËQËSITË NATYRORE DHE FATKËQËSITË E TJERA

Lopë	Krerë	2598.00	2335.00	1938.00	-263.00	-397.00
Mëshqerë		306.00	252.00	236.00	-54.00	-16.00
Gjithsej		2904.00	2587.00	2174.00		

Dela, koncentrimi

	Nj. matëse	Koncentrimi (nr.)			Trendet e rritjes/ zvogëlimit- viti:	
		2020	2021	2022	2021-2020	2022-2021
Dela	krerë	8886.00	8142.00	7226.00	-744.00	-916.00
Gjithsej		8886.00	8142.00	7226.00		

Dhitë, koncentrimi

	nj matëse	Koncentrimi (nr.)			Trendet e rritjes/ zvogëlimit- viti:	
		2020	2021	2022	2021-2020	2022-2021
Dhi	krerë	834.00	864.00	248.00	30.00	-616.00
Gjithsej		834.00	864.00	248.00		

Shpendët, koncentrimi

	Nj. matëse	Koncentrimi (nr.)			Trendet e rritjes/ zvogëlimit- viti:	
		2020	2021	2022	2021-2020	2022-2021
Pula vojëse	copë	74300.00	43360.00	59100.00	-30940.00	15740.00
Gjithsej		74300.00	43360.00	59100.00		

3.4. ZONAT INDUSTRIALE DHE OBJEKTET EKONOMIKE

3.4.1 VENDNDODHJA DHE VEÇORITË E ZONËS INDUSTRIALE

Sektor i industrisë në Komunën e Rahovecit, bazohet kryesisht në industrinë agro-industriale, përpunimin e rrushit dhe të grurit, industrinë e plastikës, të ndërtimtarisë, teknologjinë përpunuese të metaleve, teknologjinë për ngrohje dhe ftohje, artizanate, tregti, shërbime etj. Pas luftës, ndërtarjet e vogla kanë shfaqur tendencën për shfrytëzimin dhe përpunimin e gurit, rërës, zhavori dhe argjilës, evidente me një shkatërim josesektiv të resurseve.

Duke e pasur parasysh nivelin e përgatitjes profesionale dhe shpirtin ndërmarrës, shumë individë kanë filluar me biznese individuale dhe familjare duke trasuar rrugën për një të ardhme dhe duke u bazur në ekonominë e tregut, si e vetmja perspektivë zhvillimore.

Në sektorin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme ekziston një asistencë e konsiderueshme e organizatave vendore dhe ndërkombëtare, të cilat janë përkushtuar për stabilizim dhe profesionalizim të ekonomisë. Organizatat ofrojnë asistencë për të zhvilluar prodhime të reja, si dhe tregun për to.

Gjendja ekonomike e bujqve është mjaft e rëndë. Përpas tregut të reduktuar 15, kemi të bëjmë me një import të pakontrolluar dhe joselektiv të produkteve bujqësore, gjë që i sjell prodhuesit tanë të pemëve dhe të perimeve në pozitë mjaft të rëndë.

3.4.2 AGROBIZNESI

Pasi bujqësia ka qenë gjithmonë degë e rëndësishme e ekonomisë së komunës së Rahovecit, vërehet se ende ka interesim për t'u angazhuar në këtë veprimtari, edhe sipas kushteve të favorshme natyrore dhe traditës. Shumica e prodhuesve merren me ekonomi bujqësore familjare, dhe prodhues të organizuar në ndërmarrje bujqësore.

Bujqësia vazhdon të jetë një ndër sektorët me potencial të madh e të rëndësishëm në rrirjen e ekonomisë dhe të sigurisë së ushqimit. Sektorët të cilët vazhdojnë të kenë kushte të favorshme dhe me rendimente në rrirje janë: sektori i perimkulturës, i vreshtarisë dhe drithërat.

Vitet e fundit në komunën tonë kultivohen rreth 2,300 ha me perime në të cilat kultura e specit është bima perimore e cila zë sipërfaqe më të madhe sa i përket kultivimit me rreth 700 ha, qepa me rreth 230 ha e pas kësaj vjen patatja me 220 ha, si dhe kultura e tjera në sipërfaqe më të vogël. Duke filluar nga pozita gjeografike, lartësia mbidetare, relievi dhe kushtet e tjera klimatike, komuna e Rahovecit ka një pozitë mjaft të përshatshme për kultivimin e hardhisë së rrushit. Rreth 2,400 ha me hardhi të rrushit janë të mbjella vetëm në komunën e Rahovecit, ku prej tyre 75% janë me rrush të verës, ndërsa 25% me rrush të tryezës.

Poashtu, në komunën e Rahovecit, sipërfaqe të konsiderueshme të mbjelljeve bujqësore zë edhe sektori i drithërave. Në sipërfaqen totale prej 2,500 ha, të kultivimit të drithërave, kultura e grurit kryeson me rreth 1,500 ha, duke u pasuar nga misri me mbi 900 ha, si dhe kultura e tjera, si: elbi, thekra, tërshtëra, etj.

3.4.3 TURIZMI

Vlerësimi i gjendjes – Turizmi është më pak i zhvilluar, edhe pse Rahoveci është njëri ndër qytetet më të vjetra të Kosovës, me relikte të vendbanimeve të dikurshme antike, të cilat rrjedhin nga epoka e hershme romako-ilire.

Në përgjithësi, Zona e Dukagjinit është përplojt me trashëgimi arkitekturore, shpirtërore, fetare, etnologjike etj. Poashtu, resurse për një turizëm rekreativ ekzistojnë në kanionin e Drinit të Bardhë. Turizmi kulturor kryesisht mund të jetë i bazuar në trashëgimi kulturore/arkitekturore: shëtitë tradicionale, turizëm kulturor arkeologjik, shpella, hamame, trashëgimi arkitekturore dhe fetare në Hoçën e Madhe, e cila tashmë është edhe e mbrojtur me pakon e Ahisarit, nga e cila derivon dhe Ligji për Mbrojtjen e Zonave të Veçanta të Mbrojtura dhe në hartim e sipër pënderisa flasin është Ligji për Hoçën e Madhe.

3.4.4 SEKTORI PRIVAT/ KOMUNITETI I BIZNESIT

Sektori i industrisë në komunën e Rahovecit, bazohet kryesisht në industrinë agro-industriale, përpunimin e rrushit dhe të grurit, industrinë e plastikës, ndërtimtarisë, teknologjinë përpunuese të metaleve, teknologjinë për ngrohje dhe ftohje, artizanate, tregti, shërbime etj. Pas luftës, ndërmarrjet e vogla kanë shfaqur tendencën për shfrytëzimin dhe përpunimin e grurit, të rërës, të zhavorit dhe të argjilës, evidente me një shkatërim joselektiv të resurseve.

Duke e pasur parasysh nivelin e përgatitjes profesionale dhe shpirtin ndërmarrës, shumë individë kanë filluar me biznese individuale dhe familjare duke trasuar rrugën për një të ardhme dhe duke u bazuar në ekonominë e tregut, si e vetmja perspektivë zhvillimore.

Në sektorin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, ekziston një asistencë e konsiderueshme e organizatave vendore dhe ndërkombëtare, të cilat janë përkushtuar për stabilizim dhe profesionalizim të ekonomisë.

Organizatat ofrojnë asistencë për të zhvilluar prodhime të reja, si dhe tregun për to. Përkrahja gjithashtu vjen edhe nga institucionet gjegjëse të nivelit institucional, me qëllim të krijimit të një mjedisi favorizues për zhvillimin ekonomik. Kjo i referohet, sikur është përmendur më parë, arsimimit profesional, certifikimit të standardeve profesionale, standardeve për kualitet në menaxhim, prodhimtarisë, prodhimeve, etj. Të gjitha këto aktivitete kontribuojnë në stabilizimin e NVM-së, si bazë e rëndësishme e ekonomisë së Kosovës, gjegjësisht e qytetit të Rahovecit, duke sjellë sa më shumë prodhime kosovare në treg dhe duke ofruar mundësi të reja punësimi.

Bujqësia si degë e ekonomisë, është bartëse e zhvillimit ekonomik në komunën tonë dhe si e tillë duhet t'i kushtohet vëmendje e posaçme, si nga udhëheqësia komunale ashtu edhe ato shtetërore. Pjesa më e madhe e banorëve në komunën tonë, merren me kultivimin, grumbullimin dhe përpunimin e perimeve si dhe kultivimin e kulturave lavëtare dhe të vreshtarisë.

Sipas shënimeve të Entit Statistikor, komuna jonë disponon me 13.600 hektarë tokë bujqësore. Sipërfaqja e tokës bujqësore, e cila gjendet përgjatë shtetit të lumit Drini i Bardhë, në lartësi mbidetare prej 310 – 350 m, është tokë alluviale me pjellori të lartë, në të cilat kultivohen kulturat bujqësore intenzive, siç janë perimekultura (speci, domate, patate, tranguj, shalqini, karota e të tjera) dhe kulturat lavëtare (gruri, misri). Në tokat kodinore, në lartësi mbidetare prej 350 – 600 m, gjendet toka e tipit Smonice, ku kultivohen kulturat lavëtare pranverore dhe vjeshtore, kulturat shumëvjeçare, ku bëjnë pjesë edhe kullosat. Por, duke pasur parasysh ndërtimin e objekteve të ndryshme në tokat bujqësore, siç janë: objektet e banimit, objektet hoteliere, pompat e benzines dhe objektet e ndryshme industriale, si dhe eksplotimin e zhavorit në tokat bujqësore, kjo ka ndikuar që sipërfaqet e tokës bujqësore të zvogëlohen gradualisht, duke u shndërruar në tokë ndërtimore, prandaj, planifikimin e mbijeljeve vjeshtore dhe ato pranverore nuk mund t'i planifikojmë në mënyrë të saktë.

3.4.5 SHOQATAT AFARISTE

Komuna e Rahovecit posedon shoqatën e Venarëve (Prodhuesit e Vererave) Shoqatën e Gjuetarve, Shoqatën e Bizneseve etj.

3.5. OBJEKTET

3.5.1 OBJEKTET E BANIMIT

Objekte të vjetra banimi ka fare pak sepse materiali i dobët i tyre nuk ka mundur t'i përballojë kohës. Objektet e banimit dhe oborret kanë dallime, varësisht nga vendi i ndërtimit, si: qyteti, vendbanimet pranë qytetit, vendbanimet kodinore-malore.

Shumica e objekteve të banimit janë të prethuara me mure, ndërsa në oborre dallohen edhe objektet e tjera ekonomike - bujqësore.

Deri vonë, objektet e banimit ndërtoheshin me material të dobët, nga qerpiçi dhe druri, që zakonisht forma e objekteve i ngjante shkronjës L. Në këto dekadat e fundit, objektet e banimit kanë ndryshuar tërësisht, si në formë ashtu edhe në cilësi. Tani objektet e banimit ndërtohen me një e më shumë kate, që zakonisht kanë kulmet në dy ujëra, ndërsa janë të ndërtuara me material të fortë ndërtimor, si: tulla, blloka të pjekur, betoni e hekuri. Kështu që, objektet e ndërtuara të banimit në fshat, fare pak dallojnë me ato në qytet. Nuk ka ndonjë stil unik të ndërtimit të objekteve të banimit. Dendësia e banimit brenda zonës së ndërtuar, në vendbanimet rurale, është mjaft e lartë dhe është e përafërt me shumë qytete të vogla të Kosovës dhe këto vlera sillen rreth 50 banorë në ha.

Ndërsa, në qendërën e vetme urbane, në Rahovec, dendësia e banimit arrin në 85 banorë në ha, me mundësi të rrijës në të ardhmen, për të arritur në rreth 100 banorë për hektarë. Ndërsa, në vendbanimet rurale, dendësia maksimale e planifikuar do të jetë 50 banorë për hektarë.

Gjendja e banimit në vendbanimet rurale dhe në vetë qytetin e Rahovecit, u dëmtua rëndë në luftën e fundit, gjatë së cilës u shkatërruan një numër i madh i objekteve të banimit dhe ekonomike, ndërsa pasojat po evitohen me kalimin e kohës.

Hapësira e banimit në raport me sipërfaqet e ndërtuara është dominante, me rreth 90% në raport me zonën e ndërtuar në nivelin komunal, ndërsa në qytet ajo dominon me rreth 80 %. Kjo tregon se aktivitetet e tjera janë në nivel shumë të ulët të zhvillimit, sidomos për qytetin, ndërsa në vendbanimet rurale, përveç objekteve të banimit, janë prezente edhe një numër i konsiderueshëm i objekteve përcjellëse ekonomike.

Numri i anëtarëve për ekonomi familjare lëviz nga 7.7 anëtarë në vendbanimet rurale, në 6.3 anëtarë në qendërën urbane. Këto parametra tregojnë për një gjendje jo të favorshme të standartit jetësor.

Sipërfaqja e banimit për banorë është me sa vijon: 18.8 m² për anëtarë në nivel të komunës, 19.5m² për anëtarë në vendbanimet rurale dhe në 17.1 m² për anëtarë në qytet. Kjo gjendje është e pavolishme në këto tri nivele.

Në komunën e Rahovecit ka familje me kushte ekonomike që nuk janë në gjendje të kenë shtëpi të përballeshme. Duke u referuar të dhënave mbi varfërinë, sipas paragrafit të mësipërm, 12,35% e popullsisë jeton me 1 \$ ditë / për person dhe 69,57% e popullsisë jetojnë me 2 \$ ditë /për person. Përveç kësaj, 590 familje janë nën asistencë sociale (përafërsisht 37% e popullsisë). Të dhënat e përmendura më sipër tregojnë nevojën për ofrimin e programeve e veçanta të banimit.

Në komunën e Rahovecit, numri i gjithmbarshëm i njësive të banimit është 7691. Pjesa më e madhe e njësive të banimit gjendet në zonën rurale të komunës – 5,193, ndërsa në atë urbane – 2,498 (ASK, Banesat dhe Ndërtesat, sipas komunave, 2013).

3.5.2 OBJEKTET AFARISTE

Pozita e Komunës së Rahovecit është e volitshme për ndërmarrësi si dhe biznes. Veprimtarië e përshtatshme për zhvillimin e ekonomisë regjionale mund të jenë:

- Industria dhe bizneset me ndoije të vogël;
- Industritë/ bizneset të cilat prodhimin e bazojnë në lëndën e parë nga resurset vendore si Industria e Verarisë;
- Prodhimtaria dhe bizneset e përqendruara në produktet bujqësore.

Më poshtë janë listuar disa koncepte themelore, të cilat duhet të zhvillohen nga komuna për ta përkrahur zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme:

VLERËSIMI I RRËZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË E TJERA

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme do të kenë shtrirje përgjatë akseve kryesore, si dhe potencial për zhvillimin përgjatë rrugëve regionale Rahovec – Gjakovë, Rahovec- Suharekë, pasatj përgjatë rrugës Krushë e Madhe - Brestoc, si dhe rruga regionale Prizren – Klinë, që kalon përgjatë nënqendrave: Krushë e Madhe, Xërxë, Ratkoc dhe Çifllak.

3.5.3 OBJEKTET SPORTIVE

Në Rahovec janë aktive shumë klube sportive të futbollit, basketbollit, hendbollit, boksit, karatesë, etj. Aktivitetet sportive zhvillohen në kuadër të objekteve sportive që janë të shpërndara si në zonën urbane po ashtu edhe në atë rurale. Në Rahovec gjendet një numër i konsiderueshëm i objekteve, si: stadiumi i qytetit, palestra e sportit “Mizahir Isma” e ndërtuar dhe e hapur në vitin



2019, stadiumi i qytetit „JAHJA DANUZA“ – Rahovec si dhe Fusha e Futbollit-KF Rahovecit.





Figura 1 Fusha e tenisit në - Rahovec



Disa vendbanime të komunës së Rahovecit dhe lagjeve të qytetit nuk kanë fusha të hapura sportive, të cilat do të mund të shfrytëzohen nga komuniteti, sidomos atyre në pronësi publike.

3.5.4 OBJEKTET KULTURORE

Jeta kulturore dhe artistike në komunën e Rahovecit kryesisht zhvillohet në qytetin e Rahovecit, ku edhe ndodhet numri më i madh i objekteve të kulturës, por edhe në fshatra.

Janë të njohura eventet kulturore si ai i vjeljes së rrushit “Hardh Fest” si dhe ai i ansambli të valleve dhe të këngëve burimore “Anadrimia Jehon”.

Festa e vjeljes organizohet çdo vjeshtë afër shtëpisë së Verërave. Dita e parë i kushtohet hapjes së festivalit me thirrjet nga fjalimi i zyrtarëve shtetëror si dhe kryetari të komunës, përfaqësuesit të Ministrisë së Bujqësisë dhe përfaqësuesve të delegacioneve të miqve. Është karakteristike se tufa e parë e rrushit pritët simbolikisht duke zyrtarizuar kështu hapjen e të

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKËQËSITË NATYRORE DHE FATKËQËSITË E TJERA

korrave. Festa, shfaqje dhe ekspozita të artistëve lokalë, organizohen pranë shtëpisë së verës dhe në qendërën e qytetit të Rahovecit gjatë gjithë fundjavës.

Tjeter eveniment mjaft i rëndësishëm i muzikës folklorike shqiptare është festivali “Anadrinia Jehon”. Ai fillon në javën e dytë të muajit Maj, në kuadër të “Javës së dëshmorëve dhe të heronjve të Komunës së Rahovecit”, dhe organizohet në fshatin Dejinë. Ky festival ka për qëllim mbledhjen e adhuruesve të folklorit nga të gjitha trojet shqiptare, për të ruajtur dhe kultivuar traditën shqiptare.

Shtrirja hapësinore e objekteve të kulturës, në kuadër të zonës urbane është e mirë, mirëpo ka nevojë për plotësim dhe përmirësim të infrastrukturës ekzistuese në përgjithësi. Objektet ekzistuese kulturore i plotësojnë vetëm pjesërisht kushtet për qasjen e personave me nevojë të veçantë.

Shtëpitë e kulturës—janë të organizuara në zonën urbane dhe në ato rurale, ku përpos në Rahovec janë edhe në fshatrat, si : Krushë e Madhe, Xërxe, Ratkoc, dhe Drenoc.



Figura 2 Shtëpia e Kulturës “Mensur Zyberaj” - Rahovec



Figura 3 Festivali i specit - Krushë e Madhe



Figura 4 Shtëpia e Kulturës

Muzeu i qytetit - i përmbush nevojat e komunitetit për nevojën e një muzeu për tërë komunën e

Rahovecit, ka lokacion qendror dhe është lehtë i qasshëm nga të gjithë banorët.



Shtëpia - muze “Ukshin Hoti”- Është shtëpia e veprimtari dhe e patriotit shqiptar të kohës tonë, Ukshin Hoti. Ky objekt vihet në mbrojtje dhe vendoset që të jetë shtëpi- muze në ditëlindjen e 70-të të tij, ndërsa në ambientet e saj janë ekspozuar fotografi dhe disa nga mjeket e punës së tij. Veprimtari Ukshin Hoti, derisa ishte në Burgun e Dubravës, është zhdukur nga forcat serbe dhe nuk dihet asgjë për fatin e tij.

3.6. STREHIMORET DHE OBJEKTET PËR STREHIM

Përkujdesja është masë shumë e rëndësishme në kuadër të Mbrojtjes dhe Shpëtimit. Organizohet dhe përgatitet krahas me masat e tjera të Mbrojtjes dhe Shpëtimit. Ka rëndësi të veçantë që të harmonizohet mirë me masat e tjera si evakuimin dhe strehimin. Fatkeqësitë elementare, brenda një kohe shumë të shkurtrë, lënë një numër të madh njerëzish, jo vetëm pa kulm mbi kokë, por edhe pa mjete më të domosdoshme për jetë. Për këtë asye, krahas evakuimit dhe strehimit, planifikohet edhe përkujdesja për të evakuuarit dhe të strehuarit qysh më parë, në bazë të vlerësimit nga fatkeqësitë elementare dhe fatkeqësitë e tjera. Parashikohen dhe sigurohen mjete materiale të domosdoshme për furnizimin e atyre të cilët kanë mbetur pa to. Krahas përkujdesjes, parashikohet dhe përgatitet edhe vendosja e domosdoshme për një kohë të caktuar në objekte publike (hotele, shkolla, shtëpi, pushimore etj) për të gjithë njerëzit që evakohen nga vendbanimet e përhershme.

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË E TIERA

Evakuimi bëhet me qëllim të largimit të popullsisë prej vendeve dhe objekteve të rrezikuara në objekte dhe vende më pak të rrezikuara.

3.6.1 PËRCAKTIMI I LOKACIONEVE (ZONAVE) TË GRUMBULLIMIT NË RAST FATKEQËSIE

Evakuimi planifikohet në Komunë nga strukturat komunale, përgjegjëse për Mbrojtje dhe Shpëtim, duke ju përmbytur Planit Komunal për Evakuim i cili përfshin, pos tjerash:

- Udhëzimet e hollësishme për qytetarët mbi mënyrën dhe kohën e evakuimit;
 - Evidentimin e familjeve dhe anëtarët e familjeve për evakuim;
 - Vend-grumbullimin, mënyrën dhe mjetet për transport;
 - Rrugët dhe drejtimet e evakuimit;
 - Destinimin (vendosjen);
- Posqerisht duhet patur kujdes evakuimin me prioritet për kategoritë e vecanta të popullatës, si:
- Evakuimin e fëmijëve deri në moshën 14 vjeçare,
 - Nënat me fëmijë të vegjël,
 - Përsinat e sëmurë,
 - Përsinat e moshuar,
 - Përsinat e pafluqishëm dhe me nevoja të posaçme eij.

3.6.2 LOKACIONI I STREHIMOREVE/TITULLARI

Në komunën e Rahovecit, në raste të krizimit të situatave emergjente nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera për strehimin e përkohshëm të të evakuuarve, ekzistojnë qendra të strehimit kolektiv:

1. Shkollat fillore dhe të mesme të komunës së Rahovecit;
2. Salla sportive në Rahovec, si dhe objekte të tjera të pabanuara, që mund të përdoren për strehimore dhe që gjenden larg përimetri të rrezikut.

3.6.3. KAPACITETET – ka kapacitete të mjaftueshme nëse paraqitet nevoja.

3.6.4. GJENDJA E TYRE

Gjendja e shkollave është e mirë, palestra sportive është ndërtuar në vitet e fundit dhe ka kapacitete për strehim treth 1000 banorë.

3.7. KAPACITETET SHËNDËTËSORE PUBLIKE DHE PRIVATE

3.7.1 INSTITUCIONET SHËNDËTËSORE

Institucionet e nivelit parësor shëndetësor në komunën e Rahovecit:

- Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF);

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQESITË NATYRORE DHE FATKEQESITË E TJERA

- Qendra e Mjekësisë Familjare (QMF)- 7;
- Ambulanca shëndetësore (AMF)- 7.

3.7.2 KAPACITETET HUMANE SHËNDETËSORE:

- Specialist i mjekësisë familjare apo tjetër- 20;
- Mjekkë të Përgjithshëm-10.
- Stomatologë-10;
- Infermierë-78;
- Radiolog teknik ____;
- Teknik i farmacisë ____;
- Teknik laborant ____;
- Teknik stomatolog-3;
- Bashkëpunëtor shëndetësor i mesëm ____;
- Infermier me shkollim të: _____, Etj.

Totali i të të punësuarve në QKMF Rahovec është 155. Drejtoria Komunale për Shëndetësi ka 198 punëtorë.

Tab 24

Emri i vendbanimit	Nr i institucioneve shëndetësore private
Rahovec	30
Ratkoc	5
Kramovik	1
Krushë e Madhe	5
Xërxe	2
Total:	43

3.7.3 KAPACITETET TEKNIKE NË SEKTORIN PUBLIK (QKMF/QMF)
Staf shtesë janë edhe 2 teknike të rengenit, 5 farmacist dhe 4 laborantë.

Harta 7: Institucionet shëndetësore në Komunën e Rahovecit (Burimi i të dhënave
Ministria e Shëndetësisë) Aneksi i hartave

Tab 25. Kapacitetet mjekësore reaguese publike

Nr.	Kapacitetet mjekësore reaguese publike	Dinamika
1.	Dhënia e ndihmës së parë nga personeli profesional	
2.	Transporti nga lokacioni i pacientit në spital (shtëpi shëndeti)	30 min nga fshati më i largët
3.	Transporti nga lokacioni i pacientit në qendrat e tjera rajonale dhe QKU	15 min
4.	Numri i ekipeve kujdestare të ndihmës së parë	3
5.	Numri i shtrretërve në spital	
6.	Numri i shtrretërve në shtëpi shëndeti	20
7.	Numri i shtrretërve mobil në shtëpi shëndeti	
8.	Numri i leseve për të lënduar	7
9.	Autoambulanca	7

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF), e vendosur në zonën urbane të Rahovecit, mbulon me shërbime gjithë territorin e saj. Gjendja momentale e saj është e kënaqshme dhe aktiviteti i saj vazhdon të jetë edhe më tutje.
Ndërsa Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF) -7, Qendrat e Mjekësisë Familjare në: Ratkoc, Fortesë, Çiftllak, Drenoc, Krushë e Madhe, Jagjia e Arave dhe Apterushë, kanë kapacitet zhvillimi dhe mbulimi të këtyre nënqendrave.

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË E TJERA

	Infermierë - numër	Mjekë familjarë	Infermierë familjarë	Mjekë të përgjithshëm
Rahovec	QKMF	75	4	62
	Poliklinika e Stomatologjisë	3	10 Stomatologë	14
	QMF Krushë e Madhe			5
	QMF Ratkoc		1	7
	QMF Bellacerkë		1	2
	QMF Drenoc			2
	QMF Çifllak			2
	QMF Optrushë			1
	QMF Rahovec			1
	AMF Xërxë			3
	AMF Brestoc			
	AMF Lagja e Epërme			1
	AMF Hoçë e Madhe			
	AMF Zoqisht			
Gjithsej	AMF Malësi e Vogël			
	AMF Polluzhë			
		78	16	84
				20

AMF- 7 Ambulanca të Mjekësisë Familjare në: Lagja e Epërme, Hoçë e Madhe, Zoqisht, Brestoc, Malësi e Vogël, Polluzhë dhe Xërxë. Ambulanat gjithashtu mund të vendosen në të gjitha fshatrat me popullatë mbi 2000 banorë dhe përkohësisht në fshatrat me më pak banorë, deri sa të përmirësohet rruga për qendrën e bashkësisë lokale ose fshatin më të afërt me ambulancë.

3.7.4 KAPACITETET MJEKËSORE PRIVATE

Sipas listës së bizneseve, në komunën e Rahovecit, janë identifikuar afër 43 objekte shëndetësore private të cilat janë prezantuar në tabelën në vijim sipas vendbanimeve.

Nga 42 objekte shëndetësore, 14 prej tyre janë: Aktivitetet e dentistëve në komunën e Rahovecit, ndërsa të tjerat janë:

- a. Aktivitetet e mjekësisë së specializuar,
- b. Aktivitetet e tjera të shëndetit të njeriut,
- c. Aktivitetet e mjekësisë së praktikës së përgjithshme,
- d. Aktivitetet e tjera të shëndetit të njeriut etj.

Tab. 26 Institucionet shëndetësore private

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË E TJERA

3.7.5 DËTYRA TË EKIPEVE PËR SHËRKIMET MJEKËSORE NË SITUATA EMERGJENTE:

- Ofrimi i ndihmës së parë medicinale në vendin e incidentit,
- Triazhimi i personave të aksidentuar, plotësimi i kartonit të triazhës së pacientit dhe mbajtja e evidencës,
- Evakuimi dhe bartja adekuate e personave të lënduar nga zona e fatkeqësisë në qendrat spitalore dhe repartet e tjera të specializuara medicinale,
- Mërkata e masave preventive anti-epidemiologjike si dhe luftimi i vatrave të mundshme të paraqitjes së tyre,
- Aplikimi i sistemit të mbrojtjes karantinë me rastin e shfaqjes së sëmundjeve të ndryshme infektive e të tjera,
- Informimi i popullatës lidhur me gjendjen sanitare në terren dhe dhënia e udhëzimeve-këshillave adekuate medicinale për veprime në situata të caktuara emergjente,
- Sanimi i terrenit-lokacionit të aksidentuar,
- Planifikimi dhe krijimi i rezervave kritike në medikamente dhe produkte të tjera farmaceutike për funksionim adekuat në situata emergjente,
- Detyra të tjera sipas specifikave dhe nevojave.

Emri i vendbanimit	Nr i institucioneve shëndetësore private
Rahovec	30
Ratkoc	5
Kramovik	1
Krushë e Madhe	5
Xërre	2
Total:	43

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQESITË NATÛRORE DHE FATKEQËSITË E TJERA

1.	Dhënia e ndihmës së parë nga personeli profesional	
2.	Transporti nga lokacioni i pacientit në spital (shtëpi shëndeti)	30 min nga fshati më i largët
3.	Transporti nga lokacioni i pacientit në qendrat tjera rajonale dhe QKU	15 min
4.	Numri i ekipeve kujdestare të ndihmës së parë	3
5.	Numri i shtrretërve në spital	
6.	Numri i shtrretërve në shtëpi shëndeti	20
7.	Numri i shtrretërve mobil në shtëpi shëndeti	
8.	Numri i leseve për të lënduar	7
9.	Autoambulanca	7

4. INFRASTRUKTURA TEKNOLOGJIKE DHE E TRAFIKUT

4.1. RRUGËT (RRJETI RRUGOR DHE QARKULLIMI)

Komuna e Rahovecit shtrihet në mesin e rrugëve nacionale Gjakovë – Prishtinë dhe Gjakovë – Prizren, si dhe atyre regjionale Malishevë – Gjakovë, dhe Rahovec – Suharekë. Territori i komunës është relativisht i madh dhe ka një rrjet rrugor prej 616.2 km rrugë të të gjitha kategorive. Gjendja e trafikut është relativisht në nivel të kënaqshëm në rrugët periferike të komunës, ndërsa sa i përket atyre brenda qytetit, ka pak vëshitësi në zhvillimin normal të qarkullimit të mjeteve, e kjo bëhet edhe më e vështirë kur kemi parasysh praninë e madhe të motokultivatorëve dhe mjeteve bujqësore motorike. Konfiguracioni i terrenit është kodrinor ku karakterizohet me dendësi shumë të madhe të vendbanimeve në disa lagje të qytetit, si rezultat i kësaj i kemi edhe rrugët shumë te ngushta, të cilat përdoren nga të gjithë pjesëmarrësit në trafik. Shumica e këtyre rrugëve janë të asfaltuara, mirëpo nuk kanë trotuare për lëvizjen e këmbësorëve. Për nga aspekti i mobilitetit, rrugët në këto lagje mund të cilësohen si të rrezikshme, duke mos u ofruar siguri të mjaftueshme të gjithë pjesëmarrësve në trafik. Komuna, përveç trafikut rrugor, ka edhe atë hekurudhor, e cila e lidh Prizrenin – Fushë-Kosovën, mirëpo aktualisht kjo linjë është jashtë funksionit.

Në komunën e Rahovecit, ekziston niveli i katër kategorive të rrugëve (të klasifikuara në Kosovë), duke filluar prej rrugëve nacionale e deri tek ato të pakategorizuara.

Rrjeti i rrugëve në komunën e Rahovecit përbëhet nga:

- Rrugët nacionale – M9.1 (Gjakovë - Prishtinë)
- Rrugë regjionale - (R107 Prizren-Gjakovë, R117 Rahovec-Suharekë, R111 Xerxë
- Ratakoc-Kramovik, R204 Rahovec- Krushë e Madhe, R110 Malishevë- Rahovec –Xerxë
- Rrugë lokale (rrugët të cilat i lidhin 34 zona kadastrale me gjithsej 36 vendbanime, duke përfshirë edhe rrugët që lidhin lagjet më të rëndësishme të vendbanimeve)
- Rrugë të pakategorizuara (të cilat lidhin lagjet e fshatit, si dhe i lidhin të gjitha hapësirat në të cilat zhvillohen aktivitetet socio-ekonomike).

Tabela 26- Rrjeti i rrugëve në komunën e Rahovecit

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATÛRORE DHE FATKEQËSITË E TJERA

Nr.	Përshkrimi	Gjatësia në km	%
01	Rrugë nacionale	6.2 km	1,0%
02	Rrugë regjionale	64.4 km	10,4 %
03	Rrugë lokale dhe të tjera	545.6 km	88,6%
TOTALI		616.2 km	100%

Nga totali i përgjithshëm i rrugëve 616.2 km, sa janë në komunën e Rahovecit sipas gjatësisë, rrugë nacionale janë 6.2 km, rrugë regjionale 64.4 km, rrugë lokale dhe të tjera 545.6 km.

Rruga nacionale M9.1

Nëpër territorin e komunës së Rahovecit kalon rruga e rëndësishme në nivel nacional, e cila lidh Prishtinën-Gjakovën dhe Shqipërinë e Veriut (nëpërmjet Qafës së Morinës), që cilësohet si rrugë nacionale. Kjo rrugë, në komunën e Rahovecit, ka një gjatësi prej 6.2 km, si dhe kalon në dy komuna kadastrale.

Komunat kadastrale (vendbanimet) në të cilat kalon rruga nacionale M9.1 janë: Kramovik, Mirasor. Pozita e mirë gjeografike i ka mundësuar kësaj komune lidhje shumë të mira të komunikacionit rrugor dhe hekurudhor. Gjithashtu e karakterizon atë me komunikacion mjaft të dendur, si në transportin e mallrave, po ashtu edhe atë të udhëtarëve.

Rruga nacionale e cila shtrihet në territorin e komunës është e asfaltuar dhe menaxhohet nga MMPHI. Gjendja e rrugës nacionale në komunën e Rahovecit, në përgjithësi është e mirë.

Karakteristikë e kësaj rruge është shtrirja e urave (mbikalime) në raport me hekurudhën dhe me rrugë që e lidh Gjakovën me Klinën.

Rrugë regjionale

Rrugët e kësaj kategorie i mundësojnë komunës së Rahovecit lidhje shumë të mirë në nivel regjional dhe kanë shtrirje në pesë drejtime me gjatësi prej 64.4 km. Gjithashtu këto rrugë janë të asfaltuara dhe menaxhohen nga MMPHI-ja:

- Rruga regjionale R-107, Prizren-Xërxë-Gjakovë, i mundëson komunës së Rahovecit lidhje të mirë me komunën e Prizrenit dhe të Gjakovës dhe rrugët regjionale R111, që lidhet me komunën e Klinës. Kjo rrugë i lidh vendbanimet mjaft të rëndësishme, si: Krushë e Madhe, Celinë, kalon në komunën kadastrale të fshatit Bellacerkë dhe Xërxë.
- Rruga regjionale R110, – krijon lidhje të mira në mes të komunës së Rahovecit dhe Malishevës dhe pasitaj nëpërmjet kësaj rruge lidhet edhe me Prishtinën (Rahovec- Malishevë – Prishtinë)– kalon në pjesën qendrore të komunës së Rahovecit e deri të kufi komunal i Malishevës, dhe i prek komunat kadastrale: Xërxë, Bellacerkë, Bërnjak dhe komunën kadastrale të qytetit të Rahovecit).
- Rruga regjionale R111, Xërxë –Ratkoç -Kramovik - shtrihet kryesisht në pjesën perëndimore të komunës. Nëpërmjet kësaj rruge komuna e Rahovecit ka qasje në rrugën nacionale Gjakovë-Prishtinë dhe me komunën e Klinës.

Rruga lokale

Konsiderohen rrugët të cilat i lidhin të gjitha vendbanimet e komunës duke u nisur nga qendra e vendbanimit dhe rrugët e tjera të rëndësishme, të cilat mundësojnë lidhje të mira me to.

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKËQËSITË NATYRORE DHE FATKËQËSITË E TJERA

Rrugë të tjera - Rrugë urbane

Konsiderohen rrugët të cilat i lidhin lagjet e qytetit të Rahovecit, gjithsej rrugë urbane në qytetin e Rahovecit

Rrugë të tjera – të pakategorizuara

Konsiderohen të gjitha rrugët të cilat shfrytëzohen për realizimin e aktiviteve bujqësore, socio-ekonomike dhe të tjera, si në brendësi të vendbanimeve.

Harta 8: Rrjeti rrugor dhe hekurudhor në komunën e Rahovecit (Burimi i të dhënave Ortofoto 2018 klasifikimi sipas Ministrisë Mjedisit, Planifikimit hapësinor dhe Infrastrukturës) *Aneksi i hartave*

4.2. HEKURUDHAT

Rrjeti hekurudhor në komunën e Rahovecit është i karakterit regional dhe ka shtrirje në pjesën perëndimore të komunës së Rahovecit, përkatësisht i takon kategorisë së komunikacionit regional, i cili e lidh Prizrenin- kalon në territorin e komunës së Rahovecit dhe e lidhë Klinën me Fushë-Kosovë. Kjo linjë hekurudhore është një-binarësh, me gjatësi prej 33 km në komunën e Rahovecit. Komunitat kadastrale, të cilat preken nga rrjeti hekurudhor, përkatësisht kanë qasje direkte në këtë rrjet janë gjithsej 12, duke filluar nga (Mirasor, Kramovik, Çifllak, Dobidol, Dejinë, Ratkoc, Malësi e Vogël, Gexhë, Xërçë, në komunën kadastrale të Bellacerkës, Celinë dhe Krushë e Madhe). Duke u nisur nga ky fakt, mund të konstatohet se rrjeti hekurudhor, i cili është mjaft i hershëm në këtë komunë, është edhe si indikator për zhvillimin e vendbanimeve më të rëndësishme të komunës. Rrjeti hekurudhor është i një rëndësie të veçantë, jo vetëm për komunën e Rahovecit, por edhe të tjerat, sepse ndihmon në transportimin e mallrave dhe të udhëtarëve. Linja hekurudhore, për momentin nuk është në funksion dhe si rrjedhojë nuk ka qarkullim të udhëtarëve dhe mallrave përmes saj.

4.3. AEROPORTET

Aeroporti bujqësor në Stone Castle nuk është aktiv.

4.4. URAT DHE TUNELT

Të gjitha urat e identifikuara në tërë territorin e komunës së Rahovecit, i takojnë dy kategorive të komunikacionit:

- Komunikacionit rrugor, dhe
- Komunikacionit hekurudhor.

Urat në komunikacionin rrugor

Nga 57 ura të cilat janë të ndërtuara në rrjetin rrugor të komunës, 3 prej tyre shtrihen në rrugë nacionale dhe 7 në rrugë regjionale.

Urat e tjera shtrihen në rrugë lokale dhe ato të pakategorizuara, të cilat kanë gjatësi prej 5 deri 20 m.

Urat në rrugë magjistrale

Konfiguracioni i terrenit ka imponuar që në gjithsej 6.2 km rrugë nacionale në komunën e Rahovecit, të ndërtohen 3 ura mjaft të rëndësishme për komunikacionin e rrugës nacionale (Kramovik- 2 ,

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQESITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË E TJERA

Mirasor- 1). Urat kryesore dhe më të rëndësishme në këtë kategori të rrugëve janë ato në fshatin Kramovik, njëra prej tyre mbi lumin Drini i Bardhë, me gjatësi prej 131 m, e tjetra mbi hekurudhë me gjatësi 100 m.



Urat e tjera kryesisht konsiderohen të vogla me gjatësi prej 1 deri 10m, dhe shtrihen në rrugët lokale dhe të pakategorizuara. Në përgjithësi, janë në gjendje mesatarisht të mirë, me përfshirje të disa urave të cilat karakterizohen me gjatësi të vogël dhe të panjftueshme.

Urat në rrugë regjionale

Janë të vendosura në të dy drejtimet e rrugëve regjionale, një është e vendosur në rrugën regjionale Rahovec-Xërxë – Gjakovë (përkatesisht në komunën kadastrale të Xërxës, mbi lumin Drini i Bardhë (Ura e Fshejtë) tjetra në komunën kadastrale të Ratkocit, dhe në komunën kadastrale të Çifllakut në rrugën regjionale Xërxë-Ratkoc- Kramovik.

Urat në komunikacionin hekurudhor

Në rrjetin hekurudhor të komunës së Rahovecit janë të ndërtuara gjithsej 4 ura, prej të cilave 1 në komunën kadastrale të Mirasorit, 1 në Çifllak, 1 në Ratkoc, 1 në komunën kadastrale të Fortësës (Bellacerkës).

Tunelet

Karakteristikë e komunikacionit hekurudhor është tuneli në mes të vendbanimit Gexhë dhe Xërxë (tunei në komunën kadastrale të Gexhës dhe të Xërxës me gjatësi prej 730 m, të ndërtuara në rrjetin hekurudhor).

Harta 9: Urat dhe tunelet në komunën e Rahovecit (Digitalizim nga Ortofoto 2018 Agjencia Kadastrale e Kosovës) *Aneksi i hartave*

4.5. LARGPËRQESIT DHE TRAFIK-STACIONET

Rrjeti i Energjetikës, në komunën e Rahovecit, është i mbuluar mirë, shikuar nga aspekti i furnizimit me energji elektrike, mirëpo gjendja e këtij rrjeti, në drejtime të caktuara, nuk është e mirë dhe kërkon intervenime. Nga gjithsej 36 km, sa ka gjatësi rrjeti energjetik i tensionit të lartë, 34.3 km e rrjetit energjetik gjendet në zonën e kopshteve. Në përgjithësi, kërkohej që kapaciteti i rrjetit energjetik në të gjitha drejtimet të ketë rritje, përkatesisht duhet të vazhdohej rritja e kapacitetit të rrjetit energjetik nga 10 kV në 20 kV.

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË E TJERA

Energjia elektrike, nga termo-elektranan “A dhe B”, bartet nëpërmjet rrjetit të tensionit të lartë deri të nënstacionet e mëdha të tensionit të lartë.

Energjetika, në kushet bashkëkohore, është një resurs i pazëvendësueshëm në kuptim të zhvillimit ekonomik, të ushtrimit të veprimtarive, të ngritjes dhe të mbajtjes në nivel të standardit jetësor dhe mirëqenies sociale në përgjithësi. Sistemin energjetik e përbëjnë:

- Prodhimi,
- Transferimi apo bartja,
- Distribrimi apo shpërndarja dhe
- Shpenzimi

Tab. 27 Rrjeti i energjisë elektrike, sipas kapaciteteve dhe numri i konsumatoreve

Drejtimi i rrjetit energjiitk	Kapaciteti në kv	Trafot	Individuale	Kolektive	Nr. konsumatore
Drejtimi Qyteti I	10KV	4		4	1197
Drejtimi Qyteti II	10kv	5		5	1422
Drejtimi Nëntori II	10kv	1	1		1
Drejtimi Nëntori III	10kv	2	2		2
Drejtimi i Komunës	10kv	4		4	941
Drejtimi i Hidrosistemi	10 kv	20	20		34
Drejtimi Shkolla e Mesme	10kv	2		2	623
Drejtimi i Shkozës		14	11	3	200
Drejtimi i Opuershës		26	4	22	1539
Drejtimi i Pataçanit		24		24	1077
Drejtimi i Stone Castle		1	1		6
Drejtimi i Podrumit		4	3	1	42
Drejtimi i Bellacerkës- Fortesës		8		8	375
Drejtimi i Ratkocit		19	3	16	1021
Drejtimi i Dejit		34	6	28	985
Drejtimi i 18 Nëntorit		2	2		2
Drejtimi i Silosit 1		1	1		1
Drejtimi i Silosit 2		1	1		1
Drejtimi i Xërxës		18	13	5	450
Drejtimi i Matreksit		3	2	1	23
TOTALI		193	70	123	9942

Përmirësimi i rrjetit të energjisë elektrike në përgjithësi në nivel komune, duhet të bëhet edhe në segmentin e përmirësimit të infrastrukturës fizike me shtylla elektrike.

Tabela 28. Rrjeti i energjisë elektrike, sipas kapaciteteve të propozuara

47

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË E TJERA

Drejtimi i rrjetit energjitik	Kapaciteti i propozuar në kv	Numri i trafistacioneve të propozuar	Statusi fizik
Drejtimi Qyteti I	20 KV	2	Përmirësim solid
Drejtimi Qyteti II	20 KV	1	Përmirësim solid
Drejtimi i Komunës	20 KV	1	Përmirësim solid
Drejtimi Shkolla e Mesme	20 KV	1	Përmirësim solid
Drejtimi i Optrushës	20 KV		Përmirësim selektiv
Drejtimi i Potocanit	20 KV		Përmirësim selektiv
Drejtimi i Bellacerkës-Fortesës	20 KV		Përmirësim solid
Drejtimi i Shkozës	20 KV		Përmirësim solid
Drejtimi i Raktocit	20 KV	2	Përmirësim selektiv
Drejtimi i Dejnit	20 KV		Përmirësim selektiv
Drejtimi i XërXës	20 KV		Përmirësim selektiv
TOTALI		7	

4.6. SISTEMET ENERGJETIKE (OBJEKTET DHE SISTEMET)
(të paraqiten të dhëna në formë statistikore dhe në tabela)

Harta 10: Rrjetit elektrik në Komunën e Rahovecit (Burimi i të dhënave – Draft-plani i PZHK-së komuna e Rahovecit). *Aneksi i hartave*

4.7. SISTEMET E TELEKOMUNIKIMIT

Telefonia mobile – në territorin e Rahovecit është e mbuluar mjaftë mirë, të gjitha vendbanimet e Rahovecit kanë qasje në shërbimet e telefonisë mobile, të cilat ofrohen nga dy operatorët e licencuar nga ART-ja. Të dy operatorët mobil i kanë të shpërndara antenat individuale në lokacione të ndryshme të komunës. Numri i antenave të vendosura nga operatorët mobilë sipas vendbanimeve dhe operatorëve në tërë territorin e komunës është 12.

Tab. 29

Institucioni	Tel. kontaktues	Adresa elektronike
1 PTK		info@telekomi.net info@valamobile.com
2 IPKO		
3 Kujtesa		office@kujtesa.com

Shërbimet e Internetit – Ekzistojnë disa operatorë të cilët bëjnë shpërndarjen e shërbimeve të internetit në komunën e Rahovecit. Territori i komunës është i mbuluar

mjaft mirë me shërbime të internetit, Operatorët me ndikim më të madh, që ofrojnë shërbime të internetit në komunën e Rahovecit janë:

1. PTK - Darda NET, nëpërmjet të telefonisë fikse;
2. IPKO - ofron shërbime të internetit nëpërmjet të antenave (individuale) dhe
3. KUJTESA - ofron shërbime të internetit nëpërmjet të antenave (individuale)

Radiotelevizioni - Rrjeta e Radiotelevizionit në komunën e Rahovecit është e shpërndarë pothuajse në tërë territorin e komunës. Në këtë komunë ekzistojnë disa forma të shfrytëzimit të valëve radio-televizive të ndara në dy grupe:

1. Radio-televizionet Nacionale - RTK, RTV21 dhe KTV;
2. Radio - lokale - radio Rahoveci;
3. Radio-televizionet nëpërmjet antenave Satelitore;
4. Radio-televizionet nëpërmjet sistemeve kablllore.

4.7.1 QENDRA TELEKOMUNIKUESE, TRANSMETUESE DHE REPETITORËT

Harta 11: Antenat e telefonisë mobile në Komunën e Rahovecit (Burimi i të dhënave – draft - plani i PZHK-së, Komuna e Rahovecit). *Aneksi i hartave*

4.7.2 TV DHE RADIOSTACIONET

Rrjeti i Radiotelevizionit në komunën e Rahovecit është i shpërndarë pothuajse në tërë territorin e komunës. Ekzistojnë disa forma të shfrytëzimit të valëve radio-televizive të ndara në dy grupe:

1. Radiotelevizionet Nacionale – RTK, RTV21, KTV, T7, KANAL10, KLAN KOSOVA, ATV, TV DUKAGJINI;
2. Radio - lokale – Radio Aktiv;
3. Radiotelevizionet nëpërmjet antenave Satelitore;
4. Radiotelevizionet nëpërmjet sistemeve kablllore.

Në përgjithësi, informacion është çdo lloj lajmi, i cili bën të mundur komunikimin e ndërsjellë përmes të shkruarit, të folurit etj. Informacioni është diçka që mund të mësojmë, njohim apo kuptojmë. Në gjuhën e përditshme do të thotë njohuri apo dihuri rreth një çështjeje apo ecurie. Informacioni, në një përkufizim më të gjerë, është mbledhja, përpunimi dhe renditja e një të dhëne që shton diturinë dhe njohurinë e marrësit. Me fjalë të tjera, informacioni është rrethana në të cilën të dhënat dërgohen dhe merren, sipas parimit "jap dhe marr". Informacioni është koncept i përdorur gjerësisht në shumë fusha të jetës së përditshme. Kriteret bazë të klasifikimit të mediave përcaktohen kryesisht nga forma se si i ofrohen ato konsumatorit mediaitik për t'u shfrytëzuar. Mediat klasifikohen kryesisht në katër grupe kryesore të cilat janë:

1. Mediat televizive;
2. Mediat radiofonike;
3. Mediat e shkruara;
4. Rrjetet sociale (interneti).

Rrjetet sociale janë ueb-media, që përcillen në mbarë botën me një shpejtësi të rrufeshme, prandaj në ditët e sotme, përdorimi i tyre ka marrë një zhvillim të jashtëzakonshëm. Përdoruesit e tyre janë të gjithë ata që kanë në dispozicion kompjuter, telefon dhe lidhje me internet.

4.8. SISTEMET HIDROTEKNIKE

4.8.1 OBJEKTET PËR FURNIZIM ME UJË

Sigurimi i ujit të pijshëm cilësor është parakusht themelor për shëndetin e një komuniteti, andaj edhe detyrë e çdo shoqërie është të ofrojë këtë shërbim në kohë dhe sasi të mjaftueshme.

Furnizimi me ujë për qytetarët e komunës së Rahovecit, bëhet nga Ligeni i Radoniqit, i cili ka kapacitet prej 113 milion m³, përmes kompanisë rajonale “Gjakova” dhe nga pusët në zonat më të thella rurale. Aktualisht, KRU “Gjakova” sh.a., është ofruesi i vetëm publik me ujë të pijshëm në komunën e Rahovecit.

Sipas të dhënave nga raportet e Insituit Kombëtar të Shëndetit Publik (IKSHP) dhe KRU “Gjakova” sh.a., pjesa më e rrezikuar e popullsisë është ajo në zonat rurale të cilët furnizohen me ujë nga pusët individuale dhe nga ujësjellësit vetanake burimore, të cilët nuk menaxhohen nga ndërmarrjet. Ato paraqesin rrezik për qytetarët, të cilët përdorin ujin e pakontrolluar, por që kohë pas kohe ka pasur dëshmi se shumë prej tyre kanë shfrytëzuar ujë të kontaminuar.

Uji i ofruar për zonën e shërbimit të cilën e mbulon KRU “Gjakova”, i plotëson standardet e ujit të pijshëm sipas rregullores, respektivisht standardeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) dhe rregulloreve dhe normave të IKSHP. Metoda e pastrimit, trajtimit – përpunimit të ujit është me sistemin e para -klorinimit e deri te filtrimi në SF.

4.8.2 KORPORATAT RAJONALE TË UJËRAVE (KRU) DHE BURIMET ALTERNATIVE

4.8.3 SISTEMI I DISTRIBUIMIT TË UJIT PËR PUJE

Pjesa më e madhe e territorit të komunës së Rahovecit furnizohet me ujë të pijshëm nga ligjeni i Dukagjinit (Radoniqit).

Sistemi i furnizimit me ujë në komunën së Rahovecit menaxhohet nga KRU “Gjakova”, ndërsa furnizimi për qytetin dhe fshatrat e komunës së Rahovecit bëhet, përveç nga KRU “Gjakova”, edhe nga burimet e disa fshitarave .

Komuna e Rahovecit ka rjetet shumë të zhvilluar të furnizimit me ujë të pijes, i cili ka shtrirje në 29 vendbanime që kanë qasje në ujësjellës kolektiv.

Nga tabela mund të shihet se 81 % e popullatës së Rahovecit kanë qasje në sistemin e ujësjellësit kolektiv, derisa vetëm 19% e popullatës nuk kanë qasje në këtë sistem.

Aktualisht, sistemi i ujësjellësi dhe i kanalizimit (të ujërave të zeza dhe ujërave të shiut) në komunën e Rahovecit, menaxhohet nga KRU Gjakova. Furnizimi i komunës së Rahovecit me ujësjellës bëhet nga KRU Gjakova.

Harta 12: Vendbanimet sipas mënyrës së furnizimit me ujë në Komunën e Rahovecit
(Burimi i të dhënave – Draft- plani i PZHK-së, Komuna e Rahovecit). *Aneksi i hartave*

- Qytetari e komunës së Rahovecit, furnizohen me ujë të pijshëm në tri forma:*
- *Sistemi qendror i furnizimit-ujësjellësi i KRU Gjakova.*
 - *Sistemet e vogla -ujësjellësit lokalë (sistem të pompimit).*
 - *Puset individuale.*

4.8.4 BURIMET ALTERNATIVE TË UJIT PËR PIJE
(*Pasqyroni me të dhëna*)

Burimet e qyteit dhe të vendbanimeve të Rahovecit janë të paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tab 31

Emërtimi	Lartësia mbidetare	Lit./sek.	Temp.
Burimi i Rahovecit	390	5 – 8	13
Burimi i Zatriqit	920	5	13
Burimi i Optrushës	400	20	13
Burimi i Zoqishtit	415	15	13
Burimi i H. e Madhe	420	10	14
Burimi i Sopotit	380	6	13

Pra, qytetari e komunës së Rahovecit, furnizohen me ujë të pijshëm në tri forma:

- Sistemi qendror i furnizimit - ujësjellësi i KRU Gjakova.
- Sistemet e vogla - ujësjellësit lokalë (sistem të pompimit).
- Puset individuale.

Furnizimi i banorëve të komunës së Rahovecit me ujë të pijshëm, momentalisht përcillet edhe me disa probleme. Me probleme përcillen edhe fshatrat që kanë sistemin e ujësjellësit e sidomos gjatë periudhës së nxehtë, kur në shumë raste, uji pijes keqpërdoret edhe për ujitjen e tokave.

4.8.5 NDOTËSIT E MUNDSHËM TË UJËRAVE SIPËRFAQËSORË DHE NËNTOKËSORË
Mbeturina industriale

Trajtimi i mbejtyeve të trezikshme, përfshinë këtu mbeturinat kimike-industriale dhe ato medicinale, do të kontribuonte në përmirësimin e mjedisit dhe minimizimin e mundësisë së kontaminimit të tokës dhe të burimeve ujore nëntokësore. Largimi efektiv i mbeturinave ndërtimore dhe i mbejtyeve shtazore, do të rezultonte në lirimin e ngarkesës për operatorët që grumbullojnë dhe bartin mbeturinat komunale. Poashtu menaxhimi i tyre i duhur, do evitonte shkakun për hapjen e deponive të egra, siç po ndodh në periudhën e tanishme.

Mbeturina mjekësore - janë mbeturina të cilat krijohen gjatë kryerjes së shërbimeve medicinale. Në planin lokal të menaxhimit të mbeturinave të ngurta, nuk është specifikuar ndonjë lokacion i veçantë për trajtimin e këtyre mbeturinave në territorin e komunës së Rahovecit. Ky lloj i mbeturinave menaxhohet nga një kompani private e kontraktuar.

Mbeturinat shtëpiake

Nënjëra kështjellë	Thelbi i skenarit i nxitur nga një sërë shkakesh deri te pasojat. Patrola e Policisë, e cila ishte duke vëzhguar terrenin e fshatit Kazanik, lajmëron SHZSH-në për një zjarr, i cili ka shpërthyer në majën e bjeshkës së fshatrat Kazanik, Senoc, Drenoc, të cilët urgjentisht iu përgjigjen lajmit për intervenim. Duke parë se zjari me shpejtësi është duke depërtuar në drejtim të shtëpive të banimit dhe në drejtim të antenave të sistemit të telekomunikimit, tentohet të krijohet një bllokadë natyrore – hapje e shtigjeve për lokalizimin e zjarrit. Arrihet që zjari pjesërisht të lokalizohet, ndërsa nën ndikimin e erës së madhe, ai shkon në drejtim të shtëpive të banimit, me ç'rast digjen 50 shtëpi në afërsi të malit, mirëpo me ndihmën e zjarrfikësve dhe vullnetarëve, arrijnë të evakohen banorët e këtij fshati të rrezikuar. Gjatë evakuimit, 5 persona janë dërguar në qendërën medicinale pasi që ishin në gjendje të vështirë shëndetësore dhe për një person invalid duhet të sigurohet transport i veçantë. Përveç djegës së 50 shtëpive, 20 të tjera janë dëmtuar pjesërisht dhe duhet të sigurohet strehimi afatgjatë për 350 banorë të këtyre shtëpive ndërsa për të dëmtuarat duhet që të sigurohen mjetelet financiare për riparimin e tyre. Për shkak të dëmtimit të 3 shtyllave elektrike fshati ka mbele 72 orë pa rrymë duke vështirësuar funksionimin normal të komunitetit.
Pasojat primare dhe efektet afatgjate	Humbe e pasurisë në objekte banimi (pjesërisht apo plotësisht të dëmtuara nga zjari) Dëmtim i rrjetit elektrik lokal të prekura nga zjari. Humbia e materialit drunor dhe kullosat. Humbia e prodhimeve tjera pyjore. Dëmtimi dhe shqetësimi i faunës së egër. Dëmtimi i peizazhit natyror. Përkëqësimi i klimës lokale.

Ndikimi - Indikatorët Tregues

Rastet me fatalitet	-Nuk ka pasur raste me fatalitet.
Persona të lënduar, të sëmurë, të rrezikuar	Dy persona të lënduar.
Mungesë e nevojave elementare	Furnizimet e nevojave themelore: të ushqimit, të veshmbathjes, të shtrijave e të mbulojave, të mjeteve higjienike, të energjisë.
Të evakuarit	350 persona të evakuar, 2 personë invalidë.
Ndikimi i përgjithshëm ekonomik	-Dëmet në njërëz (shëndetësore: fizike, traumatike, psikologjike, etj) , të pa evidentuara; Dëmet e shaktuara në objekte banimi (50 shtëpi të djegura dhe 20 shtëpi të dëmtuar nga zjari)
Ndërprenjet në jetën e përgjithshme	Ndërprenje e furnizimit me ujë të pijshëm; Funksionimi i infrastrukturës rrugore (ndërprenje të akseve të caktuara rrugore apo kalim me vështirësi).
Humbye në trashëgimi kulturore	Jo.
Implikime politike	Jo.
	117

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË E TJERA

Ndikimi i përgjithshëm	Rrezik i lartë
Probabiliteti	Ndjarja e përshkruar në aspektin cilësor, dëshmon të dhëna për një shkallë të nivelit të mesëm të mundshëm.
Masat parand. gjatë periudhës së paralajmërimit të hershëm	Pas marrjes së Paralajmërimit nga IHMK-ja, për parashikimin e motit (temperatura të larta dhe erëra të forta), ngritet gatishmëria e lartë për të papriturat dhe aktivizohet Planifikimi Kontingjent për zjarre pyjore, si dhe ngritet gatishmëria e kapaciteteve humane dhe teknike të strukturave për mbrojtje dhe shpëtim.

Matrica e pasojave				
	Jeta dhe shëndeti i njerzve	Ekonomia	Stabiliteti social dhe ekonomik	Mjedisi
Të papërfillshme	x			
Të vogla				
Mesatare				
Të konsiderushme		X		x
katastrofike				

Matrica e gjasës

Katastrofike	1					
Kritike	2					
E mesme	3					
E vogël	4					
E papërfillshme	5					
Pasojat	1	2	3	4	5	
Gjasat						


- E pamundur
- E pabesueshme
- E besushme
- Gati e mundur
- E sigurt

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË E TJERA

Reagimi dhe rimëkëmbja	
Koha e paralajmërimit	Disa orë
Masat parandaluese dhe përgatitore të zbatuara gjatë periudhës së paralajmërimit	Angazhimin e punëtorëve në terren për vëzhgim dhe parandalim të shpërthimit të zjarreve. Të jetë në kontakt me qytetarët dhe banorët e fshatrave në pjesët malore, poshtu edhe me barijtë të cilët i shfrytëzojnë këto pjesë malore për kullosa të bagëtive, për informimin e pasojave, të dëmeve dhe rreziqet nga zjarret. Të vendosen shenjat për mospërdorimin e zjarrit të hapur në vend - pikiqe dhe vende më të rrezikuara për shpërthimin e zjarreve. Në rasti të shpërthimit të zjarreve, të informojnë njësinë zjarrfikëse me kohë për intervenim sa më të shpejtë për lokalizimin e zjarrit dhe mosëpërhapjes së tij. Të sigurohen të dhëna për pjesët më të rrezikuara nga shpërthimi i zjarrit. Të bëhet sigurimi i makinave për hapjen e rrugëve për depërtimin e autonjeteve zjarrfikëse dhe formimin e brezave mbrojtëse. Të evidentohen burimet e ujërave në terren për furnizim të mundshëm të zjarrfikësve. Gjithashtu, në bazë të vlerësimit të gjendjes, të përforcohen patrullimet dhe vëzhgimet në terren të përgjegjësishë dhe për ngjarjet eventuale me kohë ta informoni Njësinë Zjarrfikëse, Stacionin Policor ose Qendrën Operative 112, për angazhimin e mundshëm të NJPZSH-ve të tjera për këtë ngjarje.
Kohëzgjatja e prirur e ngjarjes	Disa javë.
Koha për kthimin në normalitet	
Nevoja për koordinim	Koordinimi ndërmjet Agjencive përkatëse - AME, APK, ISH, shërbimet e reagimit emergjent, FSK.

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKËQËSITË NATYRORE DHE FATKËQËSITË E
TJERA

Harta 22: Rrezikshmeria e vendbanimeve nga zjarret në Komunën e Rahovecit (Burimi i të
dhënave Draft - plani i PZHK-së)



1.3.7 TËRMETET

1.3.7.1 KARAKTERISTIKAT SIZMIKE TË ZONAVE DHE RREZIKU SIZMIK

Tërmeti pasqyron luhajen e plikave të tokës, të nxitura nga shkaqe natyrore ose artificiale e që janë pasojë e lirimit të brendshëm të energjisë së tokës.

Sa i përket sizmiticiteti, Kosova llogaritet si njëra prej zonave sizmike aktive, nga e cila rrjedhimisht, priten tërmete me shkallë të lartë. Duke u bazuar në të dhënat sizmike nga e kaluara e deri më sot, territori i Kosovës, por edhe i komunës së Rahovecit, kanë qenë të përfshirë nga një mori tërmetesh të cilat përgjithësisht kanë pasur karakter autokton. Por, në raste të veçanta, lëkundjet janë ndier edhe nga territoret fqinje të Kosovës kur ka pasur ndonjë vatrë të tërmeteve.

Sipas Hartës sizmike të Kosovës, komuna e Rahovecit bën pjesë në dy shkallë të intensitetit sizmik prej VII - IX shkallë të Merkalli ose VI shkallë të Richteri, që karakterizohet me intensitet mjaft të fortë me shkatërrim të mureve, bazave të ndërtesave etj.

1.3.7.2 VENDBANIMET E RREZIKUARA, NUMRI DHE STRUKTURA E BANORËVE

Të rrezikuara mund të jenë të gjitha vendbanimet e komunës së Rahovecit.

1.3.7.3 RREZIKSHMËRIA E ZONAVE TË ÇAKTUARA

Zonat me të rrezikuara janë: Zonat me densitet të lartë të popullsisë, zonat ku janë ndërtimet e dobëta në aspektin e kualitetit të materialit ndërtimor.

1.3.7.4 SHPËSHTËSIA, INTENSITETI DHE EPIQENDRA E TËRMETIT (DRIDHJEVE)

(*së paku në 100 vitet e fundit me $M > 3.5$ shkallë të Richteri*)

Si rezultat i burimeve nga shërbimet sizmologjike të lartëshenuara nga rajoni dhe Rrjetit Sizmologjik të Kosovës, të dhënat më të plota për tërmetet që kanë prekur territorin e Kosovës, ekzistojnë gjatë periudhës 1900 - 2014. Të dhënat e mëhershme janë të pakta. Ndër tërmetet më të fuqishme që kanë goditur Kosovën mund të përmendim:

1. Tërmeti i Prizrenit, 16 qershor 1456 ($MS=6.0$; $42.200^{\circ}N$, $20.700^{\circ}E$) me intensitet në epiqendër 8 ballë (Sulstarova, 2005),
2. Tërmeti i Pejës, 11 nëntor 1662 ($MW=6.0$; $42.700^{\circ}N$; $20.300^{\circ}E$) me intensitet në epiqendër 8 ballë (Sulstarova, 2005; Papazachos et al. 2000),
3. Tërmeti i Ferizajt, 26 shkurt 1755 ($M=6.1$; $42.500^{\circ}N$; $21.900^{\circ}E$) me intensitet në epiqendër 9 ballë (Elezaj, 2002),
4. Tërmeti i Ferizaj-Vitisë, 10 gusht 1921 ($ML=6.1$; $42.300^{\circ}N$; $21.300^{\circ}E$) me intensitet në epiqendër 9 ballë (Elezaj, 2002),
5. Tërmeti i Vitisë, 15 gusht Maj 1921 ($MW=5.4$; $42.020^{\circ}N$, $21.020^{\circ}E$) me intensitet në epiqendër 8 ballë (SO Skopje, D. Hadzievski),
6. Tërmeti i Gjilanit, 2 shtator 1921 ($MW = 5.0$; $42.024^{\circ}N$, $21.030^{\circ}E$) me intensitet në epiqendër 8 ballë (SO Skopje, D. Hadzievski),
7. Tërmeti Kaçanik-Viti 03 tetor 1921 ($MW = 5.6$; $42.020^{\circ}N$, $21.020^{\circ}E$) me intensitet në epiqendër 8 ballë (SO Skopje, D. Hadzievski),

8. Tërmeti i Gjakovës, 3 shtator 1922 ($MW = 5.3$; $42.025^{\circ}N$, $21.025^{\circ}E$) me intensitet në epiqendër 7|12 ballë (SO Skopje, D. Hadzievski),
9. Tërmeti i Prizrenit, 26 shtator 1945 ($MW = 5.0$; $42.015^{\circ}N$, $21.045^{\circ}E$) me intensitet në epiqendër 7 ballë (SO Skopje, D. Hadzievski),
10. Tërmeti i Klinës, 5 shkurt 1947 ($MW = 5.2$; $42.030^{\circ}N$, $21.045^{\circ}E$) me intensitet në 11. epiqendër 8 ballë (SO Skopje, D. Hadzievski),
11. Tërmeti i Kopaonikut, 18 maj 1980 ($MW = 5.7$; $43.307^{\circ}N$; $20.867^{\circ}E$) me intensitet në epiqendër 8 ballë (Harvard University, SO Skopje, D. Hadzievski),
12. Tërmeti i Gjilanit, 24 prill 2002 ($MW = 5.7$; $42.440^{\circ}N$, $21.590^{\circ}E$), me intensitet në epiqendër 8 ballë (ISC 2002, Elezaj 2002),
13. Tërmeti i Istogut, 10 mars 2010 ($MW = 5.2$; $42.763440N$, $20.628110E$) me intensitet në epiqendër 7 ballë (SIK Sh.Mustafa, 2010),
14. Tërmeti i Vushtrisë, 18 nëntor 2013 ($MW = 4.8$; $42.9^{\circ}N$; $21.014^{\circ}E$) me intensitet në epiqendër 6|12 ballë (SHGJK Sh. Mustafa, 2013).

1.3.7.5 PASOJAT E TËRMETEVE SIPAS ZONAVE SIZMIKE

Në rastet kur është tërmeti në një shkallë të lartë mund të ketë pasoja dhe prezige për jetën e njerëzve, të mirave materiale, trashëgiminë kulturore, mjedis etj.

1.3.7.6 MASAT PARANDALUESE


- Masat para tërmetit që duhet të ndëmerren në rajonet me aktivitet sizmik;
- Përpunimi i hartës së trezikut sizmik të vendit në bazë të të dhënave sizmike për nivele të ndryshme të trezikut sizmik, të pranueshme për planifikimin, projektimin dhe ndërtimin;
- Përpunimin e hartave të mikrozonimit sizmik për zonat urbane të rëndësishme;
- Përpunimi i një harte të Riskut Sizmik;
- Përpunimi i ligjeve dhe rregulloreve për masa kundër tërmeteve me shkallë të madhe;
- Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit me sizmografë dhe akcelografë.

VLERËSIMI I RREZIQËVE NGA FATKËQËSITË NATYRORE DHE FATKËQËSITË E
TJERA

1.3.7.7 HARTA E RREZIQËVE

Harta 23: Zonat e tërmeteve në komunën e Rahovecit (Burimi i të dhënave draft plani i PZHK-së)

VLERËSIMI I RREZIQIEVE NGA FATKËQËSITË NATYRORE DHE FATKËQËSITË E TJERA



SKENARI

Tërmeti pasqyron luhajtjen e pllakave të tokës, të nxiura nga shfaqje natyrore ose artificiale e që janë pasojë e lirimit të brendshëm të energjisë së tokës.

Emri i skenarit: Skenari 1		Nga Termeni	
Frekuenca e ndodhjes:			
☐ Shumë e mundshme (gjerasat 100% në vitin e ardhshëm); ☐ E mundshme(gjerasat 10-100% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 10 vitet e ardhshme); ☒ Ka gjerasa (gjerasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme); ☐ I pa mundshëm (gjerasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme);			
Madhësia e mundshme:			
X- E papërfillshme (më pak se 10%)		☐ E kufizuar (10 deri 25%)	
☐ Kritike: 25 deri 50% .		☐ Katastrofike: Më shumë se 50%	
Lloji i skenarit:			
X ☐ Skenari 1;		☐ Skenari 2;	
		☐ Skenari 3;	
Ndikimi:			
☐ I papërfillshëm;	☒ I vogël ;	☐ I mesëm ;	☐ Katastrofike;
Data e vlerësimit:			
21.4.2022			

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË E TJERA

Katastrofikë	1					
Kritike	2					
E mesme	3					
E vogël	4					
E papërfillshme	5					
Pasojat						
Gjasat	1	2	3	4	5	
E pamundur						
E pabesueshme						
E besushme						
Gati e mundur						
E sigurt						

Emri i skenarit: Skenari 2	Nga Termeti
Frekuenca e ndodhjes:	
☐ Shumë e mundshme (gjasat 100% në vitin e ardhshëm);	
☒ E mundshme(gjasat 10-100% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 10 vitet e ardhshme);	
☐ Ka gjasat (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme);	
☐ I pa mundshëm (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme);	
Madhësia e mundshme:	
☐ E papërfillshme (më pak se 10%)	☐ E kufizuar(10 deri 25%)
☐ Kritike: 25 deri 50% .	☐ Katastrofikë: Më shumë se 50%
Lloji i skenarit:	

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË E TJERA

☐ Skenari 1; ☒ Skenari 2; ☐ Skenari 3;

Ndikimi:

☐ I papërfillshëm; ☒ I vogël; ☐ I mesëm; ☐ Katastrofike;

Data e vlerësimit:

21.4.2022

Katastrofike	1				
Kritike	2				
E mesme	3			X	
E vogël	4				
E papërfillshme	5				
Pasojat					
	1	2	3	4	5

Gjasat

E pamundur
E pabesueshme
E besushme
Gati e mundur
E sigurt

1.3.8 RRËSHQJTJET DHE EROZIONET

1.3.8.1 KARAKTERISTIKAT E TERRENIT DHE TË ZONAVE POTENCIALE TË RRËSHQJTJES DHE TË EROZIONEVE

KUSHTET KLIMATIKE, INTENSITETI, SHPESHTËSIA E PARAQITJES

Erozioni është njëri nga faktorët ekzogjen që duhet trajtuar për shkak se rrezikon sipërfaqet bujqësore, infrastrukturën, por edhe begatitë e krijuara dhe të planifikuara nga faktori antropogjen. Kjo dukuri është prezente pothuajse në tërë territorin e komunës së Rahovecit, në forma dhe madhësi të ndryshme. Një rol të rëndësishëm në përshpejtimin e tij, në shumë raste, e ka luajturi edhe faktori antropogjen si rezultat i mosshfrytëzimit racional të tokave bujqësore, të prejes së pakontrolluar të pyjeve, por edhe gjatë shfrytëzimit të pakontrolluar të materialeve inerte dhe ndërtimore. Më tepër është prezent mbi formacionet molasike, si rezultat i degradimit të pyjeve, vegetacionit dhe pjerrtësisë së terrenit dhe paraqitet në formë të shpëlarjeve sipërfaqësore, lugeve rrëkenore, por edhe përgjatë brigjeve të shtetëvra të lumenjve, e përrrenjve, etj. Procesi i erozionit është i pranishëm në 60% të pellgut të Lumit Drini i Bardhë.

1.3.8.2 SIPËRFAQET E PËRFSHIRA

Tabela 40. Shkalla e erozionit

Kategoria erozive	sip-ha
Sipërfaqet pa erozion	822.8
Erozion shumë i dobët	6935
Erozion i dobët	8103
Erozion i mesëm	11093.2
Erozion shumë i fortë	596

Territori i komunës së Rahovecit karakterizohet me pjesëmarrje të sipërfaqeve erozive sipas këtyre kategorive: Sipërfaqet të cilat i janë nënshtruar erozionit shumë të dobët kapin një hapësirë prej 6935 /ha të territorit të kësaj komune. Këto sipërfaqe shtrihen kryesisht në pjesën lindore dhe juglindore, përkatësisht në lokalitetet Kramovik, Çifllak, Sarosh, Dabidol, Dejnë, Ratkoc, Malësi e Vogël, Gexhë, Xerxë, Bellacerkë, Celinë, Nagavc, Krushë e Madhe. Këto sipërfaqe shtrihen në reliev të ulët përgjatë shtratit të lumit të Drinit të Bardhë dhe janë kryesisht toka aluviale, deluviale dhe llvadhore. Territorët me erozion të dobët kapin sipërfaqe 8103 ha. Shtrihen në pjesën qendrore te komunës dhe përfshijnë vendbanimet: Rahovec, një pjesë të Brestovcit, një pjesë të Hoqës së Vogël, Bërnjak, Sapniq, Pataqan i Ulët dhe i Epërm, Nushpal, Vrajak, Bratotin, Drenoc, një pjesë Senoc, Pastasel(Pastasellë), Polluzhë, Gur i Kuq etj. Erozioni i mesëm shtrihet në sipërfaqe

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKËQSITË NATYRORE DHE FATKËQSITË E TJERA

prej 11093.8 /ha. Ka shtirje te madhe në hapësirë. Ky lloj erozioni shtrihet kryesisht në Veri dhe në Perëndim të Komunës.

Hapësirat me erozion të fortë në komunën e Rahovecit kapin sipërfaqe prej 596 ha. Ka shtirje në pjesën JL të komunës. Shtirje më të madhe ka në lokalitetet Hoçë e Madhe, Hoçë e Vogël dhe Brestoc. Ndikimet më të larta erozive janë në viset e larta, në toka të zhveshura, me rreth 3200 ha, nga të cilat, 2700 ha janë të përshatshme për pyllëzim.



1.3.8.3 PASOJAT NGA RRËSHQITJET DHE EROZIONET

(për jetën e njerëzve, të mirat materiale, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin)

Duke marrë për bazë kushtet fiziko-geologjike, përbërjen liologjike të kores së tokës, kushtet klimatologjike dhe faktorët e tjerë, të cilët kanë ndikim në krijimin e shembjeve dhe të erozionit të tokës, është vlerësuar se një dukuri e tillë nuk është e theksuar në përmasa të mëdha në komunën e Rahovecit. Megjithatë, viteve të fundit, ka ndodhje të fenomeneve të tilla për shkak të ndërrimeve klimatike.

1.3.8.4 MASAT PARANDALUESE

Me qëllim të pengimit të krijimit të ndodhjeve të vërshimeve, shembjeve dhe erozionit në territorin e komunës së Rahovecit, përgjatë rrjedhës së lumenjve dhe të përrënjeve, të cilët përshkojnë këtë territor, e me qëllim të pengimit të ndodhjeve emergjente, e ruajtjes së tokave bujqësore, ruajtjes së ambientit dhe ruajtjes së shëndetit të njerzve e ruajtjen e pasurisë së tyre, Drejtoria për Menaxhimin e Emergjencave, propozon që të ndërmeren këto masa preventive të domosdoshme:


1. Kërkimi i mundësive financiare për rregullimin e shtretërve të lumenjve dhe mbrojtjeve anësore të brigjeve të tyre, me qëllim të ruajtjes së tokave bujqësore, të akseve rrugore dhe të urave;
2. Pastrimi i shtretërve të lumenjve nga mbeturinat;
3. Ndalimi i hedhjes së mbeturinave përgjatë rrjedhës së tyre;
4. Ndalimi i shfrytëzimit pa kriter të rërës dhe të zhavorit nga shtrërit e lumenjve;
5. Ndërtimi i pendave për pengimin e gërryjes së shtratit të lumenjve dhe ndaljen e bartjes së rërës, zhavorit, gurëve dhe materialit tjetër që bartin rymat e ujit;

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKËQËSITË NATYRORE DHE FATKËQËSITË E TËJERA

6. Ndalimi i prerjes së druave për gjatë brigjeve të lumenjve;
7. Mbjellja e bimësisë për gjatë brigjeve;
8. Pastrimi i shtrëtave të lumenjve nga bimësia e cila ka mbirë vetvetiu (shelgje, verra eij), të cilat pengojnë rrjedhën normale të lumit;
9. Mbushja e pjerrtësisë së brigjeve të lumenjve me mjete natyrore dhe artificiale;
10. Pastrimi i pendave në shtrëterit e lumenjve dhe përrrenjve nga gurët, zhavori, rëra dhe materiali tjetër;
11. Si dhe masa të tjera që do të propozoheshin nga Drejtoria e Bujqësisë, Urbanizmit dhe Ndërmarrja Hidro-ekonomike;
12. Mostrespektimi i normave teknike të punëve dhe me rastin e ndërtimit të objekteve ndërtimore, si dhe masat e ndalimit të ndërtimit të objekteve ndërtimore në zonat të cilat janë evidentuar si terrene jo - stabile;
13. Gjithashu, ndalimi me ligj i punëve; nuk sanksionohen sipas normave ligjore, që edhe më tepër rëndon dhe komplikon situatën.
14. Inspektimi në terren i objekteve të evidentuara në këtë vlerësim nga inspektorët komunalë të urbanizmit, bujqësisë dhe ambienti dhe propozimi i masave sanuese dhe sanksionuese.

1.3.8.5 HARTA E RREZIQËVE NGA EROZIONI

Harta 24: Zonat e rrezikuara nga erozioni në komunën e Rahoveci (Burimi i të dhënave draft -
plani i PZHK-së)



VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË E TJERA

Skenari

Emri i skenarit: Skenari 1

Nga Erozioni

Frekuenca e ndodhjes:

☐ Shumë e mundshme (gjerasat 100% në vitin e ardhshëm);
 ☐ E mundshme(gjerasat 10-100% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 10 vitet e ardhshme);
 X ☒ Ka gjasa (gjerasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme);
 ☐ I pamundshëm (gjerasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme);

Madhësia e mundshme:

☐ E papërfillshme (më pak se 10%)
 X ☐ E kufizuar(10 deri 25%)
 ☐ Kritike: 25 deri 50%.
 ☐ Katastrofike: Më shumë se 50%

Lloji i skenarit:


x☐ Skenari 1;
 ☐ Skenari 2;
 ☐ Skenari 3;

Ndikimi:

☐ I papërfillshëm;
 X ☒ I vogël ;
 ☐ I mesëm ;
 ☐ Katastrofike;

Data e vlerësimit:

21.4.2022



E pamundur
E pabesueshme
E besushme
Gati e mundur
E sigurt

1.3.9 RESHJET E DËBORËS DHE NGRICAT

1.3.9.1 KARAKTERISTIKAT E TERRENTIT DHE E ZONAVE POTENCIALE ME TË
RESHURA TË DENDURA TË DËBORËS DHE NGRICAVE

Duke u bazuar në reshtjet e njëpasnjëshme me vite, konsiderojmë se zonat më të prekura dhe më problematike nga ngricat dhe dëbora janë rruga Rahovec – Drenoc – Sarosh, ndërsa zonat që përfshihen nga vëshirësitë në qarkullim janë Zatriqi, Guri i Kuq dhe Kazniku, që edhe nga lartësia mbidetare konsiderohen vendbanime që janë afër bjeshkëve.

1.3.9.2 INTENSITETI I RESHJEVE, SHPESHTËSIA E PARAQITJES, TEMPERATURAT
EKSTREME

(për sasinë si dhe ngricat të cilat mund ta ndryshojnë dukshëm funksionimin normal të furnizimit me produkte vitale dhe shërbime, sipas pasqyrës së vendbanimeve të rrezikuara me numrin dhe strukturën e banorëve, duke përfshirë specifikat dhe zonat më të rrezikuara për muajt më kritikë të vitit, bazuar në regjestrin statistikorë për 10-20 vitet e kaluara)

Zakonisht në 3 vende ka potenciale të akumulimit me të madh të dëborës që përfshin rrugën për Zatriq, rrugën për Guri të Kuq dhe rrugën tek plantacioni i vreshave Rahovec - Drenoc si dhe segmenti Reitiq - Reitiq e Ujët - Piranë. Në këto zona, përveç përfshirjes se erës së shpejtë , ka pasur edhe vëshirësi në qarkullim për shkak të grumbullimit të borës.

Po ashtu rruga që potencialisht ka pasur vëshirësi është edhe rruga rajonale Rahovec - Malishevë e që mirëmbajtja e saj nuk është përgjegjësi e komunës dhe prandaj vazhdimisht ka pengesa gjatë sezonit të dimrit.

Temperaturat ekstreme(të ftohta) që ndodhin janë në këto zona: Zatriq, Kaznik, Mrasor, Guri i Kuq dhe Drenoc.

1.3.9.3 PASOJAT NGA DËBORA DHE NGRICA

(për jetën e njerëzve, të mirat materiale, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin)

Vëshirësitë më të mëdha në rrugë, e në të cilën ka pasur edhe aksidente të vazhdueshme, është rruga rajonale Rahovec - Malishevë, pjesa e rrugës prej 5 km që ka vëshirësi të vazhdueshme si pasojë e rënies së borës dhe e ngricave në rrugë. Në këtë segment rrugor ka pjerriësi dhe ka hije të vazhdueshme për shkak


se është afër bjeshkës, ku gjatë dimrit shfaqen këto probleme.

1.3.9.4 MASAT PARANDALUESE

Rruga rajonale Rahovec - Malishevë duhet të zgjerohet edhe me një kors, sepse për shkak të mbingarkesës që ka gjatë sezonit dimëror, kjo rrugë shfaqet me probleme në qarkullim. Ndërsa, në rrugët që menaxhohen nga komuna, janë marrë masa parandaluese dhe ka një kujdes të veçantë, sepse komuna vit pas viti ka kontraktuar 3 kompani për mirëmbajtje rrugore verore dhe dimërore. Këto 3 kompani i kanë të ndara zonat e përzgjedhësisë dhe ka një kujdes të mjaftueshëm në mirëmbajtje rrugore, duke përfshirë edhe pastimin e trotuareve.

1.3.9.5 HARTA E RREZIQËVE

Harta 25: Rrugët e rrezikuara nga bora dhe ngricat



Rrugët më problematike nga ngricat dhe bora gjatë stinës së Dimrit në komunën e Rahovecit

Gjatesia e rrugëve më të rrezikuara nga ngrica dhe bora është 50.4 kilometra.

1.3.10 BRESHËRI

1.3.10.1 KAKAKTERISTIKAT E TERRENT DHE ZONAT POTENCIALE TË PREKURA NGA BRESHËRI

Stuhitë e breshërit, që zakonisht ndodhin në përiudhën mes pranverës së hershme e vjeshtës së vonë, gjithashtu janë karakteristike e klimës së Rahovecit. Kohëzgjatja e stuhisë së breshërit sillet prej disa sekondash e deri në një orë. Më së shpeshti zgjat 10, deri 15 minuta. Temperatura e ulëta janë faktor i rendësishëm meteorologjik, që ka ndikim të madh në klimën e këtij territori. Temperatura e ulëta, në vjeshtën e hershme dhe pranverën e vonë, lënë pasja të rënda, posaqërisht në rrugën e frutave dhe në kultivimin e perimeve.

1.3.10.2 SHPESHËSIA E PARAQITJES DHE MUJTË KRITIKË


Breshëri në vitin 2018 - Breshëri ka filluar në orët e pasdites së datës 14.6.2018 dhe ka zgjatur mbi 30 minuta në disa zona të komunës së Rahovecit, të cilat më pas janë shogëruar me reshje të rrëmbyeshme, duke shkaktuar dëme të konsiderueshme në të gjitha kulturat bujqësore të cilat janë përfshirë nga kjo fatkeqësi natyrore.

Sipas vlerësimit të komisionit, sipërfaqet e tokave bujqësore, të atakuara nga breshëri, janë mbi 2,280 ha dhe kanë përfshirë këto zona: Sapniq, Pataqan i Ulët, Fortesë (Bellacërkë), Xërxë, Gexhë, një pjesë e Malësisë së Vogël, Bërnjakë, Celinë, Nagac, Hoçë e Vogël dhe Brestoc.

Harta 26: Harta e dëmiimit të vreshtave nga breshëri, në komunën e Rahovecit, në vitin 2018

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË E
TJERA

Hartë e dëmtimit të vreshtave nga breshëri në Komunën e Rahovecit



Breshëri në vitin 2019 - Breshëri ka filluar në orët e pasdites së datës 17.6.2019 dhe ka zgjatur mbi 5-10 minuta në disa zona të komunës së Rahovecit, të cilat më pas janë shoqëruar me reshje të rrëmbyeshme, duke shkaktuar dëme të konsiderueshme në të gjitha kulturat bujqësore, të cilat janë përfshirë nga kjo fatkeqësi natyrore.

Sipas vlerësimit të komisionit, sipërfaqet e tokave bujqësore, të atakuara nga breshëri dhe vërshimet janë mbi 120 ha dhe ka përfshirë këto zona: Bërnjak, Patagan i Epërm, Fortesë (Bellacërke), Rahovec, Sapniq dhe Senoc.

Dëmet më të mëdha nga breshëri janë shkaktuar në zonat kadastrale, si: Patagan i Epërm, Rahovec, Senoc, Nashpallë, dmt. rripi i breshërit ka kaluar rrëzë bjeshtës, në zonat e lartcekura, ku përqindja e dëmit të shkaktuar në këto zona ka qenë deri në 18-30%, në disa kultura bujqësore.


Breshëri në vitin 2020

Si pasojë e të reshurave të mëdha të shiut dhe të breshërit, komuna e Rahovecit është goditur në masë të madhe, duke dëmtuar shumë kultura bujqësore. Raporti përmban të dhëna të sakta nga vizita në terren, harta, si dhe fotografi që e dëshmojnë dëmin e shkaktuar në kultura të ndryshme bujqësore që kultivohen në komunën e Rahovecit.

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË E TJERA

Breshëri ka filluar në orët e mërkurës, të datës 19.5.2020 dhe ka zgjatur mbi 30 minuta në disa zona të komunës së Rahovecit, poashtu breshëri ka filluar edhe me datë: 20.5.2020 të cilat më pastaj janë shoqëruar me reshje të rrëmbyeshme, duke shkaktuar dëme të konsiderueshme në të gjitha kulturat bujqësore, të cilat janë përfshirë nga kjo fatkeqësi natyrore.

Harta 27: Breshëri me datë 19.5.2020, në komunën e Rahovecit



Kushtet klimatike të mesit të muajit maj 2020, ishin të atilla që shkaktuan dëme pothuajse në të gjithë sektorët e bujqësisë në komunë të Rahovecit.

Nga breshëri dhe vërshimet janë dëmtuar shumë sektorë, nga të cilët më së shumti: Sektori i perimekulturës, sektori i lavëtarisë, sektori i vreshtarisë dhe sektori i pemëtarisë.

Breshëri në vitin 2021 - Janar


Komuna e Rahovecit, që nga fillimi i vitit 2021, është përballur me fatkeqësitë e ndryshme natyrore, ku ka pësuar dëme të konsiderueshme në shumë kultura bujqësore. Si shkak i erërave të forta dhe vërshimeve të shumta, dëmet janë shkaktuar në sipërfaqet e ambienteve të mbrojtura (serra), në kulturën e drithërave, të bimëve aromatike, të perimekulturës, në sektorin e blegtorisë dhe atë të vreshtarisë, ku ka pasur rrëshqitje të dheut. Si pasojë e kësaj, shumë fermerë, janë dëmtuar financiarisht pasi shumë sipërfaqe me të mbjella janë dëmtuar.

Breshëri në vitin 2021 - Qershor

Në muajin Qershor, përkatësisht me datën 11.6.2021, Komuna e Rahovecit, si pasojë e fatkeqësive natyrore (breshëri), ka pësuar dëme në disa sektorë të bujqësisë. Breshëri ka përfshirë sektorin e vreshtarisë, të drithërave dhe të pemë - perimeve.

Breshëri në vitin 2021 - Korrik

Në muajin Korrik, përkatësisht më datë: 18.6.2021, komuna e Rahovecit, si pasojë e fatkeqësive natyrore (breshëri), ka shkaktuar dëme në perime në fushë të hapur.



(të pasqyrohen në formë tabelore)

për sasinë si dhe ngjica të cilat mund ta ndryshojnë dukshëm funksionimin normal të furnizimit me produkte vitale dhe shërbime, sipas pasqyrës së vendbanimeve të rrezikuara me numrin dhe strukturën e banorëve, duke përfshirë specifika dhe zonat më të rrezikuara për muajt më kritike të vitit, bazuar në treguesit statistikorë për 10-20 vitet e kaluara);

1.3.10.3 PASOJAT NGA BRESHËRI

Në tabelat në vijim, janë prezantuar pasojat dhe dëmet e shkaktuara nga Breshëri, në këto katër vitet e fundit.

Tabela 4.1. Tabela e Përgjithshme Dëmet nga Breshëri 2018

Nr.	Kultura	Sipërfaqe e dëmtuar/ha	Vlera në €
1	Perimekulturë	597.32	3,284,961.63 €
2	Lavërtari	396.51	247,016.70 €
3	Vreshtari	419.58	1,276,82800 €

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË E TJERA

4	Pemëtari	9.31	27,580.00 €
	TOTAL	1,424.24 ha	4,836,386.65 €

Tabela 42. Tabela e Përgjithshme Dëmet nga Breshëri 2019

Nr.	Kultura	Sipërfaqe e dëmtuar/ha	Vlera në €
1	Perimekulture	23.83	139,188.09 €
2	Lavërtari	1.19	5,960.84 €
3	Vreshtari	106.18	119,718.10 €
4	Pemëtari	2.91	7,876.00 €
	TOTAL	134.11 ha	272,743.03 €

Tabela 43. Tabela e Përgjithshme Dëmet nga Breshëri 2020

Nr.	Kultura	Sipërfaqe e dëmtuar/ha	Vlera në €
1	Perimekulture	361.01	1,807,820.16 €
2	Lavërtari	172.02	117,804 €
3	Vreshtari	370.57	777,750.71 €
4	Pemëtari	4.2	11,311.80 €
	TOTAL	907.8 ha	2,714,686.67 €


Tabela 44. Tabela e Përgjithshme Dëmet nga Breshëri 2021

Nr.	Kultura	Sipërfaqe e dëmtuar/ha	Vlera në €
1	Perimekulture	150.3 ha	436,231.70 €
2	Lavërtari	131.41 ha	44,259.65 €
3	Vreshtari	127.88 ha	23,944.82 €
4	Pemëtari	0.98 ha	2,864.78 €
	TOTAL	410.57 ha	507,300.95 €

Nr.	Infrastrukturë	Vlera në €
1	Serra - foli, shembje dheu në vreshta	131,400.72 €

1.3.10.4 HARTA E RREZIQEVE

Harta 28: Zonat e goditura nga Breshëri 2018-2021 në komunën e Rahovecit (Burimi i të dhënave raportet e vlerësimeve nga Komuna e Rahovecit)



1.3.11 ORTEKËT

1.3.11.1 KARAKTERISTIKAT E TERRENT DHE ZONAT POTENCIALE

Orteku është grumbull bore që rëshqet teposhtë maleve. Orteket po ashtu quhen edhe rështqije bore. Orteket e borës janë rjedhim i një "luftë" të pabarabartë ndërmjet trysnisë në një pjerrësi. Orteku paraqitet kur trysnia (e gravitetit), që provon ta shtyjë borën teposhtë, ia kalon fuqisë (nga lidhja e topave të borës) së mbështjellësit të borës. Orteket shkaktojnë strukturat e ndërtuara, rrugët, kabllot dhe linjat e komunikimit, kur bora rëshqet nga lartësitë e mëdha, ose duke i gruposur ato. Orteket janë rreziqe kryesore në shumë vise malore. Faktorët që shkaktojnë ortekun janë:

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKËQËSITË NATYRORE DHE FATKËQËSITË E TJERA

- kushtet atmosferike,
- temperatura,
- pjerësia e këndit (topografia),
- shtresa e borës - drejtimi i erës,
- bimësia,
- gjendja e përgjithshme e grumbullit të borës.

Fuqia e grumbullit të borës është e ndërlidhur me dendësinë e borës dhe me temperaturën e tij. Krahësuar me gjërat e tjera të ngurta, shtresa e borës kanë aftësi të rrallë për t'u përballuar ndryshimeve të mëdha të dendësisë. Kështu, shtresa e depozituar me një dendësi origjinale 100 kg/m³, mund të dendësohet deri 400 kg/m² gjatë dimrit, më së shumti i nevojshëm për peshën e mbishtrësave të borës, të tretjes së trysisë dhe rikristalizimit të akullit. Kur temperatura rriten dhe kur në grumbull ka ujë të shkrirë, rritet rreziku i lëvizjes së borës. Frekuenca e ortekut është e ndërlidhur me këndin e pjerësisë. Ortekët lirohen zakonisht në pjerësinë në kufirin e zonës malore që rri matanë erës ekzistuese (në pjerësinë ku nuk fryn era grumbullohet bora që vjen prej drejtimit nga fryn era ose malel). Ortekët fillojnë të lëvizin vetëm në ndonjë pyll mesatarisht të dendur apo të zhveshur. Të gjithë Ortekët e ndjekin një shteg të ortekëve, që përmban tri elemente: - zonën e nisjes, ku fillimisht bora çahet, - shtegun e ortekut ose rrugën aktuale që e ndjek, dhe - zonën e zbrazjes, ku bora ngadalësohet dhe ndalet. Ortekët përbëhen nga dy pjesë: të sipërmen dhe të poshtmen. Në ortek, pjesa e sipërme e borës është më e shpejtë sesa pjesa e poshtme, kështu që pjesa e sipërme mbështillet me pjesën e poshtme dhe bëhen edhe vetë pjesë e poshtme e borës, duke e humbur shpejtësinë për shkak të drurëve dhe të pengesave të tjera. Pjesa e poshtme e mëparshme rrotullohet mbi pjesën e sipërme të vjetër dhe bëhet pjesë e sipërme. Ka raste ku Ortekët tentojnë të paraqiten përsëri në të njëjtin vend, prandaj rreziku për rasiin tjetër mund të vërehet sipas njohjes së shigjëve të mëhershme të ortekëve në reliev.

1.3.11.2 PASQYRA E VENDBANIMEVE TË RREZIKUARA, NUMRI DHE STRUKTURA E BANORËVE

Deri më tani nuk ka pasur raste ku janë zhvilluar Ortekët në komunën e Rahovecit. Duke u bazuar në konfiguracionin e terrenit, mund të themi që vendbanimet më të rrezikuara janë fshatit Kaznik, një pjesë e fshatit Drenoc dhe pjesa veriore e qytetit të Rahovecit.

1.3.11.3 TREGUESIT STATISTIKORË TË PASOJAVE NGA ORTEKËT PËR 10-20 VITET E KALUARA (MUJATË MË KRITIKË TË VITIT, CENUESHMËRIA, EFEKTET SIPAS EVIDENCAVE STATISTIKORE ETJ.)

Nuk ka pasur raste të Ortekëve në këto 20 vitet e fundit në komunën e Rahovecit

1.3.11.4 MASAT PARANDALUESE

Të reshurat e mëdha të borës, mbulesa e lartë e borës dhe pigrjet (grumbujt) e lartë të borës, shkaktojnë një numër problemesh në jetën e përditshme dhe në punë. Vjen deri të ndërpreja e komunikacionit rrugor në rajonet urbane e sidomos në rajonet rurale, duke vështirësuar zhvillimin normal të jetës e të punës në rajonet e përmendura, e cila pasqyrohet në veshirësimin e furnizimit të banorëve me artikuj jetësor, veshitësimin e qasjes së objekteve të ndryshme publike, si shkollave, enteve shëndetësore, të punës dhe atyre ekonomike. Në situata të tilla, shpesh vjen deri të prishja në linja elektrike, PTK, sistemin e ujësjellësit dhe objekte të tjera infrastrukturore që shkaktojnë ndërprerje të shpeshta në furnizimin e

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË E TJERA

objekteve banesore dhe të objekteve të tjera.


Orteku paraqitet kur trysnia (graviteti) që provon të shpëtojë borën teposhtë është më e madhe se fuqia e lidhjes së mbështjellësit (shtrësave) të borës. Janë katër faktorë që kontrollojnë zhvillimin e një orteku:

- Shkalla e pjerrtësisë,
- Shtrësa e borës,
- Shtrësa e brishtë e mbështjellësit të borës,
- Aktivizimi.

Shkalla e pjerrtësisë duhet të jetë e mjaftueshme që të ia mundësojë borës të rrëshqasë. Frekuenca e ortekut është e ndërlidhur me këndin e pjerrtësisë.

1.3.11.5 HARTA E RREZIQEVE

Harta 29: Rreziqet e mundshme nga Otrekët në komunën e Rahovecit



VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË E TJERA

Skenari

Emri i skenarit: Skenari 1 Ngja Orkeket

Frekuenca e ndodhjes:

- ☐ Shumë e mundshme (gjasat 100% në vitin e ardhshëm);
- ☐ E mundshme (gjasat 10-100% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 10 vitet e ardhshme);
- X ☐ Ka gjasë (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme);
- ☐ I pa mundshëm (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme);

Madhësia e mundshme:

- x ☐ E papërfillshme (më pak se 10%) ☐ E kufizuar (10 deri 25%)
- ☐ Kritike: 25 deri 50%. ☐ Katastrofike: Më shumë se 50%

Lloji i skenarit:


- x ☐ Skenari 1; ☐ Skenari 2; ☐ Skenari 3;

Ndikimi:

- ☐ I papërfillshëm; X I vogël; ☐ I mesëm; ☐ Katastrofike;

Data e vlerësimit:

21.9.2022



E pamundur
E pabesueshme
E besueshme
Gati e mundur
E sigurt

1.3.12 ERËRAT E FUQISHME DHE STUHITË

1.3.12.1 KARAKTERISTIKAT E TERRENT DHE ZONAT POTENCIALE

Stuhia është çrregullim atmosferik, e cila shkakton ndryshime atmosferike, që iniciojnë ndryshime të rëndësishme në fushen e erërave, shlyjes dhe temperaturës në shkallë hapësinore që zgjaten nga madhësia e tornados (me shpejtësi nga 1 km.)

Stuhitë korrespondojnë me fenomenet e rafalëve të erës. Këto fenomene meteorologjike kanë të bëjnë me një shtrirje që shkon nga disa qindra metra deri në disa dhjetëra kilometra dhe një kohëzgjatje nga disa minuta në disa orë. Situatat meteorologjike, në origjinën e tyre, kanë një jo - stabilitet të fuqishëm të atmosferës. Ky lloj i fenomenit duket mjaft i shpeshtë në Kosovë, sidomos këto vitet e fundit, që korrespondon me periudhat e ngrohjes së klimës në mes të qershorit dhe të shtatorit.

1.3.12.2 PASQYRA E VENDBANIMEVE TË RREZIKUARA, NUMRI DHE STRUKTURA E BANORËVE


Në rastet eventuale të përfshijes së territorit të komunës së Rahovecit nga stuhitë e erërave të fuqishme, mund të përfshihet i gjithë territori i komunës dhe mund të jenë të rrezikuar të gjithë banorët e komunës së Rahovecit.

1.3.12.3 TREGUESIT STATISTIKORË TË PASOJAVE NGA ERËRAT E FUQISHME DHE STUHITË (PËR 10-20 VITET E KALUARA, MUAJT MË KRITIKË TË VITIT, CENUESHMËRIA, EFEKTET SIPAS EVIDENCAVE STATISTIKORE ETJ.)

Në Rahovec, më së shpeshti fryjnë erërat prej verilindjes (62 %), perëndimit (50%), nga lindja (17%), jugut (14 %), ndërsa më së paku fryenë nga veriu (11,8 %), dhe juglindja (4 %).

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË E TJERA

Grafiku 9. Shpejtësia mesatare e erës në m/sek në Rahovec



Është me rëndësi të theksohet se ky territor është nën ndikimin e klimës mesdhetare e cila depërton përmes luginës së lumit Drini i Bardhë. Klima është njaft e butë dhe nuk ka variacione karakteristike ekstreme në temperaturën e ajrit gjatë vitit.

Efektet e këtyre fatkeqësive natyrore janë të shumta, bëhet fjalë për:

- Shkuljen e drunjve,
- Rrëzimin e kulmeve,
- Lëvizjen dhe hedhjen e objekteve të ngurta (mobile të kopshit, kontejnerëve...),
- Shkatërrimin e pjesës të rrjetit elektrik dhe të telefonisë,
- Çrregullimin e transportit (ajror, hekurudhor dhe rrugor),
- Aksidentet e komunikacionit,
- Zvogëlimin, madje paralizimin e aktivitetëve socio-ekonomike,
- Vdekjet ose lëndimet nga goditjet ose nga rëniet e objekteve,
- Mbytyjet,
- Vdekjet ose lëndimet nga rënia.

1.3.13 THATËSIRAT

1.3.13.1 TREGUESIT STATISTIKORË PËR MUNGESËN E THEKSUAR TË TË
RESHURAVE ATMOSFERIKE

Kosova është një vend me sipërfaqe të konsiderueshme rurale ku gjatë sezonit veror mund të ketë periudha më të gjata të vapës, që kryesisht manifestohen me mungesa të mëdha të të reshurave atmosferike, të cilat mund të shkaktojnë thatësi.

Thatësi e është një periudhë e zgjatur mujore apo vjetore, kur një rajon ka mangësi në furnizim me ujë. Në përgjithësi, kjo ndodh kur një rajon, në vazhdimsi ka reshje atmosferike nën mesataren e nevojshme. Ajo mund të ketë një ndikim të konsiderueshëm mbi ekosistemin dhe bujqësinë e rajonit të prekur. Edhe pse thatësitrat mund të vazhdojnë për disa vite, madje edhe një periudhë të shkurtër kohore, thatësira, mund të shkaktojë dëme të mëdha në ekonominë lokale të Zonës së goditur. Ky fenomen global ka një ndikim të gjerë sidomos në bujqësi.

1.3.13.2 DËMET DHE PASOJAT (TË EVIDENTUARA PËR 30 VITET E KALUARA,
MUJATË MË KRITIKË TË VITIT, CENUESHMËRIA, EFEKTET SIPAS
EVIDENCAVE STATISTIKORE ETJ.)

Nuk ka ndonjë të dhënë statistikore të publikuar në lidhje me dëmet dhe pasojat nga thatësitrat në komunën e Rahovecit. Në këto vitet e fundit, nuk ka pasur thatësira të mëdha që vlen të përmenden me dëme në jetën e njerëzve, përpos në fushën e bujqësisë që ka shkakuar dëme në rendimentet bujqësore në zonat kodrinore (që nuk kanë sistem të ujitur të tokës bujqësore).

1.3.13.3 PASQYRA E VENDBANIMEVE/ZONAVE TË RREZIKUARA, NUMRI DHE
STRUKTURA E BANORËVE

Vendbanimet me të rrezikuara janë pjesa kodrinore-malore , pasi gjatë sezonit veror ka pak të reshura atmosferike si dhe ka mungese të ujit nga Sistemi i Radoniqit. Vendbanimet me të rrezikuara janë: Guri i Kuq (ish - Petkoviqi), Kazniku, Senoci, Drenoci, Mrasori, Hoqa e Madhe, Zagishi, Optenusha dhe Zairiqi.

Afër 7585 banorë janë të rrezikuar në vendbanimet e përmendura.

1.3.13.4 REZERVAT UJORE (MBITOKËSORE DHE NËNTOKËSORE)

Lumenjtë dhe trjedhat e tjera ujore në Rahovec, janë pjesë e pellgut ujqor të lumit Drini i Bardhë. Komuna e Rahovecit është e pasur me burime natyrore dhe ka rjet hidrografik relativisht të dendur. Kjo paraqet pasurinë natyrore të komunës dhe një ndër kushtet për ekzistencën e botës bimore dhe të aktiviteteve njerëzore. Rrjetin hidrografik të komunës së Rahovecit e përbëjnë disa lumenj dhe ujëtrjedha/ përrenj, qindra burime natyrore dhe ujërral nëntokësorë.

Lumi më i madh që kalon në territorin e komunës së Rahovecit është Drini i Bardhë. Edhe pse nuk buron në komunën e Rahovecit, ai është ujëmbledhës i të gjitha trjedhave dhe i lumenjve të komunës. Nëpër komunën e Rahovecit, ky lumë trjedh me një gjatësi prej 30 km dhe pjesën më të madhe është edhe si kufi administrativ i komunave: Prizrenit, Gjakovës, Malishevës dhe Klinës. Lumenjtë-përrocat që derdhen në Drinin e Bardhë janë: lumi Drinas, Rimmik, Polluzhë, Hoqë euj.

Lumi i Hoçës buron në fshatin Hoçë të Madhe, në lartësi mbidetare 420 m dhe rrjedh nëpër fshatin Brestoc, por para fshatit Brestoc bashkohet me përtockën e Babindollit dhe disa burime të tjera dhe derdhet në Drinin e Bardhë. Lumi Bellaja është dega e majtë e Drinit të Bardhë dhe është e gjatë 3 km prej fshatit Fortesë deri te fshati Rogovë.

Lumi Duhillo buron në Rahovec dhe është i formuar nga tri burime (Duhillo, Vrella dhe Sopoti) dhe në kilometrin e 4 bashkohet me lumin e Rimmikut. Në harta topografike, ky lumë është i shënuar me emrin Gjegojë, që do të thotë për popullin e kësaj ane është i panjohur.

Lumi Rimmik buron në rrëzë - malet Gërgavice dhe në rrjedhjen e tij i merr disa burime të tjera. Ky lumë ka rëndësi të madhe ekonomike për këtë anë. Lumi Rimmik gjatë rrjedhjes së vetë bashkohet me lumin Duhillo dhe në fshatin Fortesë bashkohet me lumin e Sopniqit dhe formojnë lumin Bellaja.

Lumi Sopniq burimin e ka në rrëzë të malit të Drenocit dhe kalon nëpër fshatin Nashpallë, Sopniq. Ky lumë, gjatë stinës së verës, ka pak ujë dhe shtrati i tij është kryesisht i thatë dhe mund të quhet si Lumi i Thatë. Vlen të përmenden edhe disa lumenj-përrocka, siç janë: i Drinasit, Kramovikut, Polluzhës e të tjera.

Në tabelën vijuese pasqyrohet rrethi hidrografik i disa burimeve ujore me karakteristikë fizike të tyre.

Ujërjedhat më të ndotura, që përshkojnë territorin e qytetit të Rahovecit dhe të vendbanimeve përreth janë: Rimmiku, Duhillo, Sapniqi, Bellaja si rrjedhojë e hedhjes së mbeturinave dhe e shkakimit të ujërave të zeza. Shfrytëzimi i zhavorit kryesisht nga shtrati i lumit Drini i Bardhë është veprim shumë negativ i cili krahas dëmtimit të peizazhit, dëmtion edhe biodiversitetin e lumit dhe përreth tij. Shfrytëzimi i zhavorit nga shtrëtit e lumenjve apo ngushtimit të shtraitit të tyre me ndërtime buzë bregut, apo hedhjes së mbejveve ndërtimore, çrregullon rrjedhën e tyre dhe për pasojë kemi edhe vërshime të vendbanimeve dhe të tokave bujqësore përgjatë këtyre rrjedhave, pothuaj çdo vit në pranverë apo vjeshtë kur rritet intensiteti i reshjeve të shiut apo shkritja e hovshme e borës.

Ndodhet industriale nga operatorë si Verania dhe Termoventi si dhe operatorë të tjerë më të vegjël, gjithashtu kontribuojnë në ndodjen e burimeve ujore.

Mungesa e infrastrukturës për trajtimin ujërave sanitare apo industriale të shkarkuara në trupa ujorë edhe në të ardhmen do të jetë burim i ndodjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntoksore si burime që përdoren për nevoja të qytetarëve. Një burim tjetër i ndodjes është edhe hedhja e mbeturinave urbane apo atyre ndërtimore në shtrëtit të ujërjedhave apo afër tyre.

1.3.13.5 MASAT PARANDALUESE

Zgjerimi i rrethit të ujitjes së tokave bujqësore nga institucionet kompetente, ose krijimi i ndonjë pende në pjesën kodrinore të komunës së Rahovecit, i cili pastaj do ta mundësojë zbuljen e problemeve që shkaktohen nga thatësitrat e tokave bujqësore.

VLIRËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKËQËSITË NATYRORE DHE FATKËQËSITË E TIERA

Skenari

Emri i skenarit: Skenari 1 Nga Thatesira

Frekuenca e ndodhjes:

- ☐ Shumë e mundshme (gjasat 100% në vitin e ardhshëm);
- ☐ E mundshme(gjasat 10-100% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 10 vitet e ardhshme);
- X ☒ Ka gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme);
- ☐ I pamundshëm (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme);

Madhësia e mundshme:

- ☐ E papërfillshme (më pak se 10%) X ☐ E kufizuar(10 deri 25%)
- ☐ Kritike: 25 deri 50%. ☐ Katastrofike: Më shumë se 50%

Lloji i skenarit:


- x ☒ Skenari 1; ☐ Skenari 2; ☐ Skenari 3;

Ndikimi:

- ☐ I papërfillshëm; ☐ I vogël ; X ☒ I mesëm ; ☐ Katastrofike;

Data e vlerësimit:

21.04.2022



- E pamundur
- E pabesueshme
- E besushme
- Gati e mundur
- E sigurt

1.3.14 RREZIQET NGA EPIDEMITË DHE PANDEMITË

1.3.14.1 KARAKTERISTIKAT E TERRENT DHE ZONAT POTENCIALE

Shkaktarët e paraqitjes së epidemisë, endemisë dhe pandemisë

Depërtimi i agjencësve biologjikë dhe shumëzimi i tyre në organizmin e sulmuar, quhet infektim. Nëse ky infektim përcillet me reaksion të organizmit të sulmuar, është gjala për shfaqjen e sëmundjes ngjyësë. Kushlet e nevojshme për shfaqjen dhe zhvillimin e sëmundjes ngjyësë- infektimit, janë:

1. Burimet e infektimit: janë njerëzit e sëmurë, kafshët, bartësit e bakterieve dhe të virusëve, si dhe kuformat e njerëzve dhe të kafshëve.
2. Rrugët e bartjes: janë mënyrat e bartjes së agjencësve biologjikë, prej burimit të infektimit, deri në organizmin pranuës. Të shumtën janë personat e infektuar, uji, ajri, ushqimi, toka, si edhe faktorët të tjerë, si brejtësit dhe insektet.

1.3.14.2 SËMUNDJET NGJITËSE

Dyert e hyrjes janë: lëkura, mukozat, organet e frymëmarrjes dhe organet e tretjes. 4. Numri dhe virulentshmëria: është aftësia e bakterieve dhe e virusëve për të depërtuar në organizëm, t'i përshatën ambientit të ri, të fillojnë të shumëzohen dhe të shkaktojnë sëmundjen ngjyësë. Pas virulentshmerisë, edhe numri i bakterieve dhe i virusëve luan rol të caktuar në mekanizmin e lindjes së sëmundjes ngjyësë.

Dispozita dhe imuniteti: Dispozita është prirja e organizmit për ndonjë infektim. Në këtë ndikojnë: vjetërsia, gjinia, profesioni, kushtet sociale-ekonomike, kondicioni fizik, stina dhe kushtet e tjera jetësore. Imuniteti është rezistenca e organizmit ndaj sëmundjes së caktuar ngjyësë. Vijat mbrojtëse të organizmit: Njeriu, si edhe qeniet e tjera të gjalla, ka tre vija mbrojtëse, për luftë kundër mikroorganizmave:


- Vija e parë mbrojtëse: lëkura dhe mukozat e shëndoshë.
- Vija e dytë mbrojtëse: rruzat e kuqe të gjakut dhe sistemi limfatik.
- Vija e tretë mbrojtëse: mëlqia dhe pankreasi. Sëmundjet infektuese shfaqen në formë:
 - Endemie: përfshin një lokalitet të caktuar;
 - Epidemia: përhapja e shpejtë e infektimit të popullatës në një zonë të caktuar dhe
 - Pandemia: kur popullatën e një ose më shumë kontinenteve e përfshin sëmundja ngjyësë;
 - Gripi pandemik: Gripi i shpendëve, Gripi i ri (i derrave);
 - Sëmundjet bio-terroriste (Eheli hemorragjike, Bruceloza, Tularemia)
 - Epidemitë dhe pandemitë e papritura (shembulli: eheli hemorragjike - krime kongo, COVID 19, lija e majmuni, etj.)
 - Helmimet masive me ujë dhe ushqim.

1.3.14.3 PASOJAT NGA EPIDEMITË DHE PANDEMITË (MUJATË MË KRITIKË TË
VITIT, EFEKTET SIPAS EVIDENCAVE STATISTIKORE ETJ.)

- 1. Zonë potenciale për epidemi dhe endemi është i gjithë territori i Komunës së Rahovecit me prethinë.
- 2. Shkaktarët e paraqitjes së epidemive dhe endemive janë viruset dhe mikroorganizmat e tjerë si paraqitja e rrigrave.
- 3. Sëmundjet ngjyëse më të shpeshta janë virusi i Influcencës, Eitet hemoragjike, pickimi nga rrigrat dhe Covid 19.




Graf. 10 Numri i personave të pickuar nga Rrigrat 2017 – 2022



Harta 32: Zonat e rrezikuara nga pickimi i rrigrave (Burimi i të dhënave Komuna e Rahovecit). Zonat e rrezikuara janë të prezantuara në hartë:

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË E TËRA



Epidemitë dhe pandemitë e bazuara në vlerësimet dhe analizat e shërbimeve kompetente:

- shëndetësore,
- sanitare,
- veterinerë,
- bujqësore,
- treguesit realë të shkaklarëve,
- institucione përkatëse me specifikat e zonave më të rrezikuara.

1.3.14.4 BARTËSIT DHE PËRGJEGJËSIT E AKTIVITETEVE TË RREGULLTA DHE MASAT PARANDALUESE

- * Kur kollitëni ose teshitëni, gojëni dhe hundën mbyllëni me një shami. Shaminë që përdoret hidhëni.
- * Pasi teshitëni ose kollitëni, duart lajini me ujë dhe sapun ose me antiseptikë që përmbajnë alkol.
- * Mos prekni me duar të palara hundën dhe gojëni.
- * N.q.s. sëmundëni, 7 ditët e para qëndroni në shtëpi.

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKËQËSITË NATYRORE DHE FATKËQËSITË E TJERA

- * Qëndroni larg njerëzve që dyshoni.
- * Ajroseni shpesh ambientin ku qendroni.

1.3.14.5 HARTA E RREZIQEVE

Mund të jete i rrezikuar i gjithë territori i komunës së Rahovecit sikur rasti i COVID-19. Ndërsa rastei më të shpeshta te pickimit nga rrugat janë vendbanimet, si: Zatriqi, Drenoci, Senoci, Pasiaceli, Polluzha, Kazniku dhe Guri i Kuq.

Skenari

Skenari i ashpër - shkalla e sulmit është 7%, numri i të sëmurëve është 7, shkalla e vdekshmërisë 7%, numri i të vdekurve 7. Vdekshmëria në Kosovë, një vend me popullsi të re, mund të jetë relativisht e lartë pasi pandemië në të kaluarën kanë prekur në veçanti popullsinë e re.

Emri i skenarit: Skenari 1 RREZIQET NGA EPIDEMITË DHE PANDEMITË

Frekuenca e ndodhjes:

- ☐ Shumë e mundshme (gjasat 100% në vitin e ardhshëm);
- ☒ E mundshme(gjasat 10-100% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 10 vitet e ardhshme);
- ☐ Ka gjasë (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme);
- ☐ I pamundshëm (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme);

Madhësia e mundshme:

- ☐ E papërfllshme (më pak se 10%)
- ☒ E kufizuar(10 deri 25%)
- ☐ Kritike: 25 deri 50%.
- ☐ Katastrofike: Më shumë se 50%

Lloji i skenarit:

- ☒ Skenari 1;
- ☐ Skenari 2;
- ☐ Skenari 3;

Ndikimi:

- ☐ I papërfllshëm;
- ☒ I vogël ;
- ☐ I mesëm ;
- ☐ Katastrofike;

Data e vlerësimit:

21.4.2022

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË E TJERA

Katastrofike Kritike E mesme E vogël E papërfllshme	Pasojat				
	1	2	3	4	5
Gjasat					
	1	2	3	4	5
E pamundur					
E pabesueshme					
E besushme			X		
Gati e mundur					
E sigurt					

2. FATKEQËSITË E TJERA

2.1 VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË E TJERA

Bazohet në analizën e rreziqeve dhe të pasojave të mundshme në popullatë, të mira materiale, kulturore dhe në mjedis, brenda zonës së tyre si dhe atyre që mund të vijnë nga zonat fqinje si në vijim.

Të cilat mund ta rrezikojnë jetën dhe shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe tërë strukturës ekologjike me pasqyrën e ndërmarrjeve të cilat merren me prodhimin, depozimin dhe shpërndarjen e materieve të rrezikshme dhe të dëmshme;

2.1.1 SHPËRTHIMI I PENDAVE HIDRO-AKUMULUESE

Ku rreziku i mundshëm bazohet në:
Rrezik real të përmasave më të mëdha për një pjesë të territorit të komunës së Rahovecit paraqet dëmtimi i pendës hidroakumuluese të KRU - Gjakovës (ish Hidrosistemit Radoniq). Kjo digë në gjatësi prej L=770m, dhe lartësi 61m.

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË E TJERA

Vetë konstruktii i digës së ndërtuar ka përbajtur të qëndrueshme ndërtimore e cila sipas vlerësimeve të ekspertëve - projektuesve të kësaj dige mund të përballojë lëvizje sizmike të tokës deri në 9 shkallë të Rihterit.

2.1.2 POTENCIALIN AKUMULUES TË LIQENEVE DHE TË POZITËS SË TYRE

Maja e parë bëhet në muajin Maj, kur bazeni është me kapacitet të plotë (456,00 NNm $V=117.792.633m^3$)të ujit dhe në muajin shtator kur uji arrin nivelin më të ulët, si pasojë e shpenzimit më të madh gjatë muajve të verës.

Gjendja momentale e digës, bazuar në majet gjeodezike dhe gjeomekanike, tregon se trupi i pendës është në kufijtë e lejuar, sipas projektit, e gjithësi edhe deformimet e saj janë në kufijtë e lejuar.


2.1.3 PASOJAT NGA SHPËRTHIMI I PENDËS HIDRO-AKUMULUESE

Me dëmtimin e mundshëm të digës së Radoniqit, vala vërshuese, drejtpërdrejt rrezikon këto fshatra (me këto karakteristika të dinamikës së përmbyjjeve):

2.1.4 PASOYRËN E REZULTATEVE TË MATJEVE DHE VLERËSIMIN E GJENDJES SË TRUPIT TË PENDËS.

Harta 33: Zona e rrezikuar nga përmbytjet nga Liqeni i Radoniqit

VLERËSIMI I RREZIOEVE NGA FATKËQËSITË NATYRORE DHE FATKËQËSITË E TJERA



2.2 VLERËSIMI PËR FATKEQËSITË NUKLEARE, RADIOLOGJIKE, KIMIKE DHE BIOLOGJIKE

Hartohet ekskluzivisht në nivelin qendror, ndërsa autoritetet e nivelit lokal planifikojnë zbatimin e obligimeve, që dalin nga planet dhe programet qendrore të kësaj fushe.

2.2.1 VLERËSIMI PËR RREZIQET NGA VEPRIMET LUFTARAKE DHE TERRORISTE

Hartohet në bazë të dokumenteve strategjike të Republikës së Kosovës, të dokumenteve publike që i harton Ministria e Punëve të Brendshme apo Ministria e Mbrojtjes, bazuar në strukturën e përcaktuar, madhësinë dhe veprimet e forcave operative për veprim në fatkeqësi. Çka është terrorizëm e çka jo, veç një kohë të gjatë i ka përcukur teoritien, ekspertët dhe politikanët. Deri më tani nuk është harmonizuar definicioni mbi terrorizmin. Shpeshherë, termi terrorizëm zëvendësohet me termin terror ose anasjelltas, për këtë arsye është e nevojshme të bëhet dallimi teorik në mes të këtyre dy kupimeve.

Terrorizmi konsiston në kryerjen e një krimi nga një individ, një grup apo nga një shtet. Terrorizmi përdoret për të ngjallur te njëzëiti një ndjenjë frike, e cila në shumë raste është shumë më e madhe se pasojat e vëreta të aktit. Këto akte kanë dy shënjestra, popullsinë ose dikasteret e rëndësishme të një shteti. Shtaqet e terrorizmit janë politike, për destabilizimin e një shoqërie por edhe për hakmarrje. Qëllime të ndryshme kanë çuar në themelimin e organizatave të ndryshme të cilat më pas, nëpërmjet mesazheve të tyre me karakter politik ose fetar, ngjallin frikë dhe panik në radhët e popullsisë. Shumë ide politike janë instrumentalizuar nga organizata terroriste për të justifikuar veprimet e tyre. Si rrjedhojë, grupe terroriste ekzistojnë në çdo ideologji. Me analizimin e përmbajtjeve të definicioneve të terrorizmit, mund të konkludojmë se pak a shumë prezantohen këto kupime: kërcënimi, dhuna, frika, aspekti politik – efekti – qëllimi, efekti psikologjik dhe reagimi i pakontrolluar, moszgjedhja e caktit dhe e viktimave, planifikimi i qëllimshëm dhe organizimi sistematik i aksioneve, mënyra e luftës, akti kundër - ligjor etj. Duhet të theksohet se Kosova nuk ka përcaktuar ndonjë sulm terrorist dhe, në përgjithësi, nuk konsiderohet si vend me rrezik të veçantë për sulmet terroriste. Sidoqoftë, ngjarjet e sulmeve terroriste janë rritur. Përvojat e fundit në Irak, Afganistan, Pakistan, Spanjë, Turqi e vende të tjera, demonstrojnë se ky rrezik është më evident se më parë. Në këtë shojcë është dhënë një përshkrim i përgjithshëm që lidhet me sulmet terroriste.

Karakteristikat bazë të veprimeve terroriste:

- Ekspertiza për aktet terroriste dhe parandalimi i tyre realizohet nëpërmjet një pune shumë të specializuar ku përshihen shërbimet sekrete, njësi të specializuara të policisë dhe të forcave të armatosura dhe shpesh edhe rrejte ndërkombëtare të specializuara. Si rezultat, këto çështje janë jashtë përgjegjësi dhe parametrave të punës së atyre që merren me çështjet e emergjencave civile.
- Sidoqoftë, në rast të ndodhjes së ndonjë akti terrorist mbi objekte ose mbi njerëz, atëherë janë mekanizmat e përballimit të emergjencave civile, të cilët duhet të përgjigjen në të njëjtën mënyrë, si në rastet e fatkeqësive natyrore.

- Eksplozionet mund të kërkojnë ndërhyjen e menjëhershme të grupeve të kërkim-shpëtimit dhe menaxhimit e të dëmtuarve në masë për të shpëtuar jetët e njerëzve në të njëjtën mënyrë, si dhe në rastin e një tërmeti të vogël. Në mjaft situata kërcënuese terroriste janë dashur evakuime të shpejta dhe masive të njerëzve për t'i siguruar ata nga kërcënimet e mundshme, madje edhe nga një

paralajmërim.

- Megjithatë, ka faktore të veçantë shtesë që duhet të merren parasysh, duke përfshirë sulmet dytësore pas një sulmi që, nga pamja e jashtme, duket si kryesor, si dhe ngjarje jo të zakonshme, si për shembull sulmet me armë të shkatërrimit në masë (ASHM), për të cilat nuk ka shumë përvojë.
 - Duke u nisur nga natyra e tyre, sulmet terroristë zakonisht ndodhin pa paralajmërim ose me një lajmërim në çastin e fundit, por mund të pasohen nga një numër ngjarjesh të lidhura dhe ndonjëherë të koordinuara që shkaktojnë panik dhe strese të mëdha. Fjala terrorizëm do të thotë: dhunë e paramenduar ndaj masës jo-luftarake me qëllim ndikimi në opinionin publik për të arritur më pas në goditjen e objektivave me natyrë politike, ushtarake apo ideologjike.
 - Parandalimi është detyrë e strukturave dhe e institucioneve të specializuara.
 - Sulmet terroristë janë të paparashikueshme, kështu që, për përballimin e tyre, parapëlqehet të planifikohet në të njëjtën mënyrë si për çdo emergjencë civile tjetër, në mënyrë që të jetë e mundur të kalohet në këto plane, nëse një situatë e tillë bëhet realitet.
 - Sulmet terroristë shpesh nuk kanë paralajmërime të hershme, megjithëse mund të ndodhë të bëhen lajmërime me telefon në minutën e fundit. Në rast të tillë, mobilizimi i shpejtë i forcave operacionale duhet të aktivizojë strukturat përkatëse si dhe për rastet e fatkeqësive natyrore. Zakonisht përparësi kanë evakuimi i shpejtë dhe i sigurt si dhe izolimi i zonës së kërcënuar.
 - Për ndërhyrjet në publik në lidhje me kërcënimet terroristë është e nevojshme të merret një vendim nga instancat e larta qeveritare. Marrja e këtij vendimi për rrënimin e gatishmërisë, pra rrënimin e vigjilencës dhe e njohurive të publikut mbi atë çfarë duhet të bëhet në raste të tilla, është me rëndësi shumë të madhe pasi në këtë mënyrë shpëtohen jetë njerëzish. Këto aktivitete duhet të bëhen në të njëjtën mënyrë si për rastet e tërmeteve ose të përmbytjeve. Si rezultat, duhet të ndërmerren të gjitha aktivitetet për angazhimin e përbashkët të publikut dhe të institucioneve në këtë drejtim. Shkollat, administrata publike, spitale, subjektet private, media lokale dhe publike duhet të angazhohen për të transmetuar mesazhe të thjeshta dhe koherente nëpërmjet të gjitha mjeteve të komunikimit, duke u bazuar në njoftimet zyrtare.
 - Praktikimi dhe testimi i planeve nëpërmjet stërvitjeve është me shumë vlerë edhe në një situatë sulmi terrorist.
 - Veprimet e menjëhershme të kërkim-shpëtimin ndërmerren kryesisht nga komunitetet e prekura, ku pjesa më e madhe e njerëzve shpëtohen nga familjarët, miqtë ose fqinjët.
 - Trajtimi i menjëhershëm mjekësor do të nevojitet për t'ua ofruar të plagosurve. Një fatkeqësi e një përmasë të madhe do të kërkojë angazhim të gjërë jo vetëm të kapaciteteve lokale, por edhe të atyre kombëtare.
 - Bëhet, gjithashtu, edhe një vlerësim i shpejtë i sigurisë së objekteve si dhe për dëmet dhe nevojat më emergjente.
 - Mbatja e rendit publik dhe dhënia e një informacioni të saktë janë shumë të rëndësishme për të vendosur qetësinë si dhe për të ulur pëshijellimin e mëtejshëm që të mos shkaktohen viktima të tjera.
 - Mund të jetë e nevojshme të evakohet e gjithë popullsia nga zona e prekur ose nga zona të tjera që mund jenë nën rrezik të lartë. Në këtë situatë nevojitet mbajtja nën kontroll e rendit publik, dhënia e informacioneve të qarta, dhënia e mesazheve dhe e udhëzimeve për popullsinë si dhe informimi për zonat e sigurt të identifikuara më parë.
 - Mund të kërkohen ose të ofrohen operacione ndërkombëtare të specializuara të kërkim-shpëtimin.
- Ardhja e skuadrave të kërkim-shpëtimin do të shoqërohet me kërkesa për transportin ajror dhe për

mijelet e transportit rrugor gjatë përpjekjeve për t'i dislokuar ato në zonat e prekura, sa më shpejt të jetë e mundur.

- Edhe gjatë trajtimit të menjëhershëm mjekësor dhe të operacioneve të kërkim-shpëtimit, mund të vlerësohen rreziqet dytësore për objektet e dëmtuara.
- Mbështetja logjistike është shumë e rëndësishme për një përballim të suksesshëm. Rrjeti rrugor, telekomunikacioni dhe infrastruktura tjetër duhet të vihen në funksion sa më shpejt dhe sa më mirë që të jetë e mundur, me gjithë kufizimet.
- Nëse njerëzit mbeten brenda strukturave të prishura, skuadrat e specializuara të kërkim-shpëtimit, pasi të sigurohen, duhet të fillojnë menjëherë operacionet. Pjesa më e madhe e personave që shpëtohen do të jetë gjatë 24-48 - orështit të parë pas ngjarjes.
- Siguria, eliminimi i materialeve të rrezikshme ose pastrimi i zonës nga ndotjet, si dhe sigurimi i strukturave të dëmtuara, duhet të garantohen para se popullsia të kthehet e sigurt në zonën e prekur.
- Shërbimet publike bazë ku përfshihen uji i pijshëm, ujërat e zeza, përdorimi i rrugëve dhe furnizime me energji, duhet të sigurohen sa më shpejt të jetë e mundur.
- Duhet të merren vendime të shpejta në lidhje me objekte bazë publike (duke përfshirë ndërtesat e shkollave dhe të spitalëve) që mund të jenë shkatërruar ose dëmtuar rëndë. Ndërtesat që nuk riparohen, duhet të prishen plotësisht dhe të merret në konsideratë zëvendësimi i tyre i përkohshëm ose i përhershëm.

2.2.2 VLERËSIMI I RREZIQEVE TË RREZATIMIT RADIOAKTIV NË KOMUNËN E RAHOVECIT

(Ky material është i vlefshëm për vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve dhe të fatkeqësive natyrore)

Në territorin e komunës së Rahovecit, përkatësisht në pjesën verilindore dhe veriore të saj, ekzistojnë disa miniera të vogla dhe të mesme, në të cilat në të kaluarën e afërt është bërë nxjerrja dhe eksploatimi i xeheve dhe i mineraleve të ndryshme. Në hyrje të fshatit Zatriq, janë gjithsej 3 miniera. Një minierë e vogël ndodhet afër fshatit Kaznik dhe dy të tjera janë në zonën ndërmjet fshatrave Kramovik dhe Guri i Kuq. Në njëërën minierë që ndodhet mbi fshatin Kramovik, e cila ka mbi 300 metra galeri të hapura nëntokësore, ka edhe sasi uji, të cilin banorët e Kramovikut e kanë përdorur dhe e përdorin për nevoja shëtpike, por jo për pije. Poashtu, sasi uji ka edhe galeria e minierës, në hyrje të fshatit Zatriq. Duke marrë parasysh se në këto zona ku ekzistojnë këto miniera, ka përmbytje minerare të shkëmbinjve, ekziston mundësia që në galeritë e këtyre minierave dhe në sipërfaqet e tyre të ketë koncentrim në sasi të caktuara të gazit të Radonit, i cili si element radioaktiv, krijohet si rezultat i zëbërthimit radioaktiv të Uraniumit, Toriumit dhe Radiomit dhe përmes shkëmbinjve emetohet në hapësirat e galerive të këtyre minierave deri në sipërfaqet e tyre.

Gazi i radonit prodhohet nga zëbërthimi natyror radioaktiv i uranumit, i cili gjendet natyrshëm në toka dhe shkëmbinj. Përveç kësaj, ai gjithashtu mund të jetë i pranishëm në ujë. Radoni vjen nga toka, uji dhe furnizimi me ujë. Disa materiale ndërtimi gjithashtu emetojnë radon. Ky është gaz me origjinë natyrore që nuk mund të nuhatet, sepse nuk ka erë, ngjyrë e nuk ka shije. Ky gaz del lehtë nga toka dhe kalon në ajër, ku zëbërthehet dhe lëshon sasi të vogla të grimcave radioaktive. Kur jemi në një mjedis ku është i pranishëm radoni dhe e thithim atë, këto grimca depozitohen në qelizat që mbështesin rrugët e frymëmarrjes. Gazi i radonit është natyror dhe inert, megjithatë nivele të larta rrezatimi në trup dhe ekspozimi ndaj këuj gazi mund të dëmtojë ADN-në dhe të çojë

në kancer të mushkërive. Gazi i radonit konsiderohet shkaku i dytë më i rëndësishëm i kancerit të mushkërive, pas duhanit. Në një vend, varësisht nga zakonet e pijes së duhanit dhe përqendrimi mesatar kombëtar i radonit, përqindja e kancerit të mushkërive, të shkaktuara nga ky gaz, mund të ndryshojë midis 3% dhe 14%, sipas të dhënave të OBSH-së. Gazi i radonit tretet shpejt në natyrë, dhe në përqendritje të ulëta nuk paraqet shqetësim shëndetësor. Normalisht përqendrimi i tij në ajër ndryshon ndërmjet 5 dhe 15 Bq / m³ (Bekerele është njësi matëse e aktivitetit radioaktiv). Në këto përqendritje asnjë problem nuk qëndron, e aq më pak jashtë. Sidoqoftë, në hapësirat e mbyllura, përqendrimet e gazit të radonit janë më të larta sepse nuk hollonhet aq lehtë. Për shembull, në miniera, shpella dhe impiante të trajtimit të ujit, këto janë zonat ku regjistrohen nivelet më të larta të radonit. Nga ana tjetër, diçka që prek më shumë qytetarët është përqendrimi i këtij gaz në ndërtesa, sidomos në bodrume dhe në katet përdehës të shtëpive dhe të ndërtesave . Në shtëpi, shkolla dhe zyra, përqendrimet e radonit ndryshojnë midis 10 dhe 10.000 Bq / m³. Ky tashmë mund të jetë një problem.

Skenar - Si të zvogëlojmë përqendrimet e gazit të radonit në shtëpi dhe ndërtesa?

Ekzistojnë metoda të provuara dhe afatgjata për të parandaluar rrjedhjen e këtij gazit në shtëpi të reja ndërtimore dhe për të zvogëluar përqendrimin e tij në shtëpitë ekzistuese.

- Së pari, nëse duam të parandalojmë që gazi i radonit të hyjë në shtëpitë që po ndëtojmë, duhet të marrim parasysh zonën gjeologjike ku do t'i ndëtojmë shtëpitë dhe ndërtesat publike. Nëse shkëmbi në nëntokën ku do të ndëtohet ndërtesa ka përqendritje të larta të gazit radon, është më mirë të mos e bëjmë këtë. Në shumë vende në Europë dhe në Shtetet e Bashkuara, masat e mbrojtjes miratohen sistematikisht në ndërtesa të reja dhe në disa vende është edhe e detyrueshme.
- Së dyti, zvogëlimin e përqendrimin të gazit radon në shtëpinë apo ndërtesën ku jetojmë, mund ta bëjmë duke ndjekur këto udhëzime:
 - ✎ përmirësimi i ventilimit të pllakës;
 - ✎ instalimi i një sistemi mekanik të nxjerrjes së radonit në bodrum, dysheqe;
 - ✎ parandalimi i depërimit të radonit nga bodrumi në dhomat e gjumit;
 - ✎ përmirësimi i ajrosjes (ventilimit) së shtëpisë.

Duke mbajtur parasysh këto udhëzime, përqendrimi i gazit të radonit mund të reduktohet me 50%.

A mund të jetë gazi i radonit në ujë të pijshëm?

Në shumë vende, burim i furnizimit me ujë të pijshëm janë ujërat nëntokësore. Megjithatë këto ujëra janë në kontakt të vazhdueshëm me shtratin e shkëmbinjve, nëse ka përqendritje të larta të uraninit, gazi i radonit do të lirohet dhe do të vijet në kontakt me ujin. Sidoqoftë, deri më sot, në studimet epidemiologjike të kryera, nuk është gjetur asnjë marrëdhënie midis pranisë së radonit në ujë të pijshëm dhe një rreziku në rritje të kancerit të stomakut. Sasia e radonit, e thithur nga frymëmarrja, është më e madhe se sasia e gëlltitur nga pija. Gazi që tretet në ujë, normalisht, kalon në ajrin e hapësirave të brendshme.

Rekomandime për mbrojtjen ndaj ekspozimit nga gazi i radonit dhe radioaktiviteti

Megjithatë në disa zona në territorin e komunës së Rahovecit ekzistojnë disa miniera ku janë nxjerrë dhe eksploatuar xehë dhe mund të ketë aktivitete të tilla edhe në të ardhmen, rekomandojmë që:

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKËQËSITË NATYRORE DHE FATKËQËSITË E TIËRA

- Këto 3 zona të përmendura më sipër të shpallen “Zona të mbikëqyrura” në përputhje me RREGULLOREN E QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS (QPK) NR.08/2020 PËR KUFITË E DOZAVE DHE MBROJTJEN NGA RREZATIMI. Në rast se fillojnë apo zhvillohen aktivitete hulumtimi apo punime në minierat e këtyre zonave, punëdhënësi duhet që, punëtorët që do t'i angazhojë për këto qëllime, t'i pajisë me mjetet e duhura mbrojtëse ndaj rrezatimit radioaktiv, sepse mund të ekspozohen nga aktiviteti radioaktiv i gazit të radonit.
- Të bëhen matjet e duhura të nivelit të përqendrimit të gazit të radonit në brendësinë e minierave dhe në sipërfaqet e tyre nga ekspertë të fushës së fizikës, përkatësisht të fushës së mbrojtjes nga rrezatimet radioaktive. Ndihmë konkrete në këtë aktivitet mund të japë Agjencia e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi. Niveli i referencës për përqendrimin mesatar vjetor të aktivitetit në ajër nuk duhet të jetë më i lartë se 300 Bq/m³.
- Matjet e radonit të kryhen në përputhje me nenin 35 të rregullores për kufijtë e dozave dhe mbrojtjen nga rrezatimi, sipas së cilës niveli i referencës për përqendrimin mesatar vjetor të aktivitetit në ajër nuk do të jetë më i lartë se 300 Bq/m³. Në vendet e punës brenda zonave të identifikuara në përputhje me planin kombëtar të veprimit për radonin, të cilat janë të vendosura në katin e parë ose në bodrum, duke marrë parasysh parametrat që përbahen në planin kombëtar të veprimit.
- Matjet e përqendrimit të radonit duhet të kryhen dhe të bëhet monitorimi i këtij përqendrimi edhe në ndërtesat publike të banimit, në ndërtesa të shkollave, të kopshteve, të çerdheve dhe të institucioneve të tjera publike. Këto matje duhet të bëhen sidomos në katet përtheshë, bodrume dhe në katet e para e të dyta të ndërtesave publike dhe private.
- Asnjë ndërtim nuk do të duhej të ndodhë pa një analizë gjeologjike dhe radiologjike të vendit apo të sipërfaqes ku do të bëhet ndërtimi. Pra, paraprakisht, duhet që të bëhen matje, në mënyrë që të sigurohemi se a ka apo jo aktivitet radioaktiv si pasojë e rrjedhjes së gazit të radonit në sipërfaqen ku propozohet vendosja e themeleve të ndërtesave.
- Të kontrollohet cilësia e ujit që banorët eventualisht e shfrytëzojnë nga pusët aktuale të minierave në Zatriq, Kramovik dhe Kaznik.
- Të kontrollohet cilësia radiologjike e materialeve ndërtimore që eksploatohen nga gurrëthyesit që operojnë në zonën e Zatriqit.
- Në Qendërën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), ndonëse janë bërë matje dhe vlerësime për nivelet e ekspozimit radioaktiv, që emetojnë pajisjet radiologjike gjatë

ekzaminimeve me treze X, këto majë dhe vlerësime duhet të vazhdojnë të bëhen sistematikisht, në mënyrë që të sigurohemi për nivelet e ekspozimeve mjekësore që marrin pacientët e ekzaminuar me treze X, e poashtu edhe për dozat e rrezatimit që emetojnë gjatë kohës pajisjet radiologjike që përdoren në reparat e radiologjisë.

Harta 34: Pikat e rrezikuara nga Minierat (rrezatimi nga radioaktiviteti - burimi i të dhënave Komuna e Rahoveci) aneksi i hartave.

2.3 VLERËSIMI DHE PASOJAT E INFRASTRUKTURËS KRITIKE

(Tek vlerësimi i rreziqeve të llojit, intensitetit, efektit dhe pasojave të mundshme nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, duhet të identifikohet dhe priorizohet infrastruktura kritike në harmoni të plotë me Ligjin nr.06/L-014 për infrastrukturën kritike ose me ligjin pasues, si dhe aktet nënligjore).

2.4 STRUKTURAT PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

*Në vlerësim duhet të përcaktohen kapacitetet, forcat dhe shërbimet
Të cilat fushëveprimin e tyre e kanë të rregulluar sipas aktit nënligjor për organizimin e strukturave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë (SMSHN).*

Sektori për Mbrojtje dhe Shpëtim është organ profesional, i cili merret me çështjet emergjente në komunë dhe si e tillë bën planifikimin dhe marrjen e masave për parapengiminin, zbuljen dhe eliminimin e pasojave nga fatkeqësitë natyrore, teknologjike e të tjera.

Struktura e saj organizative dhe përgatitjet e planeve mbrojtëse, mundësojnë mbulimin e të gjitha segmenteve me të cilat do të ballafaqohet shoqëria civile dhe strukturat shtetërore në komunë, në rast të situatave emergjente. Në punën e saj të përditshme, ajo i përgjigjet Kryetarit të Komunës dhe Asamblesë Komunale në Rahovec, e sipas resorëve edhe nivelit Qendror - Agjencionit për Menaxhim të Emergjencave, ndërsa me shpalljen e emergjencave civile, i përgjigjet dhe është komplet me tërë potencialin e saj në shërbim të Komitetit Komunal për Emergjencë, Planifikimi efektiv që bëhet në kuadër të sektorit është në funksion fillestar të menaxhimit, i cili njëheri siguron udhëheqje të mirëfilltë dhe rekomandon metodën e ekzekutimit (reagimit), përmes të të cilave u jupet përgjigje shumë pyetjeve siç janë: detyrat, potenciali njerëzor, koordinimi reciprok, ndarja e përgjegjësiave, ndarja e mjeteve gjatë emergjencave etj.

Në bazë të vlerësimeve të gjithanshme profesionale dhe konstatimeve faktike në terren dhe duke marrë për bazë kompetencat dhe funksionet që ushtron ky sektor i jep propozimin Komitetit Komunal për Emergjencë shpalljen e gjendjes së emergjencës civile në një pjesë apo në tërë territorin e komunës. Në kuadër të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim veprojnë ekipet:

- a) Njësia e Zjarrfikësve;
- b) Zyra për Alarmim dhe Koordinim emergjent.

a. Njësia e Zjarrfikësve

Detyrat dhe përgjegjësitë: Në raste të aksidenteve-fatkeqësiive të përmasave të mëdha, Njësia e

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË E TJERA

Zjarrfikësve, së bashku me subjektet e tjera përkatëse të involvuara në raste emergjente do t'i kryejnë këto veprime:

- Zjarrfikje dhe detyra të tjera në raste zjarrri. (Koha e arritjes është pasqyruar në tabelë);
- Pozicionimi dhe shuarja e zjarreve përgjatë akseve rrugore dhe hapja e koridoreve për intervenim deri në zonën e incidentit;
- Do të sigurojë hyrje për shpëtimtarët për në lokacionet me tym, nëse ata nuk janë të pajisur me mjete standarde (boca oksigjeni etj);
- Misione shpëtuese lidhur me aksidentet dhe katastrofat natyrore, në raport me mundësitë dhe pajisjet e tyre;

- Do të sigurojnë operacione të shpëtimit në pyje;
 - Veprime të Evakuimit dhe të Shpëtimit në rast zjarrri;
 - Veprime të kërkim-shpëtimit në aksidente rrugore;
 - Veprime të kërkim-shpëtimit në ambiente nënujore etj.
 - Kryen edhe shërbime të tjera të natyrës medikale në vendin e incidentit dhe bartjen e të lënduarve në qendrën spitalore;
 - Kryen edhe punë e detyra të tjera sipas nevojës dhe situatës emergjente dhe lidhur me këto detyra i përgjigjet në vertikale Kryetari të Komitetit Komunal për Mbrojtje dhe Shpëtim;
- Aktualisht, Njësia e Zjarrfikësve, në përbërjen e vet, ka:
- 16 Zjarrfikës;
 - 1 Komandant i Njesisë.

Tab 45 Automjetet në përdorim nga NJPZSH- Rahovec

Nr.	Targat e Automjett	Lloji i Automjett	Fuqia	Viti i Prodhimit	Lloji i karburantit	Kapaciteti i cisternës me ujë	Numri i ulësve	Shfrytëzuesi i Automjett	Gjendja teknike e automjett
1.	07Z-35-16	ISUZU Sulmues	5193 cm ³	2018	Dizel	2000 lit	3	NJPZSH- Rahovec	Të rregullt
2.	11Z-09-08	RENAULT Tanker	6174 cm ³	1993	Dizel	4000 lit	8	NJPZSH- Rahovec	Të rregullt
3.	11Z-12Z-05	RENAULT Sulmues	8830 cm ³	1990	Dizel	1800 lit	2	NJPZSH- Rahovec	Të rregullt
4.	11Z-119-05	IVECO Malor	2998 cm ³	2014	Dizel	1000 lit	7	NJPZSH- Rahovec	Të rregullt
5.	07Z-17-16	TOYOTA Komandues	3000 cm ³	2000	Dizel		5	NJPZSH- Rahovec	Të rregullt
6.	07Z-16-16	TOYOTA Komandues	3000 cm ³	2000	Dizel		5	NJPZSH- Rahovec	Të rregullt

b. Zyra për Alarmim dhe Koordinim Emergjent

Roli dhe rëndësia:

- Sigurimi me kohë i të dhënave (informacioneve) kualitative për të ndërmarrë vendime dhe aksione drejtuese për t'i përballuar situatat emergjente në komunë e me gjerë.
- Bën grumbullimin, ruajtjen dhe distribuimin e të gjitha informacioneve që kanë të bëjnë me të gjitha

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË E TJERA

llojet e rreziqeve për jetën e njerëzve, qenieve të gjalla, pronës dhe ambientit.

- Kontrolli dhe komunikimet në operacionet emergjente.
- Koordinimi i ekipeve dhe pajisjeve emergjente.
- Bashkëpunon me të gjitha subjektet, ekipet dhe personelin tjetër të involvuar në situatat emergjente.
- Mosfunksionimi i ZAKE-së rrezikon shfaqjen e defekteve serioze në menaxhimin e emergjencave në komunë. Lidhjet dhe qasjet e ZAKE-së, me shërbimet emergjente, momentalisht me të gjitha shërbimet emergjente ZAKE, ka qasje përmes:
- Telefonisë fikse dhe asaj mobile të PTK-së;
- Rrjetit të radiovalëve në dy frekuenca, ndërsa në perspektivë planifikohet që në kuadër të modernizimit dhe përsosjes së teknikës edhe qasja përmes :
- Rrjetit të Internetit,
- Rrjetit të Intranetit, dhe
- Rrjetit të mikrovalëve. Qytetarët do të kenë mundësi të kontaktojnë Zyrën për Alarmim dhe Koordinim Emergjent përmes :

Emergjent përmes :

- Telefonisë fikse,
- Radiolidhjes, përmes bashkëpunëtorëve të ZAKE-së, në territorin e komunës, ndërsa në të ardhmen qytetarëve do t'u mundësohet qasja edhe përmes telefonisë mobile dhe Internetit.

POLICIA E KOSOVËS

Policia e Kosovës, në raste të aksidenteve të mëdha (katastrofave), do të kryejë:

- Rrëhimin e perimetrit të sigurisë në vend - incident;
- Sigurimin e kontrollit në vend të ngjarjes (zonën e incidentit);
- Sigurimin e lëvizjeve dhe të trafikut në vendin e ngjarjes dhe përreth vendit të ngjarjes;
- Evakuimin e qytetarëve në rast shpërthimi - eksplodimi nga objektet;
- Mbledhjen dhe shpërndarjen e informatave me interes me subjektet e tjera të involvuara në situatat emergjente;
- Veprimet e hetuesisë në vendngjarje;
- Parandalimin e dukurive negatiive dhe vënien nën kontroll të situatës në rastet emergjente (vjedhjet, kaosi, anarkia, abuzimet e ndryshme etj);
- Mbeshtetje në sigurinë fizike të personelit komandues të incidentit.

FORCA E SIGURISË SË KOSOVËS (FSK)

Forca e Sigurisë së Kosovës, në rast të situatave emergjente, do t'i kryejnë gai të gjitha detyrat e emergjencës dhe do të jetë bashkëvepruese në këto raste. Brigada e BRSH – FSK-së, e cila operon në perëndim të territorit të Kosovës, do:

- Të sigurojë shërbime në raste të shkatërrimeve;
- Të kryejë shërbime të kërkim-shpëtimit në situata të ndryshme emergjente, dhe angazhimi i tyre në eliminimin e pasojave të shkaktuara;
- Të sigurojë asistencën humanitare në regjione të izoluar;
- Të kryejë shërbime emergjente medikale;
- Të bëjë zbatimin e detyrave të transportit në rast të kërkesës;
- Të bëjë aktivizimin e mjeteve të paeksploduara;

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË E TJERA

- Ndihmë në zbatimin e evakuimeve, si dhe detyra të tjera, të cilat paraqiten në raste emergjente.

SHËRBIMET MEDIKALE EMERGJENTE

Ekipe profesionale të shërbimeve medicinale, janë bartëse kryesore të aktiviteteve në sferën e shpëtimit të jetës dhe mbrojtjes shëndetësore të qytetarëve në situata emergjente. Struktura organizative e shërbimeve medikale, të cilat veprojnë në territorin e komunës së Rahovecit, mundëson që në situata emergjente, të ofrojnë shërbime cilësore si në terren (mobile) ashtu edhe në mjekimin stacionar. Kapacitetet medikale në kupimin e kuadrit profesional, teknikës dhe pajisjes medicinale, si dhe të objekteve të tjera përcjellëse për veprim emergjent, në komunën e Rahovecit, janë relativisht të mira. Koncepti të ri paraqet zhvillimi i Mjekësisë Familjare me qendër e saj në Rahovec dhe 11 punkte të shpërndara nëpër Bashkësi Lokale në komunë. Detyrat e ekipeve për shërbime medikale në situata emergjente:

- Ofrimi i ndihmës së parë medicinale në vendin e incidentit;
- Triazhimi i personave të aksidentuar, plotësimi i kartonit të triazhës së pacientit dhe mbajtja e evidencës;
- Evakuimi dhe bartja adekuate e personave të lënduar nga zona e fatkeqësisë në qendrat spitalore dhe repartet e tjera të specializuara medicinale;
- Martja e masave preventive antiepidemiologjike, si dhe luftimi i vatrave të mundshme të paraqitjes së tyre;
- Aplikimi i sistemit të mbrojtjes karantinë me rasin e shfaqjes së sëmundjeve të ndryshme infektive e të tjera;
- Informimi i popullatës lidhur me gjendjen sanitare në terren dhe dhënia e udhëzimeve - këshillave adekuate medicinale për veprim në situata të caktuara emergjente;
- Asanimi i terrenit - lokacionit të aksidentuar;
- Planifikimi dhe krijimi i rezervave kritike në medikamente dhe produkte të tjera farmaceutike për funksionim adekuat në situata emergjente.

SHËRBIMET PUBLIKE

Për funksionimin efikas të shoqërisë në situata emergjente civile, kontribut tejjet të rëndësishëm japin shërbimet publike komunale, të cilat me organizimin dhe shkallën e tyre të gatishmërisë veprouese, ndikojnë direkt në kualitetin e menaxhimit të emergjencave. Ndërmartjet të cilat kryesisht i japin ngjyrën infrastrukturës publike në territorin e komunës së Rahovecit, janë: SHP-ja, KEDS-i, PTK-ja, Ndërmartja për pastrim KRM Ekoregjioni dhe Ekodrinia, si dhe disa kompani nga sektori privat, që kryesisht merren me veprimtari shërbuese, furnizuese, transportuese, ngurore - ndërtime dhe të pastrimit. Në situata emergjente, secila nga fushëveprimtaria e saj:

- Zbaton vendimet e Komitetit Komunal për Menaxhim Emergjent dhe për aktivitetet e saja i përgjigjet këtij organi;
- Merr pjesë aktive në punën e këtij Komiteti dhe jep propozimet konkrete për tejkalimin e gjendjes emergjente, duke u bazuar në profesionalizimin dhe përvojat nga fushëveprimtaria e tyre;
- Me kohë bëjnë planifikimin e resurseve njetëzore dhe teknike për funksionim racional në situata emergjente dhe lidhur me këtë njofton KKMë-në mbi mundësitë reale të tyre.
- Caktojnë prioritetet në kryerjen e shërbimeve të tyre, dhe me pëlqim të KKMë-së, vendos disipiminin e vet të kryerjes së shërbimeve.

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKËQËSITË NATYRORE DHE FATKËQËSITË E TJERA

ORGANIZATAT JOQEVERITARE

Në situata emergjente, organizatat joqeveritare bëjnë:

- Sensibilizimin e opinionit të brendshëm dhe të jashtëm lidhur me situatën emergjente;
- Informimin e drejtë lidhur me masat dhe veprimet, të cilat subjektet involvuese, në situata emergjente, ndërmarrin për tejkalimin e gjendjes së krijuar;
- Parandalojnë panikun dhe shpërndarjen e dezinformatave te qytetarët;
- Hartimi i projekteve të cilat janë në funksion të përballimit të situatave emergjente në komunë;
- Krijimi i fondeve emergjente dhe thihja e donacioneve të ndryshme për plotësimin e nevojave akute;
- Pjesëmarrja aktive në furnizimin e qytetarëve nga zonat e aksidentuara me artikuj dhe gjëra të tjera elementare për jetesë;
- Pjesëmarrja aktive në lëmin e evakuimit dhe të strehimit;
- Bëjnë kërkime për burime të mëtejme për nevoja emergjente;
- Bashkëpunimi i ngushtë reciprok i tyre me të gjitha subjektet involvuese në emergjencat;
- Hartimi i analizave, i raporteve, i bilanceve dhe përpunimi i treguesve (indikatoreve) përmes të cilave përcillen rrjedhat në situata emergjente.

Tab 46 Regjistri i autoritetit lokal të Komunës së Rahoveci (potencial për drejtimin e komitetit për MSH).

Nr. referor	Emri	Mbiemri	Funkcioni	Kontakti:	E-mail adresa
1	Smajl	Latifi	Kryetar i Komunës	045/498-190	smajl.latifi@rks-gov.net
2	Fatmir	Iska	Nënkryetar i Komunës	044/243-153	fatmir.iska@rks-gov.net
3	Defrim	Kallexhiu	Kryesues i Asamblesë komunale	049/11-538	defrim.kallexhiu@rks-gov.net
4	Besnik	Hoti	Drejtor i Drejtorisë së Administratës	045/331-300	besnik.hoti@rks-gov.net
5	Afrim	Limani	Drejtor i Drejtorisë Buxhet dhe Financa	044/219-638	afrim.limani@rks-gov.net
6	Albanor	Mullaahazi	Drejtor i Drejtorisë për Urb. Plan. Mb. Mjedis	044/487-303	albanor.mullaahazi@rks-gov.net
7	Beral	Duraku	Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi e Zhr	045/134-003	beral.duraku@rks-gov.net
8	Avni	Morina	Drejtor i Drejtorisë së Asimit	044/423-590	avni.morina@rks-gov.net
9	Saranda	Sallëku	Drejtor e Drejtorisë së Shëndetësisë M/S	045/134-002	saranda.sallëku@rks-gov.net
10	Nora	Boshnjaku	Drejtor e Drejtorisë së Inspektoratit	045/090-625	nora.boshnjaku@rks-gov.net
11	Erhan	Morina	Drejtor i Drejtorisë për Ekonomi e Zhvillim	044/478-362	erhan.morina@rks-gov.net
12	Afrim	Dina	Drejtor për Kulturë, Rini dhe Sport	044/339-035	afrim.dina@rks-gov.net
13	Përparrim	Krasniqi	Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike Komunale	044/315-261	përparrim.krasniqi@rks-gov.net
14	Afrim	Oruçi	Drejtor i Drejtorisë për Gjodeci, Kadasër dhe Fronë	045/134-006	afrim.oruçi@rks-gov.net
15	Besmirë	Bytyqi	Drejtorja për Mbrojtje dhe Shpëtim	049/199-099	besmire.bytyqi@rks-gov.net
16	Policia		029/277-913		
17	Ujeshellësi	Jeton Kadiri	049/933-796		
18	Distribucioni i KEDS-it	Behar Berisha	044/127-963		
19	Shërbimet publike (Mbetrinat)	Mentor Veliu	044/122-885 Ekoregjioni		
		Qazim Hoti	044/ 661 -375 Ekodrinia		
20	OKMF	Elbani Kryeziu	044/634-812		
21	PTK		029/276-857		

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKËQSITË NATYRORE DHE FATKËQSITË E TJERA

22	Njësia e NJPZSH-së	029/277-555	
23	Shërbimi emergjent medical	0800 11 008	
24	Kryqi i Kuq	044/204-488	

2.4.1 VLERËSIMET PËFUNDIMTARE BËHEN PËR SECILËN MASË TË MBROJTJES DHE TË SHPËTIMIT

Në raport me mundësitë reale për mbrojtje dhe shpëtim si dhe vlerësimin e resurseve njerëzore dhe materiale të nevojshme, për tu përballur me pasojat e FNFT-së.

2.6.2 VLERËSIMET PËR STRUKTURËN DHE MADHËSINË E FORCAVE PËR REAGIMIN EMERGJENT

Trajnimin dhe aftësimin e tyre, përcaktimin e resurseve materiale të nevojshme, të prioriteteve dhe të drejtimeve të zhvillimit, si dhe definimin e procedurave standarde të operimit dhe të monitorimit.

Kanalet e kullimit, Rregullimi i shtretërve dhe argjinaturat e lumjeve, kapacitetet humane, teknike, financiare, nevoja për mobilizimin e ekipeve reaguese emergjente sipas rregullores per SMSHN, trajnimin dhe qertifkimin, Krijimin e ekipeve reaguese emergjente (ERE).

3. KOSTOJA FINANCIARE E DOKUMENTIT TË VLERËSIMIT

Komuna e Rahoveci,pyete drejtorin afësisht sa mjete do te ndahen per 3 vitet e ardhshme DVRR (Dokumenti i vlerësimit te trezigeve) synon realizimin e projekteve me qellim te ndërmartjes se masave parandaluese dhe zvogëlim te trezigeve nga FNFT. Per periudhën 2023-2026 Komuna e Rahoveciit ndanë mjete financiare ne periudha kohore: Per vitin 2023 jane ndare afër 170 000,00 Euro për pasttrimin e 10 kilometrave kanale, ndërsa për ndërtimin e kanaleve ka paraparë afro 3 000 000 euro në zonat ku janë më të goditura nga vërshimet.

- 1. Problemet primare financiare:** Të gjitha strukturat, të cilat kanë përgjegjësi dhe detyrime për situatat emergjente civile, duhet të jenë të pavarura në veprime, në mënyrë që të jenë në gjendje të veprojnë menjëherë dhe në çdo kohë. Është më se e nevojshme që strukturat të kenë mundësi për të siguruar mjete financiare të mjaftueshme për veprim. Duhet të merren të gjitha masat që pajisjet, mjetet e transportit, nafta, kostot e komunikimit që parashikohen të nevojshme, të jenë në dispozicion dhe të bëhen paraprakisht të përdorshme nga të gjitha strukturat e përfshira në situata emergjente, në mënyrë që të fillojë menjëherë veprimi.
- 2. Kostot financiare sekondare:** Gjatë zhvillimit të situatës emergjente, problemet financiare rriten dhe bëhen afatgjata. Këtu përfshihen kostot për orë shtesë të personelit, kostot për sigurimin dhe vënien në funksion të pajisjeve të specializuara dhe të mjeteve të transportit, si dhe kostot për sigurimin e vendstrehimeve, asistencën mjekësore dhe ato

humanitare në përgjithësi, për ata që janë të prekur nga situata emergjente. Këto shpenzime përbëjnë probleme afatgjata buxhetore dhe duhet të planifikohen.

3. **Kostot financiare për rimekëmbje:** Në të shumtën e rasteve, janë të lidhura me përpjekjet për stabilizimin e situatës para rikthimit të fazës në gjendjen normale. Këto mund të përfshijnë kostot për:
- Riparimin e ndërtesave,
 - Të infrastrukturës,
 - Të ujit,
 - Të energjisë elektrike,
 - Të strehimit për të gjithë ata të cilët për një periudhë më të gjatë kohore nuk mund të kthehen në shtëpitë e tyre, këto burime financiare buxhetore duhet të garantohen nëpërmjet procedurave të brendshme, duke krijuar mekanizma lehtësuese për përdorim në mënyrë sa më të efektshme në situata emergjente.

3.1 Identifikimi dhe analizi i rreziqeve nga FNFT(ekiye huluntuse profesionale)

Duhet te krijohet komiteti komunal per mbrojtje dhe shpetim ne perbejtje:

- Stafi i komunës;
- Kompanitë publike;
- Policia;
- NJPZSh
- Shëndetësia;
- Kryqi i kuq,etj.

3.2 Identifikimi i nevojave për resurset humane dhe teknike

- a. Ekipi profesional, afër 50 persona;
- b. Vullnetarët nga Shogata e zjarrfikseve (sipas rasis dhe nevojës);
- c. Identifikimi i kapaciteteve per nevoja elementare (shtrretër, shatorre, batanije, pako higjienike, pako ushqimore, stuja per nxenje etj);
- d. Momerandum bashkëpunimi me kompanitë vendore për aktivizimin e paisjeve teknike ne rastet emergjente (per hapjen e rrugëve, të kanaleve etj);
- e. Makineritë e tjera te nevojshmem - afër 20 (Kamione, zjarrfikëse, dhe mjetet e tjera per transportin e njerëzve).

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË E TJERA

3.3 Identifikimi i nevojave për trajnim dhe aftësim profesional

Pasi të krijohet ekipi për reagim emergjent (ERE), Komuna e Rahovecit, kërkon trajnim dhe certifikim profesional nga AME-në.

3.4 Zbatimi i aktive ligjore, nënligjore dhe monitorimi i tyre

Komuna e Rahovecit bazohet në rregulloren nr (QRK) 18/2015 për organizimin e Njesive të SMSHN.

3.5 Masat parandaluese për zvogëlimin e efekteve nga FNFT-ja

Rregullimi i shtrëtërve të lumjeve

Rritja e kapaciteteve humane dhe teknike

Rritja e kapaciteteve në shëndesi me staf human dhe teknik

Aktivizimi i ekipeve reaguese emergjente në periudhën e thatësirave

Realizimi i projekteve që ndikojnë në zvogëlimin e rreziqeve;

4. DIZPOZITAT PËRFUNDIMTARE

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË TJERA PËR KOMUNËN E RAHOVECIT

Hartimi i “Dokumentit të Vlerësimit të Rrezikshmerisë nga FNFT është i bazuar në Ligjin 04/L-027 për

Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera;

Në grumbullimin e të dhënave për azhurnimin e Dokumentit janë shfrytëzuar burime nga: ASK (Agjencia e Statistikave të Kosovës), KEDS, Policia e Kosovës, stacioni i Rahovecit, Qendra për punë sociale, QKMF, KRU “Radoniqi”, Enti për punësim. Drejtoritë përkatëse të Kuvendit Komunal Rahovec, Plani Zhvillimor i Komunës, si dhe burime të tjera nga literatura të ndryshme.

Dokumenti u hartua nga grupit punues i caktuar nga Kryetari i komunës së Rahovecit, z. Smajl Latifi.

Prezantimi dhe Hartimi i Dokumentit të Vlerësimit i Rrezikshmerisë është i bazuar në rregulloren nr 25/2020 për Metodologjinë e Vlerësimit të Rrezikshmerisë nga FNFT.

Dokumentit të Vlerësimit i Rrezikshmerisë është me afat kohor të bazuar në Nenin 19, i cili duhet të rishikohet çdo 3 vite e në rastet e veçanta edhe më heret. Ky dokument pas aprovimit nga Kuvendi Komunal, në pajtueshmëri me mendimin profesional të AME-së dhe aktive ligjore në fuqi, Komuna e Rahovecit merr obligim zbatimin e këtij dokumenti.

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË E TJERA

5. REFERENCAT:

1. Ligji Nr.04/L-027 për Mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera LIGJI NR. 04/L-027 PËR MBROJTJE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË TJERA (rks-gov.net)
2. RREGULLORE (ORK) Nr. 25/2020 PËR METODOLOGJINË E HARTIMIT TË VLERËSIMIT TË RREZIKSHMËRISË (rks-gov.net)
3. Plan i Zhvillimor komunal Rahovec 2018-2026 Draft - plani https://kk.rks-gov.net/rahovec/wpcontent/uploads/sites/23/2018/10/00_PZHK_Rahovec_DRAFT_d.pdf
4. Agjencia Kadastrale e Kosovës – Ortofotot e vitit 2018 <http://geoportal.rks-gov.net/search>
5. Agjencia e Statistikave të Kosovës <https://ask.rks-gov.net/>
6. Instituti Hidro-meteorologjik i Kosovës , <https://ihmk-rks.net/>
7. Vlerësimi i rreziqeve nga Fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, Prishtinë Korrik 2016, [Vleresimi i Rreziqeve nga Fatkeqesite Natyrore....pdf](https://rks-gov.net/Vleresimi_i_Rreziqeve nga_Fatkeqesite_Natyrore....pdf) (rks-gov.net)
8. Raportet e vlerësimeve nga Komuna e Rahovecit
9. Zyra e KEDS në Rahovec
10. Zyra e Ujësjellësit të Radoniqit
11. Puna në terren nga ekipet e komunës së Rahovecit

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.21/23

Me datë:28.02.2023





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi Komunitës Rahovec
Skupština Opštine Oraovac / Municipal Assanbly Rahovec




ANEKSI 2 - HARTAT

VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË TJERA PËR KOMUNËN E RAHOVECIT




Prill 2023, Rahovec


Harta 1: Pozita gjeografike e Komunës së Rahovecit




Harta 2: Kufizimi i komunës së Rahovecit me komunat fqinje




Harta 3: Rrethi hidrografik i Komunës së Rahovecit




Harta 4: Dendësia e popullsisë në Komunën e Rahovecit (burimi i të dhënave: ASK 2011)



Harta 5: Disa monumente natyrore dhe kulturore në komunën e Rahoveci (Burimi i të dhënave: draft-PZHK, Rahovec).




Harta 6: Siperfaqet me pyje në Komunën e Rahovecit (Digitalizim nga Ortofotoi 2018)



Harta 7: Institucionet shëndetësore në Komunën e Rahovecit (Burimi i të dhënave: Ministria e Shëndetësisë)


RRJETI I INSTITUCIONEVE SHËNDETËSORE




3.05.02



Harta 11: Antenat e telefonisë mobile në Komunën e Rahovecit (Burimi i të dhënave: Draft - plani i PZHK-së, Komuna e Rahovecit).




Harta 13: Pompat e derivate në komunën e Rahovecit (Digitalizime dhe marja e pikave nga puna e terrenit)




Në komunën e Rahovecit janë afër 32 pompa të derivateve, të cilat shpesh e tyre gjenden përgjatë rrugëve rajonale.


Harta 14: Rrjetit i institucioneve edukative në Komunën e Rahovecit (Burimi i të dhënave: Komuna e Rahovecit)




Harta 15: Zonat e rezikuar nga vërshimet në komunën e Rahovecit (Burimi i të dhënave: Komuna e Rahovecit)




Harta 16: Zonat e vërsuara në komunën e Rahovecit (Vezhigimet në terren nga Komuna e Rahovecit, 17.9.2022)




Harta 17: Skenari I i vërshimeve (Burimi i të dhënave: Komuna e Rahovecit)




Harta 18: Skenari 2 - Zonat e rrezikuara nga vërshimet (Burimi i të dhënave: Komuna e Rahovecit)




Harta 19: Skenari 3 i vërshtimeve në komunën e Rahovecit (Burimi i të dhënave: Komuna e Rahovecit)




Harta 20: Skenari I i zjarreve (Burimi i të dhënave: Komuna e Rahovecit)




Harta 21: Skenari i dytë i zjarreve në komunën e Rahovecit (Burimi i të dhënave: Komuna e Rahovecit)




Harta 22: Rrezikshmeria e vendbanimeve nga zjarret në Komunën e Rahovecit (Burimi i të dhënave: Draft - plani i PZHK-së)




Harta 23: Zonat e tërmeteve në komunën e Rahoveci (Burimi i të dhënave: Draft - plani i PZHK-së)




Harta 24: Zonat e rrezikuara nga erozioni në komunën e Rahovecit (Burimi i të dhënave: Draft -plani i PZHK-së)




Harta 25: Rrugët e prezikuara nga bora dhe ngricat




Harta 26: Harta e dëmtimit të vreshtave nga breshëri në komunën e Rahovecit, në vitin 2018




Harta 27: Breshëri me datë 19.5.2020, në komunën e Rahovecit




Harta 29: Rreziqet e mundshme nga Ortekët në komunën e Rahovecit




Harta 30: Drejtimi i erës (Burimi i të dhënave: Plani zhvillimor i Komunës së Rahovecit)




Harta 31: Zonat më të rrezikuara nga thatësirat (Burimi i të dhënave: Komuna e Rahovecit)




Harta 32: Zonat e prezikuara nga pickimi i triqrave (Burimi i të dhënave: Komuna e Rahovecit)



Harta 33: Zona e rrezikuar nga përmbytjet nga Liqeni i Radoniqit



Harta 34: Zona e rrezikuara nga përmbytjet – majet hidro-meteorologjike







Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike
Ministry of Internal Affairs and Public Administration

Ministarsvo Unutashnjih Poslova i Javne Uprave / Ministry of Internal Affairs and Public Administration

Administration

Agjencia e Menaxhimit Emergjent/Agjencia Emergjentnog Upravljanja
Emergency Management Agency

Emergency Management Agency

U B N

22

M. B. E. g. 25

LISTE DISTRIBUIM/CIRKULARNO PISMO/ROUTING SLIP

REFERENCE:	Z. Ismajl Latif, Kryetar i Komunës së Rahovecit;				
PËR/ZATTO:					
CC:					
PËRNIES/PREKO/THROUGH					
NGA/OD/FROM:	Shefki Abdullahu, Zhvendësues i Drejtorit të Përgjithshëm të AME				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion i AME-së për Draft-Dokumentin e VKr nga INFT nga Komuna e Rahovecit;				
Nr. i zyrës:	Lokacioni:	Data:			
Br. Kancelarije:	Lokacija:	Hajvali		Datum:	
Office No:	Location:			Date:	
				07.03.2023	

Z. Kryetar,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe në bazë të kompetencave ligjore të ministritë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, bazuar në Ligjin për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, me Nr.04-L-027, neni 44 paragrafi 3, kemi pranuar për shqyrtim të ligjshmërisë kërkesën për shqyrtim të draft-dokumentit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë nga Komuna e Rahovecit, me nr. protokoli: 01-404/22, të datës: 28.12.2022.

Agjencia e Menaxhimit Emergjent/MPB, pas shqyrtimit profesional të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në pajtueshmëri me dispozitat e legjislationit në fuqi:

Arsyetimi:

Agjencia e Menaxhimit Emergjent / Ministria e Punëve të Brendshme, pas shqyrtimit të Dokumentit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, konkludon se ky draft-dokument është në pajtueshmëri të plotë me Rregulloren nr. 25/2020 për Metodologjinë e Hartimit të vlerësimit të Rrezikshmërisë, neni 17, paragrafi 7, dhe se mund të procedohet për miratim në Kuvendin Komunal të Rahovecit

Me respekt!

